



BESIMI I THJESHTËSUAR

Bazuar në Kuranin fisnik dhe Sunetin e pastër profetik

Dr. Ahmed ibn Abdurrahman el Kadi

العقيدة الميسرة

من الكتاب العزيز والسنة المطهرة

أ. د. أحمد بن عبد الرحمن القاضي



BESIMI I THJESHTËSUAR

(Bazuar në Kuranin fisnik dhe Sunetin e pastër profetik)

Dr. Ahmed ibn Abdurrahman el Kadi

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Me emrin e Allahut,
të Gjithëmëshirshmit,
Mëshirëplotit!

PËRMBAJTJA

HYRJE	09
BESIMI I THJESHTËSUAR, BAZUAR NË KURANIN FISNIK DHE SUNETIN E PASTËR PROFETIK	13
BESIMI NË ALLAHUN	13
I. Besimi në ekzistimin e Tij	14
II. Besimi në zotërimin e Tij	20
III. Besimi në uluhijen e Tij (njëshmërinë e adhurimit	29
IV. Besimi në emrat dhe cilësitë e Allahut	43
BESIMI NË MELEKËT	51
1. Ata janë robër të nderuar, të drejtë e të afërm të Tij; janë të nënshtruar dhe i frikësohen Zotit të tyre	51
2. Ata janë të emërtuar me emra fisnikë	51
3. Ata janë të krijuar prej dritës, posedojnë flatra, kanë forma gjigande e të shumëllojshme	52
4. Ata qëndrojnë në radhë dhe e lartësojnë Allahun	52
5. Ata nuk mund të shihen	53
6. Ata janë të ngarkuar me detyra të ndryshme	54
BESIMI NË LIBRAT	59
1. Besimi se librat në fjalë janë të zbritur nga Allahu me të vërtetën	59
2. Besimi në mënyrë konkrete për secilin që ia dimë emrin, kurse në ata të cilëve nuk ua dimë emrat, besojmë në mënyrë të përgjithshme	59
3. Besimi i lajmeve që nuk kanë pësuar ndryshime (përveç Kuranit)	60
4. Gjykimi me legjislacionin e Kuranit	62
5. Besimi në tërësinë e librave, pa kurrfarë përjashtimi	63
6. Ndalohet fshehja e ndonjë gjëje që përmbajnë ata, shtrembërimi, mospajtimi rreth tyre dhe përplasja e Fjalës së Allahut me njëra-tjetrën	63

BESIMI NË TË DËRGUARIT	65
1. Besimi se mesazhi i tyre është nga Allahu, pikërisht sipas dëshirës dhe urtësisë së Tij	65
2. Besimi në të gjithë të dërguarit: atyre që ua dimë emrat (u besojmë) në mënyrë konkrete, kurse atyre që nuk ua dimë, u besojmë përgjithësisht	66
3. Pranimi dhe konsiderimi për të mirëqena i gjërave që kanë lajmëruar nga Allahu	67
4. T'u bindemi, t'i pasojmë dhe të gjykojemi tek ata	67
5. T'i miqësojmë, t'i duam, t'i nderojmë dhe të dërgojmë selam (përsëndetje) mbi ta	68
BESIMI NË DITËN E FUNDIT	71
1. Besimi në atë që do të ndodhë pas vdekjes	71
2. Besimi në Ditën e Kiametit dhe shenjat e saj	72
3. Besimi në Ringjalljen	73
4. Besimi në lidhje me ndodhitë e mëdha të Kiametit	73
5. Besimi në dhënien e llogarisë	74
6. Besimi në shpërblimin (me Xhenet ose me Zjarr)	76
BESIMI NË KADERIN (PARAKAKTIMIN)	77
Në kapitullin e kaderit kanë devijuar dy grupe	77
Të dy grupeve u kundërpërgjigjet sheriati dhe realiteti	80
Mohuesve të kaderit	81
Xhebrive teprues në pohimin e kaderit	81
KURANI	83
TË PARËT E ALLAHUT TË LARTËSUAR	85
REALITETI I BESIMIT	86

IMAMLLËKU DHE XHEMATI	92
SAHABËT	93
1. Dallimi i përgjithshëm	93
2. Pjesëtarët e Bedrit	95
3. Pjesëmarrësit në Besëlidhjen e Kënaqësisë (Bejatur Ridvan)	95
4. Dallimi i veçantë	95
5. Obligimi ynë karshi sahabëve, pavarësisht shtresave dhe pozitave të tyre	97
TË DASHURIT E ALLAHUT (EVLIJATË)	99
1. I DASHURI I ALLAHUT (VELIJU)	99
2. MREKULLIA (KERAMETI)	99
BAZA TË PËRGJITHSHME RRETH ARGUMENTIMIT	100
1. BAZAT E PËRGJITHSHME	100
2. RRUGA PËR TA KUPTUAR KURANIN DHE SUNETIN	100
3. LOGJIKA E ÇILTËR	100
BIDATI	100
DISA GJËRA QË E PLOTËSOJNË BESIMIN	101
1. URDHËRIMI PËR VEPRATË TË MIRA DHE NDALIMI PREJ VEPRAVE TË KËQIJA	101
2. RUAJTA E UNITETIT DHE KOMPAKTËSISË, SI DHE LARGIMI NGA PËRÇARJA DHE KONTRADIKTA	102
3. VIRTYTET E LARTA MORALE DHE VEPRATË E MIRA	102
FEJA DHE SEKTARIZMI	105



HYRJJE

Çdo falënderim i takon Allahut. Atë e falënderojmë dhe prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë. Allahut i kërkojmë mbrojtje kundrejt të këqijave të vetvetes dhe veprave tona të liga! Atë që Allahu e udhëzon, s'ka kush e humb; kurse atë që Ai e lë në humbje, s'ka kush e udhëzon. Dëshmoj se nuk meriton adhurimin askush përveç Allahut, të Vetmit që nuk ka ortak, të Lartësuarit, i Cili thotë: **“Është Ai që analfabetëve u solli një të Dërguar nga gjiri i tyre, për t'u lexuar atyre shpalljet e Tij, për t'i pastruar e për t'u mësuar Librin dhe Urtësinë, ndonëse ata më parë ishin vërtet në humbje të plotë.”** (El Xhumua, 2) Gjithashtu, dëshmoj se Muhamedi është robi dhe i Dërguari i Tij, me dërgimin e të cilit Allahu ka begatuar robërit e Vet. Allahu i Lartësuar thotë: **“Allahu u ka dhënë besimtarëve dhuratë të madhe, kur u solli një të Dërguar nga gjiri i tyre, i cili ua lexon shpalljet e Tij, i pastron nga gjynahet dhe u mëson Librin (Kuranin) e Urtësinë (diturinë e thellë fetare), edhe pse më parë, me të vërtetë, ata ishin në rrugë krejt të gabuar.”** (Alu Imran, 164)

Allahu i Lartësuar e ka dërguar Profetin e Tij, Muhamedin *sal-lallahu alejhi ue selem*, me udhëzimin dhe fenë e vërtetë, në mënyrë që njerëzit t'i nxjerrë nga errësirat në dritë; nga humbja e qartë në udhëzimin e plotë, me anë të të cilit zgjerohet kraharori dhe qetësohet zemra. **Udhëzimi** është dija e dobishme, ndërsa **feja e vërtetë** është vepra e mirë. Mbi këto dy shtylla madhështore ngrihet jeta e këndshme.

Allahu i Lartësuar në Librin e Tij fisnik ka përfshirë çdo gjë që robërit kanë nevojë rreth besimit, adhurimeve, marrëdhënieve ndërvepruese dhe moralit të tyre.

Tradita e pastër profetike (Suneti) ka ardhur si sqaruese e asaj që është përmendur në formë të përmbledhur (në Kuran); komentuese e asaj që është e panjohur dhe shpjeguese e hollësishme e asaj që është theksuar përmbledhtas, ashtu siç ka thënë i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*: *“Vërtet mua më është dhënë Libri (Kurani) dhe diçka e ngjashme me të (Suneti).”*¹

Besimi islam është shtyllë mbajtëse dhe bazë e kësaj feje, sekreti i fuqisë dhe ngadhënjimit ndaj çdo feje. Kjo, se përmban karakteristika të veçanta që s'i ka kush, si:

¹ Ebu Davudi (4604), përcjellë nga Mikdam ibn Madi Keribi, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

E para: *teubidi* (njëshmëria e Allahut), që nënkupton veçimin e Allahut të Lartësuar në adhurim dhe veçimin e të Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, në pasim.

E dyta: *teukifi*, që nënkupton se besimi islam ka burim hyjnor, që nuk duhet të tejkalohet Kurani e Hadithi, si dhe nuk mbështetet në ndonjë mendim apo analogji.

E treta: *është në përputhje me natyrshmërinë e pastër*, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit para se t'i devijonte shejtani.

E katërta: *është në përputhje me mendjen e shëndoshë*, që është e paprekur nga dyshimet dhe epshtet.

E pesta: *gjithëpërfshirja*. Nuk ka lënë pa sqaruar asnjë aspekt rreth universit, jetës dhe njeriut.

E gjashta: pajtueshmëria. Argumentet fetare e vërtetojnë njëra-tjetrën dhe nuk ka kurrfarë kontradikte e mospajtimi në tematikat e tyre.

E shtata: *mesataria*, që është peshore ekuilibruese mes neglizhencës dhe teprimt në mendime të ndryshme.

Këto karakteristika i sjellin këto fryte:

1. Realizimin e të qenit rob i Allahut (el ubudije) dhe çlirimin nga të qenët rob i krijesave.
2. Realizimin e pasimit të të Dërguarit të Zotit të botëve dhe largimin nga bidatet e bidatçinjtë.
3. Rehatinë shpirtërore dhe qetësinë e zemrës duke u lidhur me Krijuesin, Sistemuesin e çdo gjëje, të Urtin.
4. Stabilitetin mendor, ekuilibrin logjik dhe shpëtimin nga kontradiktat dhe besëtytnitë.
5. Përgjigjen e nevojave shpirtërore e trupore dhe plotësimin mes besimit e moralit.

Dijetarët e fesë vazhdojnë t'i kushtojnë rëndësi besimit duke derdhur mund për mësimin dhe sqarimin e tij, të cilët shkruajnë tekste të shkurtra dhe shpjegime të gjata përkitazi me të. Herë duke e sqaruar besimin e selefëve (pararendësve tanë të mirë) në mënyrë të përmbledhur, herë duke sqaruar ndonjë çështje konkrete; si dhe u kundërpërgjigjen pasuesve të epshit dhe bidateve devijuese.

Kam parë (të udhës) përafrimin e çështjeve të besimit dhe renditjen e tyre sipas renditjes që i Dërguari, *sal-lallahü alejhi ue selem*, ka bërë për gjashtë bazat e besimit, të theksuara në hadithin e njohur të Xhibrilit. Tërë kjo duke u mbështetur vetëm në dy tekstet e shpalljeve: Kuranin fisnik dhe Sunetin e pastër profetik, si dhe poshtë çdo baze do të përmenden tematikat që përfshin baza në fjalë dhe do të jepen sqarime kush ka devijuar në tematikën përkatëse, duke iu kundërpërgjigjur pa u stërzgatur.

Kështu e kam prezantuar besimin: mesatar ndërmjet të qenit i gjatë dhe i përmbledhur, duke pasur si veçori qartësinë dhe thjeshtësinë, në mënyrë që muslimanët e thjeshtë të kenë mundësi të përfitojnë prej tij. Gjithashtu, të arrihet qëllimi i njohjes së besimit të pararendësve në mënyrë të përmbledhur, me shprehje të lehta dhe renditje tematike. Kështu, e kam titulluar “Besimi i thjeshtësuar, bazuar në Kuranin fisnik dhe Sunetin e pastër profetik”.

E lus Allahun që këtë vepër ta bëjë të çiltër për Fytyrën e Tij dhe të dobishme për robërit e Tij! Lavdërimi dhe shpëtimi qofshin për të Dërguarin tonë, Muhamedin, familjen dhe gjithë shokët e tij!

Dr. Ahmed ibn Abdurrahman el Kadi



BESIMI I THJESHTËSUAR, BAZUAR NË KURANIN FISNIK DHE SUNETIN E PASTËR PROFETIK

Bazë e besimit islam është besimi në Allahun, melekët (engjëjt), librat e Tij, profetët, Ditën e Fundit dhe kaderin (paracaktimin e Allahut), qoftë i mirë apo i keq.

Allahu i Lartësuar thotë: **“Mirësia nuk është të kthyerit e fytyrës suaj nga lindja dhe perëndimi, por mirësia është (cilësi) e atij që beson Allahun, Ditën e Fundit, engjëjt (melekët), Librin dhe profetët...”** (El Bekare, 177) Gjithashtu, thotë: **“I Dërguari beson në atë (Kuranin) që i është shpallur nga Zoti i tij e po ashtu edhe besimtarët: të gjithë besojnë në Allahun, engjëjt e Tij, librat e Tij dhe profetët e Tij...”** (El Bekare, 285) Po ashtu, thotë: **“O besimtarë! Besoni në Allahun, të Dërguarin e Tij, Librin, që ia ka zbritur të Dërguarit të Tij dhe Librin që e ka zbritur më parë. Kushdo që mohon Allahun, engjëjt e Tij, librat e Tij, të dërguarit e Tij dhe Ditën e Kiametit, ai, me të vërtetë, ka humbur larg udhës së drejtë.”** (En Nisa, 136) Si dhe thotë: **“Vërtet, Ne çdo gjë e kemi krijuar me masë të paracaktuar.”** (El Kamer, 49)

Kur Xhibrili, *alejhi selam*, e kishte pyetur të Dërguarin, *sal-lallahu alejhi ue selem*, se ç'është imani, ky i fundit i ishte përgjigjur: **“Të besosh në Allahun, melekët, librat e Tij, profetët, Ditën e Fundit dhe të besosh në kaderin (paracaktimin), qoftë i mirë apo i keq.”** (Shënon Muslimi)²

BESIMI NË ALLAHUN

Besimi në Allahun nënkupton bindjen e palëkundshme se Ai, i Lartësuari, ekziston dhe se është Zot i çdo gjëje. Ai është i Vetmi që e meriton adhurimin. Ai është i cilësuar me attribute të plota dhe është i pastër e i dëlirë nga atributet e mangëta.

Në besimin në Allahun përfshihen katër gjëra:

² Muslimi (8), përcjellë nga Omeri, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

I. Besimi në ekzistimin e Tij

Besimi në ekzistimin e Allahut të Lartësuar është e vërteta më e madhe: **“Kjo është kështu, sepse Allahu është e Vërteta (i Vetmi që meriton të adhurohet), kurse gjithçka që adhurohet përveç Tij, është e pavërteta. Dhe, pa dyshim, Allahu është më i Lartësuari dhe më i Madhërishmi.”** (El Haxh, 62) Dyshimi në ekzistimin e Tij është mëdyshje dhe refuzim: **“Të dërguarit e tyre u thanë: “Vallë, a mund të dyshohet në Allahun, Krijuesin e qiejve dhe të Tokës?! Ai ju thërret për t’ju falur disa gjynahe tuajat dhe që t’ju lërë deri në afatin e caktuar.”** (Ibrahim, 10) Mohimi i ekzistencës së Tij është mendjemadhësi, padrejtësi dhe kufër (mohim): **“(Musai) tha: “Tashmë ti e di se këto nuk i ka shpallur askush tjetër, përveç Zotit të qiellit dhe të Tokës, si prova të dukshme dhe Unë jam i bindur, o Faraon, se ti je i dënuar në humbje.”** (El Isra, 102) Allahu i Lartësuar thotë: **“Faraoni e pyeti: “E ç’është Zoti i botëve?” (Musai) iu përgjigj: “Është Zoti i qiejve, i Tokës dhe i gjithçkaje që gjendet midis tyre, nëse besoni me bindje.”** (Faraoni) u tha atyre rreth vetes: **“Vallë, a nuk po dëgjoni?!”** Ai tha: **“Zoti juaj dhe Zoti i të parëve tuaj.”** (Faraoni) tha: **“Me të vërtetë, i Dërguari që ju është sjellë, është i çmendur.”** (Musai) tha: **“Zoti i lindjes dhe i perëndimit dhe i gjithçkaje që gjendet midis tyre, nëse kuptoni. (Faraoni) tha: “Nëse ti merr për zot tjetërkënd, përveç meje, me siguri, do të të fus në burg!”** (Esh Shuara, 23-29)

Ekzistimin e Allahut të Lartësuar e argumentojnë disa gjëra, si:

1. Natyrshmëria e pastër njerëzore

Ajo është natyrshmëria në të cilën njeriu është krijuar asisoj, pa e mësuar dikush paraprakisht. Allahu i Lartësuar thotë: **“Drejtohu me përkushtim në fenë e pastër monoteiste, natyrën fillestare, në të cilën Allahu i ka krijuar njerëzit. S’ka ndryshim të krijimit të Allahut. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë.”** (Er Rum, 30)

Ndërkaq, i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: *“Çdo foshnjë lind me natyrshmërinë islame, porse më pas prindërit e hebrenëzajnë, e krishterojnë ose e bëjnë zjarradburues.”* (Shënon Buhariu) Në një motërzim të Muslimit qëndron: *“Çdo foshnjë lind duke qenë në fenë islame.”* Ndërsa në një transmetim tjetër të tij qëndron:

“Nuk ka asnjë foshnjë që nuk lind në këtë natyrshmëri, derisa këtë e pobon gjuba e tij.”³

Çdo krijesë e mbetur në natyrshmërinë e vet fillestare në vetvete gjen besimin në ekzistencën e Allahut, përveç nëse në këtë natyrë të pastër ka diç që e prish atë. Allahu i Lartësuar në një hadith kudsij⁴ thotë: *“Të gjithë robërit e Mi i kam krijuar besimpastër (monoteistë), mirëpo atyre u venë shejtanët e i largojnë nga feja e tyre.”* (Shënon Muslimi)⁵

Ka raste kur natyrën e pastër e mbulon leckë e dyshimeve dhe epsheve, por realiteti i saj shfaqet në kohë fatkeqësish dhe krizash. Allahu i Lartësuar ka thënë: *“Kur hipin në anije, ata i luten Allahut me devotshmëri të sinqertë, por, kur Ai i sjell në tokë shëndoshë e mirë, menjëherë ata i veshin Atij ortakë (në adhurim).”* (El Ankebut, 65)

2. Mendja e shëndoshë

Ajo është mendja e pastër nga dyshimet dhe epshet. Ajo në mënyrë të prerë pohon se krijesat doemos kanë Krijues, ngase ato nuk mund të ekzistojnë rastësisht e pa Krijues, si dhe nuk ka mundësi që ato të jenë vetëkrijuar, sepse mosekzistenca nuk prodhon ekzistencë! Pra, medoemos ka një Krijues Ekzistencësjellës, që është Allahu i Lartësuar.

Kur Xhubejr ibn Mutimi, që atëkohë ende ishte idhujtar, kishte shkuar tek i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, për lirim të robërve të Bedrit, Profetin, *sal-lallahu alejhi ue selem*, e kishte dëgjuar duke lexuar suren Et Tur në namazin e akshamit, derisa kishte arritur tek ajeti: **“A mos vallë, ata janë krijuar nga hiçi apo mos ata janë krijues të vetvetes?! A mos vallë, ata kanë krijuar qiejt dhe Tokën?! Nuk është kështu, por ata nuk janë aspak të bindur. A mos zotërojnë thesaret e Zotit tënd?! Apo mos janë ata sunduesit (e gjithçkaje)?!”** (Et Tur, 35-37), me ç’rast kishte thënë: *“Pothuajse zemra më fluturoi.”* (Shënon Buhariu) Ky ishte momenti i parë kur besimi i kishte hyrë në zemër.

3 Buhariu (1358) dhe Muslimi (2658), përcjellë nga Ebu Hurejra, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

4 *Hadith kudsij* (i shenjtë, hyjnor) quhet hadithi që e transmeton i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, nga Allahu i Lartësuar. Shënim i përkthyesit.

5 Muslimi (2865), përbrenda një hadithi të gjatë, përcjellë nga Ijad ibn Himar el Muxhashiu, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

Ligjëruesi i arabëve gjatë periudhës së injorancës, Kus ibn Saide el Ijadi, ka argumentuar arsyetimin e çiltër, me ç'rast ka thënë: “Bajga është treguese e devesë e fërkemi tregon se dikush ka kaluar. Po qielli përplot yje e Toka e mbushur me kodra, a nuk e tregojnë Krijuesin dhe të Gjithinformuarin?!”

3. Provat shqisore

Allahu i Lartësuar thotë: **“Ne do t’u tregojmë atyre shenjat Tona në hapësirat tokësore e qiellore, si dhe në vetvete, derisa t’u bëhet plotësisht e qartë se ai (Kurani) është e vërteta.”** (Fusilet, 53) Ato shfaqen në forma të ndryshme. Për shembull: mrekullitë e pejgamberëve, nderimet (*kerametet*) e miqve të Allahut, njerëzve të mirë, si dhe përgjigja e lutjes së atyre që i luten Allahut.

Allahu i Lartësuar, për të dërguarin e Tij, Nuhun, *alejbi selam*, thotë: **“Kështu, ai iu lut Zotit të vet: “Unë jam i mundur, andaj më ndihmo!” Dhe Ne i hapëm dyert e qiellit me ujë të rrëmbyeshëm dhe i shpërthyem burimet e tokës, e u takuan ujërat për një qëllim të paracaktuar. Ndërsa Nuhun e bartëm në një barkë (të ndërtuar) prej dërrasash dhe gozhdësh, e cila lundronte nën Sytë Tanë (nën mbikëqyrjen dhe kujdesin Tonë): si shpërblim për atë (Nuhun) i cili u mohua.”** (El Kamer, 10-14) Gjithashtu, thotë: **“Dhe Ne i shpallëm Musait: “Bjeri me shkopin tënd detit!” Menjëherë deti u nda dhe çdo pjesë e tij u bë si mal i madh. Atëherë Ne i afruam aty të tjerët. Musain dhe të gjithë ata që ishin me të, i shpëtuan, kurse të tjerët i fundosëm. Pa dyshim, në këtë ka shenja treguese, por shumica e njerëzve nuk janë besimtarë.”** (Esh Shuara, 63-67) Po ashtu, i Lartësuari, për Isain, *alejbi selam*, thotë: **“Dhe do ta caktojë atë të dërguar te bijtë e Izraelit (të cilëve do t’u thotë): “Ju kam sjellë prova nga Zoti juaj (që vërtetojnë profecinë time): bëj për ju diçka prej balte në formë shpendi, fryj në të e me urdhrin e Allahut ajo bëhet shpend i gjallë; shëroj të verbrit e lindur e të lebrosurit dhe i ngjall të vdekurit me lejen e Allahut; ju tregoj çfarë hani dhe çfarë ruani në shtëpitë tuaja. Sigurisht që te të gjitha këto ka prova për ju, nëse jeni besimtarë të vërtetë.”** (Alu Imran, 49)

Gjëra të ngjashme i kanë ndodhur edhe të Dërguarit tonë, Muhamedit, *sal-lallahu alejhi ue selem*. Nga Enes ibn Maliku, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, përcillet

se një burrë kishte hyrë në xhami ditën e premtë, ndërkohë i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ishte në këmbë duke ligjëruar. Ai iu drejtua të Dërguarit duke qenë vetë në këmbë dhe i tha: “O i Dërguari i Allahut, u shkatërruan pronat dhe u prenë rrugët. Lute Allahun të na çojë shi!” I Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, i ngriti duart dhe tha: “O Allah, na çojë shi! O Allah, na çojë shi!” Enesi thotë: “Betohem në Allahun se në qiell nuk shihnim asnjë re shiu, madje as re të imëta, përfshirë vendin ku ishim e deri në malin e Selit.” Vazhdon: “Pas tij doli një re si mburoja dhe, kur ajo u afrua në mes të qiellit (mbi ne), u përhap dhe filloi së reshuri. Rrëfen: “Betohem në Allahun se nuk e kemi parë Diellin një javë rresht!” Pastaj, xhumanë tjetër, një njeri hyri nga po e njëjta portë; ndërkohë i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ishte në këmbë duke ligjëruar. Personi në fjalë iu drejtua atij duke i thënë: “O i Dërguari i Allahut, u shkatërruan pronat dhe u prenë rrugët! Lute Allahun të na e ndalë shiun!” Thotë: “I Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, i ngriti duart dhe tha: “O Allah, (çoje shiun) rreth nesh e jo sipër nesh! O Allah, *kteheje shiun mbi pllaja në male, në kodra e lugina dhe atje ku rriten pemët!*” Vijon: “Sakaq, shiu u ndal dhe, kur dolëm nga xhamia, ecnim në diell.” (E shënojnë Buhariu dhe Muslimi)⁶

Allahu i Lartësuar, në mënyrë të përgjithshme, thotë: **“A ka më të mirë se Ai që i vjen në ndihmë nevojtarit të këputur, kur i lutet Atij, që jua largon të keqen dhe ju bën trashëgimtarë në tokë?! Vallë, a ka zot tjetër krahas Allahut?! Sa pak që reflektoni!”** (En Neml, 62)

Kështu, mrekullitë e pejgamberëve, përgjigjja e lutjes së atyre që e lutin Allahun e shpëtimi i atyre që janë në vështirësi, janë argumente shqisore që i kanë perceptuar masa të mëdha njerëzish, gjë që dëshmojnë bindshëm ekzistencën e Dërguesit ⁷ të këtyre mrekullive; Atij që u përgjigjet lutjeve dhe Atij që i shpëton nga vështirësitë. I Patëmeta është Allahu!

4. Legjislacioni i saktë (sberiat)

Ekzistimin e Allahut e dëshmojnë Kurani dhe Suneti autentik (tradita profetike).

Allahu i Lartësuar thotë: **“A nuk përsiatin ata për Kuranin! Sikur ai të mos ishte prej Allahut, në të do të gjenin shumë kundërthënie.”** (En Nisa, 82)

⁶ Buhariu (1014) dhe Muslimi (894).

⁷ Allahut të Lartësuar, i Cili i dërgon mrekullitë që me to të përkrahë të dërguarit e Tij. Shënim i përkatësit.

Gjithashtu, i Lartësuari thotë: **“O njerëz! Me të vërtetë, juve ju ka ardhur një provë bindëse (Muhamedi)⁸, nga Zoti juaj dhe ju është zbritur një Dritë e dukshme (Kurani).”** (En Nisa, 174) Po ashtu, thotë: **“O njerëz! Ju ka ardhur këshillë (Kurani) nga Zoti juaj, shërim për zemrat tuaja, udhëzim dhe mëshirë për besimtarët.”** (Junus, 57) Dhe thotë: **“Vallë, a nuk u mjafton atyre që Ne të kemi shpallur ty Librin që u lexohet atyre? Me të vërtetë që në të ka mëshirë dhe këshillë për njerëzit që besojnë.”** (Ankebut, 51)

Lajmet e fshehta e të vërtetuara, besimet e shëndosha, legjislacionet e drejta dhe moralet e bukura që përmban Kurani i madhërisëm janë argument se ato janë nga Allahu e kurrsesi nuk mund të jenë nga nga ndonjë krijesë a dikush tjetër përveç Tij.

Nisur nga ky fakt, asnjë njeri nuk e mohon realisht ekzistencën e Allahut. Mirëpo, disa kategori ateistësh, në të kaluarën dhe të tashmen, pretendojnë një gjë të tillë, si:

1) Dehrijunët (ata që besojnë në faktorin kohë)

Këta kanë qenë disa filozofë dehrijunë, të cilët besonin se bota është e vjetër dhe e përjetshme. Në kohën tonë, atyre u shëmbëlleshin të ashtuquajturit “ateistët e rinj”. Dehrijunët janë ata që kanë thënë: **“Nuk ka tjetër veç jetës së kësaj bote, vdesim e jetojmë dhe vetëm koha na shkatërron.”** **Ata nuk kanë kurrfarë dijenie për këtë, ata vetëm hamendësojnë ashtu.”** (El Xhathije, 24)

Ata pretendojnë se bota lëviz vetvetiu, se ajo ekziston pafundësisht dhe nuk zhduket! Po ashtu, ata thonë: Barqet janë ato që lindin e toka është ajo që na i kapërdin, rrjedhimisht vetëm koha është ajo që na shkatërron! Ata i lanë krijesat pa Krijues, ndaj Allahu iu kundërpërgjigj me fjalët: **“Ata nuk kanë kurrfarë dijenie për këtë.”** As nga ana logjike, fetare e shqisore, as nga natyra e pastër njerëzore. Madje, pretendimi i tyre nuk është gjë tjetër veçse supozim dhe hamendje. “... ata vetëm hamendësojnë ashtu.”

⁸ *Sal-lallahu alejhi ue selem.*

2) *Natyalistët*

Të cilët deklarojnë se gjithësia është krijuar nga vetë natyra. Rrjedhimisht, gjërat, si: bimët, gjallesat, materiet joorganike dhe veçoritë e tyre, kanë krijuar vetveten dhe lëvizjet e tyre. Kundërpërgjigjja ndaj tyre është shumë e thjeshtë: është e pamundur që diç të jetë krijues dhe i krijuar njëherazi! Allahu i Lartësuar thotë: **“A mos vallë, ata janë krijuar nga hiçi apo mos ata janë krijues të vetvetes?!”** (Et Tur, 35)

Natya, së cilës ia dedikojnë krijimin, është një tërësi e materieve inorganike: e shurdhër, e verbër dhe memece, nuk ka as ndjenja, as ndjesi. E si, vallë, të krijojë krijesa të gjalla që dëgjojnë, shikojnë, flasin, kanë ndjesi dhe ndiejnë dhimbje dhe shpresë?! Ai që nuk ka, s’mund të japë.

3) *Sudfijunët (ata që besojnë në rastësinë)*

Ata që deklarojnë se krijesat janë krijuar në mënyrë të rastësishme, gjë që nënkupton se, mbledhja e atomeve dhe molekulave në mënyrë të rastësishme ka nxjerrë në pah jetën dhe formimin e krijesave të shumëllojshme, pa kurrfarë sistemimi a menaxhimi të mëparshëm. Thjesht, të imagjinuarit e këtij supozimi mjafton për rrëzimin dhe shembjen e tij. Përpikëria e krijimit, sistemi i tij i mrekullueshëm, vazhdimësia e ligjeve të tij konsekuente dhe balancimi i përsosur e bëjnë të pamundur pretendimin se krijesat janë krijuar rastësisht. Allahu i Lartësuar thotë: **“E tillë është fuqia e Allahut, i Cili ka përsosur çdo gjë.”** (En Neml, 88) Gjithashtu, thotë: **“Allahu është Ai, që ka krijuar shtatë qiej dhe po aq toka. Urdhrat e Tij zbresin përmes tyre, që ju ta dini se Allahu është i Fuqishëm për çdo gjë dhe se Ai përfshin gjithçka në diturinë e Tij.”** (Et Talak, 12)

4) *Komunistët*

Komunistët janë pasuesit e Karl Marksit, të cilët deklarojnë: Zoti nuk ekziston, jeta është thjesht materie.

Meqë shtetin e tyre, Bashkimin Sovjetik, e formuan mbi këtë breg të rrënuar dhe besim të kotë, ra për një kohë të shkurtër dhe u copëtua në shtetthe të shumta.

5) Individë të veçuar përgjatë historisë

Bie fjala, Faraoni, që hiqej sikur mohonte Zotin, duke thënë: **“E ç’është Zoti i botëve?”** (Esh Shuara, 22) Më pas, këtë gjë (të qenët Zot) ia atribuoi vetes, kur tha: **“Unë jam Zoti juaj më i lartë!”** (En Naziat, 24). Pastaj vazhdoi dhe pretendoi hyjnizimin e vetes, duke thënë: **“Unë nuk di që për ju ka tjetër zot (hyjni) përveç meje!”** (El Kasas, 38) Ai e kërcënoi Musain, *alejbi selam*, duke i thënë: “(Faraoni) tha: “Nëse ti e merr për zot (hyjni) tjetërkënd, përveç meje, me siguri, do të të fus në burg!” (Esh Shuara, 28)

Edhe Nemrudi, që kishte bërë fjalë me Ibrahimin, *alejbi selam*, për Zotin e tij: **“Kur Ibrahim i tha: “Zoti im është Ai që jep jetë dhe shkakton vdekje” - ai u përgjigj: “Edhe unë mund të jap jetë e të shkaktoj vdekje.” Ibrahim pastaj i tha: “Allahu e sjell Diellin nga lindja. Sille ti nga perëndimi!” Atëherë, ai (mohuesi) mbeti gojëhapur. Allahu nuk i udhëzon ata që janë keqbërës.”** (El Bekare, 258)

Të gjithë ata kanë qenë në kontradiktë me vetveten dhe në kundërshti me natyrshmërinë e tyre, gjë të cilën e ka dëshmuar Allahu kundër tyre me fjalët: **“Kështu, ata i mohuan ato padrejtësisht dhe me mendjemadhësi, edhe pse shpirti i tyre i besonte për të vërteta. Pa shiko, cili ka qenë fundi i shkatërrimtarëve!”** (En Neml, 14) Mu për këtë këta njerëz nuk zënë vend në asnjë listë të njerëzve autoritarë e nuk lënë gjurmë në histori.

II. Besimi në zotërimin e Tij

Besimi në zotërimin e Tij (rububije) nënkupton bindjen e palëkundshme se vetëm Allahu i Lartësuar është Zoti, Krijuesi, Sunduesi dhe Urdhëruesi. Fjala Zot d.m.th. Zotëria, Sunduesi, Zotëruesi i çështjeve, i Cili me mirësitë e Tij kujdeset për të gjitha krijesat. Allahu i Lartësuar thotë: **“(Faraoni) tha: “E, kush është Zoti juaj, o Musa?” (Musai) tha: “Zoti ynë është Ai që çdo gjëje i ka dhënë trajtën e vet e pastaj e ka udhëzuar.”** (Ta Ha, 49-50)

Rreth sferës së zotërimit të Allahut sillen tri çështje:

1. Krijimi

Allahu është Krijues i çdo gjëje dhe gjithçka përveç Tij është e krijuar. Ai, i Lartësuar, thotë: **“Allahu është Krijuesi i çdo gjëje dhe Ai është Mbikëqyrës**

i çdo gjëje.” (Ez Zumer, 62) Dhe thotë: **“... i Cili ka krijuar çdo gjë dhe e ka rregulluar si duhet.”** (El Furkan, 2) Çdo lloj krijimi që i dedikohet dikujt përveç Allahut është krijim relativ, që nënkupton formimin, hartimin e diçkaje dhe paracaktimin, e jo krijimin nga asgjëja, siç thotë i Lartësuar: **“Qoftë i Lartësuar Allahu, Krijuesi më i përsosur!”** (El Muminun, 14)

2. Sundimi

Allahu është Sunduesi, e të tjerët përveç Tij janë të sunduar. Allahu i Lartësuar thotë: **“A nuk e di ti se vetëm Allahut i përket sundimi i qiejve dhe i Tokës? Përveç Allahut ju nuk keni tjetër mbrojtës e as ndihmës.”** (El Bekare, 107) Gjithashtu, thotë: **“Allahut i përket sundimi i qiejve dhe i Tokës dhe (vetëm) Allahu është i Fuqishëm për çdo gjë.”** (Alu Imran, 189) Njashtu, thotë: **“Thuaj (o Muhamed): “O Allah, Zotëruesi i gjithë Pushtetit! Ti ia jep pushtetin kujt të duash dhe ia heq kujt të duash...”** (Alu Imran, 26) Po ashtu thotë: **“... nuk ka ortak në pushtet...”** (El Isra, 111) Dhe thotë: **“Ky është Allahu, Zoti juaj. Pushteti është i Tij! Kurse ata që ju i adhuroni krahas Tij, nuk zotërojnë as sa cipa e bërthamës së hurmës.”** (Fatir, 13) Çdo sundim që i dedikohet dikujt tjetër përveç Allahut është sundim i kufizuar, i përkohshëm dhe i pjesshëm, sikurse qëndron në fjalën e Tij: **“O populli im, sot juve ju përket pushteti i Tokës...”** (Gafir, 29) Dhe në fjalën e Tij: **“... ose me atë që e keni në pushtetin tuaj.”** (En Nisa, 3) Ndërkaq, sundimi i plotë e absolut i takon vetëm Allahut të Lartmadhërishtëm. Allahu thotë: **“Vërtet, jemi Ne që e trashëgojmë Tokën dhe gjithçka që gjendet në të dhe ata te Ne do të kthehen.”** (Merjem, 40)

Urdhri

Allahu është Urdhëruesi, kurse të tjerët përveç Tij janë të urdhëruar. Allahu i Lartësuar thotë: **“Thuaju (o Muhamed!): “Të gjitha janë në dorë të Allahut!”** (Alu Imran, 154) Gjithashtu, thotë: **“Vetëm Atij i përket Krijimi dhe Urdhërimi. Qoftë i bekuar Allahu, Zoti i botëve!”** (El Araf, 54) Dhe thotë: **“Atëherë merr fund puna! Tek Allahu kthehen të gjitha punët.”** (El Bekare, 210) Gjithashtu, të Dërguarit të Tij, *sal-lallahu alejhi ue selem*, i ka thënë: **“Ti nuk ke asgjë në dorë...”** (Alu Imran, 128) E ç’mund të thuash për të tjerët pos tij?! Po ashtu, thotë: **“Me të vërtetë, është vendimi i Allahut, si për të parën dhe për të dytën.”** (Er Rum, 4) Vetëm Allahu është Urdhëruesi i

krijësive të Tij. E, ai urdhër që iu dedikohet dikujt tjetër, përveç Tij, siç qëndron në fjalën e Tij: **“... por paria shkoi pas urdhrin të Faraonit, ndonëse urdhri i Faraonit nuk ishte i drejtë”** (Hud, 97), është urdhër i kufizuar, që hyn nën dëshirën e Tij: nëse do, e përmbush; e, nëse do, e pamundëson.

Urdhri i Allahu të Lartësuar përfshin urdhrin e Tij që ka të bëjë me ligjet e universit dhe atë fetar. Gjithsesi, urdhri universal është ekzekutiv dhe është sinonim i dëshirës (së Allahut). Allahu i Lartësuar thotë: **“Vërtet, urdhri i Tij, kur Ai dëshiron diçka, është që t’i thotë asaj “bëhu!” - dhe ajo bëhet.”** (Ja Sin, 82) Ndërkaq, urdhri fetar është për të vënë në provë dhe është sinonim i dashurisë (së Allahut për atë gjë): mund të ndodhë dhe të mos ndodhë. E tërë kjo hyn në dëshirën gjithëpërfshirëse të Allahut, ashtu siç thotë: **“... për secilin nga ju që dëshiron të ndjekë rrugën e drejtë. Por ju nuk mund të dëshironi, përveçse me vullnetin e Allahut, Zotit të botëve!”** (Et Tekvir, 28-29)

Cilësitë e tjera të Allahut të Lartësuar që kanë të bëjnë me zotërimin e Tij kthehen te këto të tria: krijimi, sundimi dhe urdhri, si: dhënia e rrishtit, dhënia e jetës, shkaktimi i vdekjes, lëshimi i shiut, kultivimi i tokës, lëvizja e erërave, lundrimi i anijeve, ndërrimi i natës me ditën, shtatzënia, lindja, shëndeti, sëmundja, krenaria, nënçmimi etj.

Besimi në zotërimin e Allahut të Lartësuar është i ngulitur në natyrshmërinë e pastër njerëzore, që konceptohet me intuitën e mendjeve, është ndijor në këtë univers dhe është përmendur shumë në tekstet fetare.

Ndër argumentet e saj në Librin e Allahut janë këto vargje kuranore: **“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës, në këmbimin e natës me ditën, në anijet që lundrojnë nëpër det për t’u sjellë dobi njerëzve, në ujin që Allahu zbret prej qiellit, duke ngjallur përmes tij tokën e vdekur dhe duke shpërndarë gjithfarë gjallesash, në lëvizjen e erërave dhe në retë që qëndrojnë midis qiellit e Tokës, pra, në të gjitha këto, sigurisht që ka shenja për njerëzit me intelekt.”** (El Bekare, 164)

“Ti bën që nata të hyjë te dita dhe që dita të hyjë te nata. Ti e nxjerr të gjallën prej së vdekurës dhe të vdekurën e nxjerr prej së gjallës. Ti i jep kujt të duash pa kufij.” (Alu Imran, 27)

“Me të vërtetë, Allahu është Ai që farën dhe bërthamën e bën të mugullojë. Ai e nxjerr të gjallën prej së vdekurës dhe të vdekurën prej së gjallës. Ky është Allahu. Atëherë, përse i largoheni Atij? Ai bën të feksë drita e agimit. Ai e ka bërë natën për pushim, ndërsa Diellin dhe Hënën për të njehsuar kohën. Kjo është urdhëresa e Allahut, të Plotfuqishmit dhe të Gjithëdijshmit. Është Ai që i ka krijuar yjet, për t’ju rrëfyer rrugën në errësirat e tokës dhe të detit. Ne ua kemi shpjeguar qartë shpalljet Tona njerëzve që dinë. Është Ai që ju ka krijuar prej një njeriu të vetëm, që të jetoni dhe të preheni në tokë. Ne ua kemi shpjeguar qartë shpalljet Tona njerëzve që kuptojnë. Është Ai që lëshon nga qielli ujë, nëpërmjet të cilit Ai nxjerr sythat e çdo bime. Prej kësaj Ne nxjerrim gjelbërim, kokrra gruri në kallinj, palma hurma të ngarkuara me kalaveshë të ulët, kopshte rrushi, ulliri dhe shege, që ngjajnë, por që janë të ndryshëm nga njëri-tjetri. Vështroni frutat e tyre kur formohen dhe piquen. Sigurisht që në këto ka shenja për njerëzit që besojnë.” (El Enam, 95-99)

“Allahu është Ai që qiejt i ka ngritur me shtylla, të cilat nuk mund t’i shihni e më pas është ngritur mbi Fron. Ai ka nënshtruar Diellin dhe Hënën; të gjitha këto rrotullohen për një kohë të caktuar. Ai i drejton të gjitha çështjet dhe i shpjegon në hollësi shpalljet, me qëllim që ju të bindeni se do të takoheni me Zotin tuaj. Është Ai që e ka shtrirë tokën, duke krijuar në të male dhe lumenj. Dhe për çdo lloj frute, Ai ka krijuar nga një çift. Ai ka bërë që nata ta mbulojë ditën. Me të vërtetë, në këto ka shenja për njerëzit që mendojnë.” (Er Rad, 2-4)

“Ai i ka krijuar qiejt dhe Tokën me urtësi. I lartësuar qoftë Ai mbi gjithçka që ia shoqërojnë (në adhurim)! Ai e ka krijuar njeriun prej një pike fare, por ja që ky bëhet kundërshtar i hapët! Kafshët Ai i ka krijuar për ju. Nëpërmjet tyre ju siguron rroba të ngrohta dhe dobi të tjera. Prej tyre ju ushqeheni dhe shikoni pamje të bukura, kur i ktheni nga kullota dhe, kur i nxirrni në kullotë. Ato mbajnë barrët tuaja deri në vende të largëta, te të cilat ju do të arrinit me mundim të madh; me të vërtetë, Zoti juaj është i Butë dhe Mëshirëplotë. (Ai ka krijuar) edhe kuajt, mushkat dhe gomarët, që ju t’i shaloni dhe t’i mbani për bukuri. Ai krijon edhe gjëra që ju nuk i dini. Allahut i takon që t’ju tregojë rrugën e drejtë, kur ka

prej tyre edhe të shtrembra; sikur të donte Allahu, do t'i udhëzonte të gjithë. Është Ai që zbret nga qielli shi, i cili ju siguron ujë për të pirë dhe bën që të rriten bimët, që shërbejnë si ushqim për kafshët. Nëpërmjet tij (ujit) rriten të lashtat, ullinjte, palmat, rrushi dhe fruta të llojlojshme. Këtu ka vërtet tregues (të fuqisë hyjnore) për njerëzit, që kuptojnë. Ai ka bërë që ju ta shfrytëzoni natën dhe ditën, Diellin dhe Hënën. Edhe yjet janë vënë në shërbimin tuaj me urdhrin e Tij. Njëmend, në këto ka shenja për njerëzit që mendojnë. Ai ka krijuar në Tokë për ju çdo gjë me ngjyra dhe cilësi të ndryshme. Natyrisht që në këto ka shenja për njerëzit që ua vënë veshin. Është Ai që ju ka vënë në shërbim detin, që ju të hani prej tij mish të freskët dhe të nxirrni nga ai stolitë që mbani. Ti sheh sesi anijet e çajnë atë, që ju të kërkoni mirësitë e Allahut dhe të jeni mirënjohës. Ai ka vendosur male të palëvizshme në Tokë, që ajo të mos tundet bashkë me ju, dhe ka krijuar lumenj e rrugë për të arritur aty ku synoni. Ai ka vënë edhe shenja të tjera, si dhe yjet, nëpërmjet të cilave njerëzit orientohen. Atëherë, a është njësoj si Ai që krijon, si ai që nuk krijon?! A nuk po merrni vesh? Nëse do t'i numëronit mirësitë e Allahut, nuk do të mund t'i llogarisnit ato. Allahu është vërtet Falës dhe Mëshirëplotë.” (En Nahl, 3-18)

“Me të vërtetë, Ne e kemi krijuar njeriun prej palcës së baltës, e pastaj, e bëmë atë pikë fare dhe e vumë në një vend të sigurt (mitër). E mandej, pikën e farës e bëmë droçkë gjaku, e pastaj e bëmë copëz mishi pa formë; mandej, me atë mish bëmë eshtrat, pastaj i veshëm eshtrat me mish dhe pastaj e bëmë atë (njeriun) krijesë tjetër (duke i futur shpirtin). Qoftë lartësuar Allahu, Krijuesi më i përsosur! Mandej, pas kësaj ju do të vdisni, pastaj, ju me siguri që do të ringjalleni në Ditën e Kiametit. Ne kemi krijuar mbi ju shtatë qiej dhe nuk jemi të pakujdesshëm ndaj krijesave Tona. Ne zbresim ujë nga qielli me masë të caktuar, pastaj e depozitojmë atë në Tokë. Por, nëse dëshirojmë, Ne jemi në gjendje ta heqim atë tërësisht. Nëpërmjet tij (ujit), Ne bëjmë për ju kopshte hurmash dhe rrushi, ku ka shumë fruta për të ngrënë, si dhe pemën (e ullirit) që rritet në malin e Sinait e që u jep vaj dhe mëlmesë atyre që e hanë. Vërtet, edhe te bagëtitë për ju ka shenja (për të medituar): ju pini atë që gjendet në barkun e tyre, hani

mishin e tyre, nxirrni shumë dobi të tjera dhe udhëtoni me to, ashtu siç udhëtoni me anije.” (El Muminun, 11-22)

“A nuk e vëren ti se Allahu i shtyn retë ngadalë e pastaj i bashkon e i grumbullon njëren mbi tjetrën, derisa të shohësh shiun sesi del prej tyre dhe bie nga qielli?! Ai, prej reve të mëdha si mali, lëshon breshrin e me të godet kë të dojë, kurse e shmang prej kujt të dojë. Shkëlqimi i vetëtimës së tij gati t’i merr sytë. Allahu ndërron ditën dhe natën. Me të vërtetë, në këto (dukuri natyrore) ka mësim për ata që kanë mend. Allahu ka krijuar çdo lloj kafshe prej ujit; disa nga ato ecin me barkun e tyre, një pjesë ecin me dy këmbë e disa prej tyre me katër këmbë. Allahu krijon çfarë të dojë. Me të vërtetë, Allahu është i Fuqishëm për çdo gjë.” (En Nur, 43-45)

“A nuk e ke parë ti sesi Zoti yt e ka zgjatur hijen?! Sikur të kishte dashur, do ta bënte të pandryshueshme? Pastaj Ne e kemi bërë Diellin udhëzues të saj, pastaj e tërheqim atë (hijen), dalëngadalë pranë Vetes. Dhe është Ai që jua ka bërë natën mbulesë dhe gjumin pushim, kurse ditën jua ka bërë për të lëvizur. Është Ai që i dërgon erërat si lajmëtarë të gëzueshëm para mëshirës së Tij, duke lëshuar prej qiellit ujë të pastër, që nëpërmjet tij të ngjallim vendin e vdekur dhe t’u japim ujë kafshëve dhe shumë njerëzve që Ne i kemi krijuar. Ne e kemi përsëritur (dhuntinë) që të vënë veshin, por shumica e njerëzve kundërshtojnë e janë mosmirënjohës. Sikur të donim Ne, do të dërgonim në çdo qytet paralajmërues. Mos i dëgjo mohuesit, por luftoju ata me forcë ndërmjet këtij (Kuranit). Është Ai që i ka lënë të lirë dy ujëra: njëri i pijshëm e i ëmbël, kurse tjetri i njelmët e i hidhur, duke ngritur pengesë e kufi të prerë ndërmjet tyre. Është Ai që ka krijuar prej ujit njeriun, e ka vënë në lidhje me fis nga gjaku dhe nga martesat. Zoti yt është i Plotfuqishëm.” (El Furkan, 45-54)

“Prandaj lavdërojeni Allahun kur bie muzgu dhe kur gdhin drita! Për Atë është falënderimi në qiej dhe në Tokë, në mbrëmje dhe në mesditë. Ai krijon të gjallën prej së vdekurës, krijon të vdekurën prej së gjallës dhe e gjallëron tokën pas shkretimit të saj. Në të njëjtën mënyrë do të ktheheni edhe ju në jetë. Një prej shenjave të Tij është që Ai ju krijoj prej dheut, pastaj ja, tashmë ju jeni njerëz të shpërndarë në të

gjitha anët. Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja për njerëzit që mendojnë. Ndërmjet shenjave të Tij janë krijimi i qiejve e i Tokës dhe shumëllojshmëria e gjuhëve dhe e ngjyrave (racave) tuaja. Pa dyshim, në këtë ka shenja për ata që dinë. Të tjera shenja të Tij janë gjumi juaj natën e ditën dhe kërkesa juaj nga dhuntitë e Tij. Vërtet, në këtë ka shenja për njerëzit që dëgjojnë. Gjithashtu, prej shenjave të Tij janë paraqitja e vetëtimës si frikë e shpresë dhe dërgimi i shiut prej qiellit, që nëpërmjet tij të gjallërohet toka pas shkretimit të saj. Sigurisht, në këtë ka shenja për njerëzit që mendojnë. Dhe një prej shenjave të Tij është që qiejt dhe Toka qëndrojnë sipas urdhrit të Tij, pastaj, kur Ai t’ju thërrasë me një të thirrur, ju përnjëherë do të dilni nga toka (të ringjallur), Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë. Gjithçka i përulet Atij. Ai e zë fill krijimin dhe Ai e përsërit atë e për Të kjo është edhe më e lehtë. Atij i përket shembulli më i lartë në qiej dhe në Tokë. Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti.” (Er Rum, 17-27)

“I Gjithëmëshirshmi ua ka mësuar Kuranin (robërve të Tij), ka krijuar njeriun dhe i ka mësuar atij të folurit e qartë. Dielli dhe Hëna ndjekin rrugën e caktuar, bimët dhe pemët i përulen (Allahut). Ai e ka ngritur qiellin lart dhe ka vënë balancën (për çdo gjë), që ju të mos e shkelni atë. Prandaj matni drejt e mos hani në peshë! Ai e ka bërë Tokën për krijesat. Aty ka fruta të llojllojshme dhe palma hurmash me frutat si bistakë, ka drithëra me gjethe e kërcej dhe bimë me erë të mirë. Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?!⁹ Ai e krijoi njeriun prej baltës së thatë, ashtu si vorba, ndërsa xhinët i krijoi prej flakës së zjarrit. Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?! (Ai është) Zoti i dy lindjeve dhe i dy perëndimeve.¹⁰ Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?! Ai i ka lëshuar dy dete¹¹ që të takohen, por, midis tyre ka një pengesë që nuk mund ta kapërcejnë. Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?! Prej tyre nxirren margaritarë dhe korale. Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?! Atij i përkasin edhe

9 Këtu fjala u drejtohet njerëzve dhe xhinëve. Ky varg përsëritet 31 herë në këtë sure.

10 Sipas disa komentuesve të Kuranit, bëhet fjalë për pikat e lindjes dhe perëndimit të diellit në verë dhe në dimër.

11 Ujin e kripur dhe ujin e ëmbël.

anijet që lundrojnë nëpër dete e që lartohen si male. Pra, cilat dhunti të Zotit tuaj po i mohoni?! (Err Rrahman, 1-25)

“A nuk jua kemi bërë Tokën si shtrat e malet si shtylla?! Ne ju kemi krijuar në çifte dhe gjumin jua kemi bërë për prehje. Natën jua kemi bërë mbulesë, ndërsa ditën e kemi caktuar për të punuar. Mbi ju kemi ndërtuar shtatë qiej të fortë dhe kemi vënë kandil (Diell) të shndritshëm! Nga retë Ne ju lëshojmë ujëra të bollshme për rritjen e drithërave, bimëve dhe kopshteve të dendura.” (En Nebe, 6-16)

“Cili është më i vështirë: krijimi juaj apo i qiellit, të cilin Ai e ndërtoi, ia ngriti lart kupën dhe e përsosi? Netët i bëri të errëta, kurse ditët të ndritshme. Pastaj e shtriu rrafsh Tokën, dhe, nga ajo nxori ujërat dhe bëri kullotat, kurse malet i bëri të patundshme, që t’i gëzoni, ju dhe bagëtitë tuaja.” (En Naziat, 27-33)

“Le të mendojë njeriu për ushqimin e vet: jemi Ne që lëshojmë ujë me bollëk, pastaj e çajmë tokën në thellësi dhe nxjerrim prej saj drithërat, rrushin e perimet, ullirin e palmat, kopshtet e dendura, pemët dhe gjithë barërat, që t’i gëzoni ju dhe bagëtitë tuaja.” (Abese, 24-32)

Shumica e njerëzve, e pohojnë tërësisht njëshmërinë e zotërimit të Allahut të Lartësuar; se Ai është Krijuesi, Sunduesi, Drejtuesi i çdo çështjeje. Madje, edhe për idhujtarët arabë Allahu në Librin e Tij ka treguar në shumë vende se e miratonin një gjë të tillë, si fjala e Tij: “Thuaj: “E kujt është Toka dhe gjithçka që gjendet në të, nëse e dini?” Ata do të thonë: “Të Allahut!” E ti thuaju: “Vallë, a nuk po ia vini veshin?” Thuaj: “Kush është Zoti i shtatë qiejve dhe Zoti i Fronit Madhështor?” Ata do të thonë: “Allahu!” E ti thuaju: “Vallë, a nuk keni frikë ju?” Thuaj: “Kush është Ai që ka në dorë pushtetin mbi çdo gjë, i Cili mbron, por prej Tij nuk mund të mbrohet askush, nëse e dini?” Ata thonë: “Allahu.” E ti thuaju: “Atëherë, përse magjepseni?!¹² (El Muminun, 84-89) Dhe fjala e Tij: “Nëse ti i pyet ata: “Kush i ka krijuar qiejt dhe Tokën?” Ata, me siguri, do të thonë: “Ato i ka krijuar i Plotfuqishmi dhe i Gjithëdijshmi.” (Ez Zuhruf, 9)

¹² Pra, përse magjepseni nga besimet tuaja të kota deri në atë pikë sa të mos i nënshtroheni Atij që në dorë ka gjithçka?!

Në këtë kapitull ka ndodhur një devijim i pjesshëm nga ana e grupeve të ndryshme. Kjo, se i kanë shoqëruar Allahut të tjerë në zotërimin e Tij, si:

1) *Dualistët zaratustër dhe manibeistë*

Të cilët deklarojnë se bota i ka dy krijues: zotin e dritës, i cili krijon të mirën; dhe atë të errësirës, i cili krijon të keqen. Ata janë të pajtimit se drita është më e mirë sesa errësira, kurse janë në kontradiktë se a është errësira e vjetër apo e re.

2) *Të krishterët*

Të cilët besojnë në trini. Zoti i Vetëm, sipas pretendimit të tyre, është tri qenie hyjnore: Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë.

Por, ata nuk pohojnë se në botë ka tre zota, të ndarë nga njëri-tjetri. Madje, ata pajtohen rreth asaj se Krijuesi i botës është Një.

3) *Idhujtarët arabë*

Të cilën kanë pasur bindjen se zotat e tyre (të rremë) posedonin dobi, dëm, drejtimit të çështjeve, si dhe e kërkonin fatin në fall.

4) *Kaderitë mobues*

Të cilët deklarojnë: “Njeriu e krijon veprën e tij”, në mënyrë të pavarur nga Allahu.

Të gjitha këto mendime të devijuara hidhen poshtë me argumentin e natyrës së pastër njerëzore, të mendjes, të ndijimit dhe të fesë (të cilat argumentojnë) njëshmërinë e Zotit të Lartësuar në krijimin, sundimin dhe urdhrin e Tij. Allahu i Lartësuar thotë: **“Allahu nuk ka zgjedhur për Vete ndonjë bir dhe përveç Tij s’ka asnjë zot tjetër, përndryshe çdo zot do të merrte atë që ka krijuar dhe do të ngriheshin njëri mbi tjetrin. Qoftë i lartësuar Ai nga shpifjet e tyre!”**¹³ (El Muminun, 91) I Adhuruari i vërtetë doemos duhet të jetë Krijues, Veprues i gjithçkaje që dëshiron. Po të kishte (Allahu) ortak, do të krijonte e do të vepronte! Kështu që, ky rast nuk ka alternativë tjetër pos këtyre dyjave:

E para: Ose çdo zot të marrë atë që ka krijuar dhe të jetë i pavarur në pushtetin e tij, gjë që këtë mundësi nuk e pranon përpikëria e kësaj bote.

¹³ Kjo është logjikë shumë e pastër për të argumentuar njëshmërinë e Allahut. Ç’është e vërteta, vetëm kjo njëshmëri bën që Allahu i Lartmadhëruar të mos përfshihet në zënkat “hyjnore” të përshtatshme për mitologjitë politeiste.

E dyta: Ose të përpiqen për ta mposhtur dhe për të dominuar mbi njëri-tjetrin, që, ndërsa njëri dëshiron të lëvizë një objekt, tjetri dëshiron që të mos lëvizë; apo nëse ndonjëri prej tyre dëshiron ngjalljen e ndonjë gjëje, tjetri dëshiron që ta lërë të vdekur. Rrjedhimisht, ose do të arrihet dëshira e të dyve, ose i ndonjërit prej tyre, ose nuk do të arrihet dëshira e asnjërit. Dëshira e parë dhe e tretë është e paarritshme, ngase janë dy të kundërta, që nuk mund të bashkohen dhe as të ngrihen bashkërisht.¹⁴ Prandaj, doemos duhet të jetë e dyta. Atij që i përmbushet dëshira, është i Adhuruari, i Fuqishmi; kurse tjetrit, të cilit nuk i realizohen dot dëshirat, nuk është i denjë për t'u adhuruar. Së këndejmi, çështja kthehet në pohimin e Një Zoti të Vetëm; Krijuesi të Vetëm; Sunduesi të Vetëm dhe Sistemuesi të Vetëm të çështjeve. Kjo është ajo që njihet si *argumenti i pamundësisë*.

III. Besimi në uluhijen e Tij (njëshmërinë e adhurimit)

Ky besim nënkupton bindjen e palëkundshme se Allahu i Vetëm është i Adhuruari i Vërtetë që e meriton adhurimin. Fjala el Ilah e ka kuptimin i **Adhuruari**; të cilin e adhurojnë zemrat me dashuri dhe madhërim. Realiteti i adhurimit nënkupton kulmin e dashurisë, përvuljes, nënshtrimit dhe madhërimit. Kjo nuk i takon askujt, përveç të Adhuarit të Vetëm (Allahu). Me këtë besim ka ardhur dëshmia më e madhe (la ilahe il-lallah), nga Dëshmuesi më i madh (Allahu), për të dëshmuarën më të madhe (teuhidin). Allahu i Lartësuar thotë: **“Allahu dëshmon, e po ashtu edhe engjëjt, edhe njerëzit e dijes, se nuk ka zot tjetër që meriton të adhurohet përveç Tij, duke mbajtur drejtësinë. S’ka zot tjetër që meriton të adhurohet përveç Tij, të Plotfuqishmit, të Urtit.”** (Alu Imran, 18) Gjithashtu, Ai thotë: **“Zoti juaj është një Zot i vetëm! S’ka zot tjetër (të denjë për adhurim), përveç Tij, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!”** (El Bekare, 163)

Allahu i ka krijuar të gjitha krijesat e Tij: njerëzit dhe xhinët, për ta adhuruar vetëm Atë, megjithëse Ai është i Vetëmjaftueshëm e nuk ka aspak nevojë për ta. Allahu i Lartësuar thotë: **“Xhinët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë. Unë nuk kërkoj prej tyre rrisht, as nuk dëshiroj që të Më ushqejnë.”** (Edh Dharijat, 56-57) Të gjithë peygamberët ua ka dërguar njerëzve për ta realizuar këtë besim, për t’i ftuar që ta veçojnë Atë në adhurim dhe për

¹⁴ Që nënkupton se medoemos njëra dëshirë do të realizohet, e tjetra jo. Rrjedhimisht, nuk ka mundësi që asnjëra të mos realizohet. Shënim i përkthyesit.

ta flakur idhujtarinë. Allahu i Lartësuar thotë: **“Çdo populli Ne i çuam një të dërguar (që u thoshte): “Adhuroni Allahun dhe shmangni idhujt.”** (En Nahl, 36) Popullit të tyre së pari u thanë: **“O populli im! Adhuroni Allahun, ju nuk keni zot tjetër (të denjë për adhurim) përveç Tij!”** (El Araf: 59, 65, 73, 85) Allahu i Lartësuar thotë: **“Ne nuk kemi nisur asnjë të dërguar para teje, që të mos i kemi shpallur: “S’ka zot tjetër (të denjë për adhurim) përveç Meje, andaj më adhuroni (vetëm) Mua.”** (El Enbija, 25)

Realizimi i këtij besimi nënkupton që të gjitha adhurimet duhet t’i dedikohen vetëm Allahut. Ai që ndonjë adhurim ia kushton dikujt tjetër përveç Allahut, është idhujtar, jobesimtar. Adhurimet ndahen në disa lloje:

1. *Adhurimet e zemrës*

Siç është *dashuria*: Allahu i Lartësuar thotë: **“E, megjithatë, disa njerëz zgjedhin (për të adhuruar) në vend të Allahut (zota) të tjerë, (duke i konsideruar) si të barabartë me Të dhe duke i dashur siç duhet Allahu. Por ata që besojnë, e duan shumë më tepër Allahun (se idhujtarët idhujt e tyre).”** (El Bekare, 165)

Frika: Allahu i Lartësuar thotë: **“Ju mos iu frikësoni atyre, por frikësohuni prej Meje, nëse jeni besimtarë!”** (Alu Imran, 175)

Shpresa: Allahu i Lartësuar thotë: **“Thuaj: “Unë jam vetëm një vdekatar si ju, që më është shpallur se Zoti juaj është një Zot i Vetëm. Kështu, kush shpreson takimin me Zotin e vet, le të bëjë vepra të mira dhe të mos i shoqërojë askënd në adhurim Zotit të vet!”** (El Kehf, 110) Këto të tria janë baza e adhurimeve të zemrës. Allahu i Lartësuar thotë: **“Vetë ata që idhujtarët u luten, kërkojnë t’i afrohen Zotit të tyre, madje edhe më të afërtit, duke shpresuar mëshirën e Tij dhe duke iu frikësuar dënimit të Tij.¹⁵ Me të vërtetë, nga dënimi i Zotit tënd duhet të ruhet gjithkush.”** (El Isra, 57) Nuk duhet kufizuar vetëm te disa prej tyre kundrejt të tjerave. Pra, ai që e adhuron Allahun vetëm me frikë, është *harurij*¹⁶. Ai që e adhuron

15 Vargjet 56-57 aludojnë për engjëjt, profetët ose shenjtorët që politeistët i hyjnjorë, duke menduar se ata mund të jenë ndërmjetës për të fituar mëshirën e Allahut.

16 *Harurij* është njëri nga emërtimet e havarixhëve. Më tutje autori do të flasë më tepër rreth tyre. Shënim i përkthyesit.

Allahun vetëm me shpresë, është *murxhi*¹⁷. Ai që e adhuron Allahun vetëm me dashuri, është *zindik*¹⁸. Ndërkaq, ai që e adhuron Allahun me dashuri, frikë dhe shpresë, është monoteist, besimdrejtë.

Rregullimi i zemrës është bazë e rregullimit të trupit, siç qëndron në hadithin: “*Vini re, në trupin e njeriut është një copë mish, që, nëse ajo është në rregull, tërë trupi është në rregull, por, nëse ajo prishet, prishet i tërë trupi. Kini kujdes, ajo është zemra.*” (E shënojnë Buhariu dhe Muslimi)¹⁹

2. Adhurimet me fjalë

Siç është lutja: Allahu i Lartësuar thotë: “**Xhamitë i janë kushtuar vetëm Allahut, prandaj mos i lutni askujt, krahas Allahut.**” (El Xhin, 18)

Kërkimi i mbështetjes: Allahu i Lartësuar thotë: “**Thuaj: “Kërkoj mbështetje te Zoti i agimit.”** (El Felek, 1) “Thuaj: “Kërkoj mbështetje te Zoti i njerëzve.” (En Nas, 1)

Kërkimi i ndihmës: Allahu i Lartësuar thotë: “**Ju kërkua ndihmë nga Zoti juaj e Ai ju përgjigj...**” (El Enfal, 9)

Përmendja e Allahut (dbikri), me llojet e saj: Allahu i Lartësuar thotë: “**O besimtarë, përmendeni shpesh Allahun...!**” (El Ahzab, 41)

Leximi (i Kuranit): Allahu i Lartësuar thotë: “**Lexo (o Muhamed) atë që të është zbritur prej Librit (Kuranit)!**” (El Ankebut, 45)

Fjalët e bukura në përgjithësi: Allahu i Lartësuar thotë: “**Tek Ai ngjiten fjalët e bukura...**” (El Fatir, 10), si dhe të tjera.

3. Adhurimet trupore

Siç janë *namazi* dhe *therja e kurbanit*: Allahu i Lartësuar thotë: “**Thuaj: “Në të vërtetë, namazi im, kurbanimi im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve.”** (El Enam, 162) Gjithashtu, Ai thotë: “**Andaj, falu (vetëm) për Zotin tënd dhe ther kurban!**” (El Keuther, 2)

¹⁷ *Murxhi* janë ata që e kanë nxjerrë veprën prej nocionit të besimit dhe kanë thënë se ai është i njëjtë të gjithë besimtarët. Në vijim autori do të flasë më gjerësisht rreth tyre. Shënim i përkthyesit.

¹⁸ *Zindik* është ai që e shfaq Islamin, por e fsheh mohimin. I tilli është hipokrit (munafik). Shënim i përkthyesit.

¹⁹ Buhariu (52) dhe Muslimi (1599), përcjellë nga Numan ibn Beshiri, *Allahu qoftë i kënaqur me ta!*

Tavafi (rrotullimi rreth Qabesë): Allahu i Lartësuar thotë: “... dhe le t'i vijjë rrotull Shtëpisë së lashtë (Qabesë).” (El Haxh, 29)

Largimi i pengesës nga udha: I Dërguari, *sal-lallahu alejbi ue selem*, duke i përmendur degët e besimit, kishte thënë: “*Shkalla më e ulët e besimit është largimi i pengesës nga udha*”²⁰, si dhe të tjera.

4. Adhurimet që lidhen me pasurinë

Ku hyjnë shpenzimet që janë akte adhurimi, si: *zekatet, lëmoshat, testamentet, vakëfet dhe dburatat*: Allahu i Lartësuar thotë: “Lëmosha e zekatit është vetëm për të varfrit, për nevojtarët, për ata që janë ngarkuar me mbledhjen dhe administrimin e tij, për ata, zemrat e të cilëve duhen përfitur, për lirim të skllëvërve, për të rënduarit nga borxhet, për (luftëtarët në) rrugën e Allahut dhe për udhëtarët e mbetur rrugëve. Këto janë detyrat e vëna prej Allahut. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshtëm dhe i Urtë.” (Et Teube, 60) Gjithashtu, i Lartësuar thotë: “Po ka nga beduinët të atillë që besojnë Allahun dhe Ditën e Kiametit dhe shpenzimin (në rrugë të Allahut) e quajnë si mjet për t’iu afruar Allahut dhe për të merituar bekimin e të Dërguarit. Dhe vërtet që kjo do t’u sjellë afrimin: Allahu do t’i pranojë ata në mëshirën e Vet. Njëmend, Allahu është Falës i madh dhe Mëshirëplotë.” (Et Teube, 99)

Dhënia ushqim (të varfërve): Allahu i Lartësuar thotë: “Ata i ushqejnë të varfrit, jetimët dhe të zënë robër, edhe pse vetë janë nevojtarë.” (El Insan, 8-9)

Besimi në njëshmërinë e Allahut në adhurim është domosdoshmëri e besimit në zotërimin e Tij dhe kërkesë e Tij. Atij që pohon se Allahu është Krijuesi, Sunduesi, Drejtuesi i çdo gjëje, i bëhet e domosdoshme ta pranojë njëshmërinë e Allahut në adhurim dhe ta veçojë Atë me adhurime. Allahu i Lartësuar në shumë vende në Librin e Tij ua ka ngritur argumentin idhujtarëve në bazë të këtij pohimi (besimit në zotërimin e Tij), si: “O njerëz! Adhuroni Zotin Tuaj, i Cili ju ka krijuar ju dhe ata që ishin para jush, që të mund të ruheni (nga të këqijat); i Cili e ka bërë për ju tokën shtresë dhe qiellin ndërtesë; i Cili prej së larti zbrit ujë dhe nëpërmjet tij bën që të rriten

²⁰ Muslimi (35), përcjellë nga Ebu Hurejra, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

fruta si ushqim për ju. Prandaj mos sajoni me vetëdije zota të barabartë me Allahun.” (El Bekare, 21-22)

“Thuaj: “Kush ju ushqen nga qielli dhe Toka? Kush mundëson të dëgjuarit dhe të parët? Kush mund të nxjerrë të gjallën nga e vdekura dhe të vdekurën nga e gjalla? Kush i drejton gjërat?” Ata do të thonë: “Allahu.” E ti (o Muhamed) thuaj: “Atëherë, përse nuk e keni frikë Atë?” Ky është Allahu, Zoti juaj i vërtetë. E çfarë ka pas së vërtetës, përveç humbjes? Atëherë, përse largoheni?” (Junus, 31-32)

“Thuaj (o Muhamed): “Lëvduar e falënderuar qoftë Allahu dhe shpëtimi qoftë për robërit e Tij të zgjedhur. Kush është më i mirë, Allahu apo ata që ia shoqërojnë Atij (në adhurim)?! A ka më të mirë se Ai që ka krijuar qiejt dhe Tokën dhe lëshon për ju nga qielli ujë, me të cilin krijon kopshte të mrekullueshme?! Ju nuk mund t’i bëni pemët të rriten (pa këtë ujë). Vallë, a ka krahas Allahut zot tjetër?! Jo, por ata janë njerëz që i veshin (Allahut) të barabartë me Të! A ka më të mirë se Ai që e ka bërë Tokën të qëndrueshme, ka bërë në të lumenj, ka ngritur në të male dhe ka bërë midis dy deteve pengesë të padukshme?! Vallë, a ka krahas Allahut zot tjetër?! Jo, por shumica e tyre janë të paditur. A ka më të mirë se Ai që i vjen në ndihmë nevojtarit të këputur, kur i lutet Atij, që jua largon të keqen dhe ju bën trashëgimtarë në tokë?! Vallë, a ka krahas Allahut zot tjetër?! Sa pak që reflektoni! A ka më të mirë se Ai që ju rrëfen rrugën në errësirat e tokës dhe të detit dhe ju çon erërat si lajmëtare të mëshirës së Tij? Vallë, a ka krahas Allahut zot tjetër? I Lartësuar qoftë Allahu dhe i Lavdëruar mbi çdo gjë që ia shoqërojnë (në adhurim). A ka më të mirë se Ai, që zë fill krijimin dhe pastaj e ripërsërit atë, që ju jep mjete jetese nga qielli dhe Toka?! Vallë, a ka krahas Allahut zot tjetër? Thuaj (o Muhamed): “Sillni provat tuaja, nëse ajo që thoni është e vërtetë!” (En Neml, 59-64) Allahu i Lartësuar ua ka ngritur argumentin për ta njëzuar vetëm Atë në adhurim, me vetë faktin se të tillët e pohonin *teuhidin rububije* (njëshmërinë e zotërimit të Allahut).

Po ashtu, Allahu i Lartësuar e ka konsideruar të pavlerë adhurimin që u kushtohet zotave të idhujtarëve, me vetë faktin se ata nuk cilësohen me asnjë cilësi të zotërimit. Allahu i Lartësuar thotë: “A mos vallë ata i veshin Atij si ortakë idhuj që nuk mund të krijojnë asgjë, ndërkohë vetë janë të

krijuar?! Idhuj, që nuk mund t’u japin ndonjë ndihmë atyre e as veten nuk mund ta ndihmojnë?! Edhe nëse i thirrni në rrugën e drejtë, ata nuk do t’ju ndjekin. Prandaj njësoj është: i thirrët apo nuk i thirrët. Në të vërtetë, ata që iu luteni ju, në vend të Allahut, janë robër si ju. Thirrini ata dhe le t’ju përgjigjen, nëse thoni të vërtetën! A kanë ata këmbë për të ecur ose duar për të kapur? A kanë sy për të parë ose veshë për të dëgjuar? Thuaj: “Thirrni zotat tuaj të rremë dhe kurdisni kurthe kundër meje, pa më lënë kohë! Në të vërtetë, Mbrojtësi im është Allahu, i Cili ka zbritur Librin dhe kujdeset për të mirët. Kurse ata që i adhuroni në vend të Tij, nuk mund t’ju ndihmojnë as ju e as veten. Edhe sikur t’i thërrasësh në rrugë të drejtë, ata nuk do të dëgjojnë! Ty të duket sikur të vështrojnë, por ata nuk shohin.” (El Araf, 191-198) Gjithashtu, Ai thotë: “E megjithatë ata²¹ adhurojnë në vend të Tij zota, të cilët nuk krijojnë asgjë e që vetë janë të krijuar, që nuk zotërojnë për veten as dëm e as dobi e që nuk janë në gjendje të japin as vdekjen, as jetën e as që të ringjallin.” (El Furkan, 3) Dhe thotë: “Thuaju (o Muhamed): “Thirrini ata që i hyjnizoni krahas Allahut! Ata nuk kanë pushtet as sa pesha e një thërmije, qoftë në qiej apo në Tokë; për ta nuk ka pjesë as në qiej, as në Tokë dhe Allahu nuk ka asnjë ndihmës nga radhët e tyre.” Asnjë ndërmjetësim tek Ai nuk bën dobi, përveçse për atë që Ai jep leje. Kur t’u hiqet frika nga zemrat e tyre, ata do të thonë: “Çfarë tha Zoti juaj?” dhe do të përgjigjen: “Të vërtetën! Ai është i Lartësuar dhe i Madhërishëm.” (Sebe, 22-23)

E për këtë, shirku (të rivalizuarit) në adhurimin e Allahut të Lartësuar është:

1. Padrejtësia më e madhe

Allahu i Lartësuar thotë: “**Pa dyshim, idhujtaria është një padrejtësi shumë e madhe.**” (Lukman, 13) Kjo, se ajo është diskreditim ndaj Zotit të botëve, dedikim i së drejtës absolute të Tij (adhurimit) dikujt tjetër, si dhe barazim i dikujt tjetër me Të, siç thotë Allahu: “**E megjithatë, ata që nuk besojnë, sajojnë zota të tjerë si të barabartë me Zotin e tyre.**” (El Enam, 1)

2. Mëkati më i madh

I Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “*A t’jua tregoj mëkatet më të mëdha? (Këtë e tha) tri herë. Patjetër, o i Dërguari i Allahut, - iu përgjigjen. Ai tha: “T’i*

²¹ Idhujtarët.

shoqërosb Allahut dikë në adhurim.” Siç ka ardhur në hadith. (E shënojnë Buhariu dhe Muslimi) ²²

3. Gjynahu më i madh

I Dërguari, *sal-lallabu alejhi ue selem*, është pyetur: “Cili është gjynahu më i madh tek Allahu?” Dhe ka thënë: “*T’i bësh Allahut ortak, ndërkohë Ai të ka krijuar ty.*” (E shënojnë Buhariu dhe Muslimi) ²³

4. Degjenerim i natyrës së shëndoshë njerëzore dhe rënie në devijim

Allahu i Lartësuar thotë: “**Kush i shoqëron Allahut diçka (në adhurim), i ngjan atij që bie nga qielli e që e rrëmben zogu ose i ngjan atij që stuhia e erës e ka hedhur në një vend të largët e të humbur.**” (El Haxh, 31)

Meqë idhujtaria është tejet e shëmtuar, Allahu i Lartësuar për të ka vendosur dispozita në këtë botë dhe në botën tjetër, si:

- *Mosfalja e këtij mëkati*

Allahu i Lartësuar thotë: “**Vërtet Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër përveç Tij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë. Kushdo që i bën shok Allahut (në adhurim), ka bërë gjynah të tmerrshëm.**” (En Nisa, 48)

- *Xheneti është i ndaluar për të dhe i tilli është përgjithmonë në Zjarr*

Allahu i Lartësuar thotë: “**Sigurisht, atij që i bën shok Allahut (në adhurim), Allahu do t’ia ndalojë Xhenetin dhe strehimi i tij do të jetë Zjarri. Për keqbërësit nuk ka ndihmës.**” (El Maide, 72)

- *Asgjësimi i të gjitha veprave (të mira)*

Allahu i Lartësuar thotë: “**Me të vërtetë, të është shpallur ty (o Muhamed), si dhe atyre që kanë qenë para teje: “Nëse i shoqëron Allahut diçka tjetër (në adhurim), me siguri që punët e tua do të zhvlerësohen dhe do të jesh ndër të humburit.**” (Ez Zumer, 65) ²⁴

²² Buhariu (2654) dhe Muslimi (87), përcjellë nga Ebu Bekrete, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

²³ Buhariu (4477) dhe Muslimi (86), përcjellë nga Abdullah ibn Mesudi, *Allahu qoftë i kënaqur me të!* Sipas këtyre dy koleksioneve pyetësi ka qenë Abdullah ibn Mesudi, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

²⁴ Sqarim: Vargjet kuranore kanë të bëjnë me atë që vdes si idhujtar pa u penduar, ngase Allahu i Lartësuar i fal të gjitha mëkatet, madje edhe idhujtarinë, me kusht që njeriu të pendohet për të para se të vdesë. Shënim i përkthyesit.

Në këtë kapitull kanë devijuar disa grupe njerëzish. Ja disa prej tyre:

- 1) **Idhujtarët**, edhe pse ata që adhurohen janë të ndryshëm, si: pemë, gurë, njerëz, xhinë, engjëj, planetë dhe gjallesa me anë të të cilave i ka devijuar shejtani.
- 2) **Varradhuruesit**, të cilët i lusin të vdekurit dhe ua kushtojnë zotimet dhe kurbanet, si dhe prej tyre kërkojnë arritjen e të mirave dhe largimin e të këqijave.
- 3) **Magjistarët, sharlatanët dhe falltarët**, të cilët i adhurojnë xhinët në këmbim të asaj që i njoftojnë, që ua paraqesin atyre, ose që bëjnë për ta.

Për shkak të rrezikut të madh që ka shirku në adhurim, i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka tërhequr vërejtjen nga shkaqet që shpijnë tek ai, si dhe ka mbyllur udhët që dërgojnë drejt rënies në të. Ndër shembujt në fjalë theksojmë:

1. Tërbeqja e vërejtjes nga teprimi në raport me njerëzit e mirë

I Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “*Kini kujdes nga teprimi! Sepse vërtet teprimi në fe i ka shkatërruar popujt para jush.*” (E shënojnë Ahmedi, Nesaiu dhe Ibn Maxhe)²⁵ Gjithashtu, i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “*Mos e teproni duke më lavdëruar ashtu siç e kanë tepruar të krishterët me (Isain) të birin e Merjemes. Vërtet unë jam vetëm rob i Tij, andaj thoni (për mua): Rob i Allahut dhe i Dërguar i Tij.*” (E shënon Buhariu)²⁶

Ndër format e teprimit në raport me njerëzit e mirë është edhe tevesuli (afrimi tek Allahu) nëpërmjet tyre. Afrimi ndahet në disa lloje:

a) Afrim që konsiderohet shirk që nxjerr nga feja:

Ky lloj ndodh atëherë kur lutja për plotësimin e nevojave dhe largimin e brengave u drejtohet atyre (të vdekurve), e jo Allahut.

b) Afrim që konsiderohet bidat (risi), por që nuk e arrin shkallën e shirkut (idhujtarisë):

Afrimi tek Allahu me gjëra që Ai nuk i ka ligjësuar, si: afrimi me qenien e njerëzve të mirë, pozitën, vlerën apo shenjtërinë e tyre, e të ngjashme.

²⁵ Ahmedi (1851, 3248), Nesaiu (3059) dhe Ibn Maxhe, (3029); përcjellë nga Ibn Abasi, Allahu qoftë i kënaqur me të!

²⁶ Buhariu (3445), përcjellë nga Omeri, Allahu qoftë i kënaqur me të!

c) Afrim i ligjësuar:

Ky është afrimi me besimin tek Allahu dhe adhurimin kushtuar Atij, si dhe duke e lutur Allahun me ndonjë prej emrave apo cilësive të Tij. Afrimi tek Ai me ndonjë vepër të mirë që e ka vepruar, apo të kërkojë që ndonjë njeri i mirë të lutet për të për ndonjë çështje të përgjithshme.

Sa i përket fjalës së Omerit, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*: “O Allah! Ne të afrohem me të Dërguarin tonë, *sal-lallahu alejbi ue selem*, e Ti na lëshoje shi; vërtet (tani) të afrohem me xhaxhain e të Dërguarit tonë, andaj na lësho shi!” (E shënon Buhariu)²⁷ Ky është afrim tek Allahu me lutjen e Abasit (drejtuar Atij), për shkak të farefnisnë së tij me të Dërguarin, *sal-lallahu alejbi ue selem*, e kurrsesi më qenien e tij! Po të ishte i ligjësuar afrimi me qeniet (e njerëzve të mirë), sahabët do të afroreshin tek Allahu me qenien e të Dërguarin, *sal-lallahu alejbi ue selem*, edhe pas vdekjes së tij.

2. Tërheqja e vërejtjes nga mashtrimi në raport me varret

Ja disa forma të saj:

a) Shndërrimi i varreve në faltore (mesxhid)

Nga Aishja, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, përcillet se ka thënë: “Kur i qe afruar (vdekja) të Dërguarit të Allahut, *sal-lallahu alejbi ue selem*, pati filluar të mbulonte fytyrën me një rrobë të tijën prej leshi. Kur ndiente se po i merrej fryma, e hiqte atë dhe, duke qenë kështu, pati thënë: “*Mallkimi i Allahut qoftë mbi çifutët dhe të krishterët: i kanë shndërruar varret e peygamberëve të tyre në faltore.*” Ka tërhequr vërejtjen nga ajo çfarë kanë bërë. Po të mos ishte kjo, varri i tij do të ekspozohej, megjithatë ai kishte frikë mos (varri i tij) shndërrohej në faltore.” (E shënojnë Buhariu dhe Muslimi)²⁸ Dhe ka thënë: “*Vini re, ata që kanë qenë para jush i kanë shndërruar varret e peygamberëve dhe njerëzve të mirë në faltore! Kujdes, mos i shndërroni varret në faltore! Vërtet unë jua ndaloj këtë gjë!*” (E shënon Muslimi)²⁹

Kuptimi i kthimit të tyre në faltore nënkupton faljen e namazit në to, edhe nëse mbi to nuk ndërtohet ndonjë faltore; ngase faltorja (mesxhidi) nënkupton vendin e rënies në sexhde.

27 Buhariu (1010), përcjellë nga Enesi, e ky nga Omeri, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

28 Buhariu (435, 437, 1390) dhe Muslimi (529, 531).

29 Muslimi (532), përcjellë nga Xhundebi, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

b) Ndërtimi mbi to, shtimi i diçkaje tjetër mbi to përveç dheut dhe gëlqerosja e tyre

Nga Ebul Hejxh el Esedi, Allahu e mëshiroftë!, përcillet se ka thënë: “Ali ibn Ebu Talibi, Allahu qoftë i kënaqur me të!, më ka thënë: “Po të dërgoj për atë gjë me të cilën më ka dërguar i Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*: të mos lësh portret pa prishur e as varr të ngritur pa e rrafshuar!” (E shënon Muslimi)³⁰

Gjithashtu, nga Xhabir ibn Abdullahu, Allahu qoftë i kënaqur me të!, përcillet se ka thënë: “I Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka ndaluar gëlqerosjen e varrit, uljen dhe ndërtimin mbi të.” (E shënon Muslimi)³¹ Në këtë (ndalesë) hyjnë edhe ndërtimi i kupolave, zbukurimi dhe stolisja e tyre mbi to.

c) Marrja e udhëtimit drejt tyre (me qëllim adhurimi)

Bazuar në fjalën e tij, *sal-lallahu alejhi ue selem*: “Nuk merret udhëtim i posaçëm (për adhurim) në drejtim të asnjë vendi, përveçse drejt tri xhamive: Xhamisë së Shenjtë (Qabesë), Xhamisë Sime (në Medinë) dhe Xhamisë Aksa (në Palestinë).” (E shënojnë Buhariu dhe Muslimi)³²

ç) Marrja e varrit të të Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, si vend festimi

I Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “Mos e merrni varrin tim si vend festimi!”³³ (E shënon Ebu Davudi)³⁴ Festë është të bërit zakon vajtjen apo të synohet diçka që ka të bëjë me kohë apo vend (të caktuar).

³⁰ Muslimi (969).

³¹ Muslimi (970).

³² Buhariu (1189) dhe Muslimi (1397), përcjellë nga Ebu Hurejra, Allahu qoftë i kënaqur me të!

³³ Pra, mos e ktheni varrin tim në një vend të cilit i ktheheni vazhdimisht, ose e bëni zakon ta vizitoni në kohë të caktuara, ngase kjo mund të shpjerë në madhërimin e të Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ashtu siç madhërohet Allahu i Lartmadhërihëm. Domethënë, shndërrimi i varreve në vendfestë është një prej rrugëve të idhujtarisë (shirkut). Për këtë i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “Mos e shndërroni varrin tim në vendfestë e as shtëpitë tuaja në varre, por më dërgoni salavate, sepse salavati juaj më arrin kudo që jeni!” Salih ibn Abdulaziz Alu Shejbi, *Et Temhid li sberbi Kitabii temhid*, f. 295, *Allahu e ruajtë!* Shënim i përkthyesit.

³⁴ Ebu Davudi (2042), përcjellë nga Ebu Hurejra, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

3. *Tërbeqja e vërejtjes nga përngjasimi me idhujtarët dhe ithtarët e Librit (çifutët dhe të krishterët) në besimet, adhurimet dhe zakonet e tyre specifike*

I Dërguari, *sal-lallabu alejhi ue selem*, ka thënë: “*Të dalloni nga idhujtarët!*” (E shënojnë Buhariu dhe Muslimi)³⁵ Gjithashtu ka thënë: “*Të dalloni nga mexhusët (zjarradburnesit)!*” (E shënon Muslimi)³⁶ Dhe ka thënë: “*Të dalloni nga çifutët!*” (E shënon Ebu Davudi)³⁷

4. *Tërbeqja e vërejtjes nga vizatimi i portreteve*

Nga Aishja përcillet se Umu Seleme, *Allahu qoftë i kënaqur me to!*, i kishte përmendur të Dërguarit, *sal-lallabu alejhi ue selem*, një kishë që e kishte parë në Etiopi dhe portretet që kishin qenë në të. Profeti kishte thënë: “*Ata janë një popull që, nëse u vdiste ndonjë njeri i mirë, mbi varrin e tij ndërtonin faltore, tek vizatonin ato portrete. Ata janë krijesat më të këqija tek Allahu.*” (E shënojnë Buhariu dhe Muslimi)³⁸

5. *Tërbeqja e vërejtjes nga fjalët që përmbajnë idhujtari*

Disa forma të tyre janë:

a) **Betimi në dikë tjetër përveç Allahut**

Bazuar në hadithin: “*Ai që betohet në dikë tjetër përveç Allahut, ka mohuar ose ka rënë në idhujtari.*”³⁹ (E shënon Tirmidhiu)⁴⁰

35 Buhariu (5892) dhe Muslimi (259), përcjellë nga Ibn Omeri, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

36 Muslimi (260), përcjellë nga Ebu Hurejra, Allahu qoftë i kënaqur me të!

37 Ebu Davudi (652), përcjellë nga Shedad ibn Eusi, Allahu qoftë i kënaqur me të!

38 Buhariu (434) dhe Muslimi (528); teksti është i Buhariut.

39 **Vendimi për betimin në dikë tjetër pos Allahut:** a. Në qoftë se atë për të cilin betohet e madhëron sikurse Allahun ose më shumë, atëherë është shirk i madh; b. Nëse e madhëron atë, por jo siç madhërohet Allahu, atëherë është shirk i vogël. Abdullah ibn Ahmed el Huvejli, *Tenbidi i thjeshtësuar*, f. 104. Shënim i përkthyesit.

40 Ebu Davudi (3251), Tirmidhiu (1535); teksti është i këtij të fundit. Që të dytë këtë e shënojnë nga Ibn Omeri, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

b) Barazimi i dikujt me Allahun në dëshirë⁴¹

Bazuar në fjalën e të Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selem*: “A më bërë të barabartë me Allahun?! Thuaj: “Çfarë deshbi vetëm Allahu”, drejtuar atij që i kishte thënë: “Çfarë deshbi Allahu dhe ti.” (E shënon Nesaiu)⁴²

c) Shiu ra për shkak të këtij ylli⁴³

Bazuar në hadithin kudsij: “Ndërkaq, ai që tha: “Ra shi për shkak të këtij apo atij ylli”, është jobesimtar në Mua dhe besimtar në yjet.” (E shënojnë Buhariu dhe Muslimi)

⁴⁴Me këtë krahasohen të gjitha fjalët që përmbajnë dedikimin e sistemimit të (ndonjë) çështjeje nga dikush tjetër përveç Allahut të Lartësuar.

6. Tërbeqja e vërejtjes nga veprat që shpijnë në shirk

Disa forma të tij janë:

a) Vënia e rrethit apo perit në dorë ose në qafë, me qëllim të pengimit të së keqes apo largimit të saj⁴⁵

Bazuar në hadithin e Imran ibn Husejnit, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, i cili përcjell se i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, kishte parë një njeri që në dorën e tij kishte vendosur një rreth prej bakri: “Mjerë ti! Ç’është ky?”, - e kishte pyetur (i Dërguari). “Është kundër plogështisë”, - i ishte përgjigjur ai. Atëherë i Dërguari,

41 **Vendimi:** a. Në qoftë se beson se Allahu dhe krijesa janë të barabartë, atëherë është shirk i madh, edhe nëse në vend të lidhëzës *dhe* përdor ndajfoljen *pastaj* (arb. *thumme*); b. Në qoftë se nuk beson se Allahu dhe krijesa janë të barabartë kur e përmend Allahun bashkë me krijesën duke përdorur lidhëzën *dhe*, atëherë është shirk i vogël. Si duhet të themi në raste të tilla? Në raste të tilla mund t’i përdorim dy forma: E para: Të përdoret ndajfolja *pastaj*, por pa besuar se Allahu dhe krijesa janë të barabartë. Për shembull: çfarë do Allahu, *pastaj* ti; kërkoj ndihmë prej Allahut, *pastaj* prej teje; e thënie të ngjashme. E dyta: Tërë çështja t’i drejtohet vetëm Allahut. Për shembull: çfarë do Allahu, i Vetmi; kërkoj ndihmë vetëm prej Allahut; e kështu me radhë, gjë e cila është forma më e mirë. Abdullah ibn Ahmed el Huvejlî, *Teuhidi i thjeshtësuar*, f. 106-107. Shënim i përkthyesit.

42 Nesaiu në Es Sunen el kubra (10759), përcjellë nga Ibn Abasi, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

43 Llojet e kërkimit të reshjeve nga yjet: 1. Shirk i madh: a. Kur u lutet yjeve për të lëshuar shi. Për shembull: o aksh yll, lëshona shi etj. b. Kur reshjet ua përshkruan këtyre yjeve ose fazave, duke menduar se ato veprojnë vetvetiu, pavarësisht vullnetit të Allahut, edhe nëse nuk u drejtohet me lutje; 2. Shirk i vogël: Kur mendon se Allahu i ka bërë shkak ato yje për reshjet e shiut; 3. I lejuar: Kur beson se këto faza ose yje janë vetëm shenja aluduese, se nuk janë shkaqe dhe se nuk ndikojnë vetvetiu. Abdullah ibn Ahmed el Huvejlî, *Teuhidi i thjeshtësuar*, f. 96. Shënim i përkthyesit.

44 Buhariu (846) dhe Muslimi (71), përcjellë nga Zejd ibn Halid el Xhuhenui, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

45 Duhet ditur se këto lloje të shirkut të vogël mund të jenë shirk i madh, varësisht vepruesit të tyre, bie fjala, vënia e rrethit apo perit në dorë ose në qafë, betimi në dikë tjetër përveç Allahut, hajmalitë etj., në parim janë shirk i vogël. Por, nëse njeriu beson se këto ndikojnë vetvetiu dhe nuk janë shkaqe, atëherë ky është shirk i madh. Shënim i përkthyesit.

sal-lallahu alejhi ue selem, i kishte thënë: “*Hige, sepse ai vetëm të shton plogështi! Po të ndisje duke e pasur atë në dorë, nuk do të shpëtoje kurrë.*” (E shënojnë Ahmedi, Ibn Maxhe dhe Ibn Hibani)⁴⁶

b) Vënia e hajmalive, guaskave, litarëve dhe gjerdanëve për pengimin e mësyshit⁴⁷

Bazuar në hadithin: “*Atij që vë hajmali, Allahu mos ia përmbushtë dëshirën. Atë që mban guaskë*⁴⁸, *Allahu mos e lëntë të qetë.*” (E shënojnë Ahmedi, Ibn Hibani dhe Hakimi)⁴⁹ Në një transmetim të Ahmedit dhe Hakimit qëndron: “*Ai që vë hajmali, ka bërë shirk.*”^{50,51} Dhe bazuar në hadithin: “*Mos lini pa prerë asnjë gjerdan a varëse prej litari në qafat e deveve.*” (E shënojnë Buhariu dhe Muslimi)⁵²

c) Et tiveleh dhe rukjet që përmbajnë idhujtari (yshtjet)

Bazuar në hadithin: “*Me të vërtetë rukjet (yshtjet)*⁵³, hajmalitë dhe nuskat (et tiveleh) janë shirk.” (E shënojnë Ebu Davudi dhe Ibn Maxhe)⁵⁴ *Et tiveleh* është diçka që e bëjnë duke pretenduar se e bën të dashur gruan te burri i saj (dhe anasjelltas).

46 Ahmedi (20000), Ibn Maxhe (3531) dhe Ibn Hibani në Sahihun e tij (6085).

47 Edhe në këtë kohë sheh njerëz që vendosin patkonj kuajsh, sy të kaltër, hudhra e gjëra të ngjashme, për t’ua larguar të keqen. Nëse besojnë se këto gjëra ua largojë të keqen vetvetiu, atëherë ky veprim është shirk i madh. Shënim i përkthyesit.

48 Me fjalën el uedeah, në hadith, nënkuptohen guaskat e detit, që përdoreshin për të shmangur mësyshin. Njeriun që i varte ato guaska besohet se nuk e kapte syri ose nuk e godiste xhini. Muhamed ibn Salih el Uthejmini, *Allahu e mëshiroftë!, Komenti i librit të teubidit, vëllimi i parë*, f. 114. Shënim i përkthyesit.

49 Ahmedi (17404), Ibn Hibani (6086) dhe Hakimi në El Mustedrak (7708), përcjellë nga Ukbe ibn Amiri, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

50 Ahmedi (17422) dhe Hakimi në El Mustedrak (7720), përcjellë nga Ukbe ibn Amiri, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

51 Nëse personi që vë hajmali beson se vetë ajo pengon të keqen ose e largon atë, pa urdhrin e Allahut, atëherë ka bërë shirk të madh, në të kundërtën, ka bërë shirk të vogël. Shënim i përkthyesit.

52 Buhariu (3005) dhe Muslimi (2115), përcjellë nga Beshir el Ensariu, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

53 *Rukjet* janë lutje në formë kure, që u lexohen atyre që janë të sëmurë. Fjala “... *rukjet* ...”, në hadith, nuk përfshin të gjitha rukjet, por vetëm ato që nuk janë përcjellë në shariat, kurse ato që janë përcjellë në shariat nuk janë shirk. I Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, për suren El Fatiha, ka thënë: “*Ku e dije ti se ajo është rukje?*” Po çfarë nënkuptohet atëherë me “rukjet” në hadith: ato që nuk janë të përcjella në shariat, edhe nëse janë të lejuara, apo ato që janë shirk? Mund të themi se nënkuptohen ato që janë shirk, sepse fjalët e të Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, nuk kundërshtojnë njëra-tjetrën. Atëherë, rukjet që kanë ardhur të përcjella në shariat, bie fjala, rukjet me lutje, që i lexohen të sëmurit dhe nuk përmbajnë shirk, janë të lejuara. Muhamed ibn Salih el Uthejmini, *Allahu e mëshiroftë!, Komenti i librit të teubidit, vëllimi i parë*, f. 123. Shënim i përkthyesit.

54 Ebu Davudi (3883) dhe Ibn Maxhe (3530), përcjellë nga Ibn Mesudi, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

ç) Therja në vendet ku i është bërë Allahut shirk (idhujtari)

Bazuar në fjalën e tij, *sal-lallahu alejhi ue selem*, kur e kishte pyetur një njeri që ishte zotuar për të therur një deve në (vendin) Buvaneh: “A ka pasur në atë vend ndonjë idhull që adhurohej gjatë injorancës?”⁵⁵ Ata i thanë: “Jo.” I Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, sërish i pyeti: “A ka pasur në të ndonjë festë të tyren që kremtohej?” Ata i thanë: “Jo.” I Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, tha: “Përmbushe zotimin tënd!” (E shënon Ebu Davudi)⁵⁶

d) Oguret e zeza dhe pesimizmi⁵⁷

Bazuar në hadithin e Ibn Mesudit, Allahu qoftë i kënaqur me të!, se i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “Oguret e zeza (et tjerah) janë shirk. Oguret e zeza janë shirk.” (E shënojnë Ebu Davudi dhe Ibn Maxhe)⁵⁸

Në përgjithësi, çdokush që pohon si shkak diçka që nuk e ka vendosur Allahu, as në aspektin ndijor e as në atë fetar, nuk ka bërë gjë tjetër veçse ka rënë në shirk, ose ka shkuar drejt tij.

55 Ky term cilëson periudhën para shpalljes (së Islamit). Është quajtur kështu, sepse njerëzit asokohe ishin në një injorancë të madhe. Muhamed ibn Salih el Uthejmini, Allahu e mëshiroftë!, Komenti i librit të teuhidit, vëllimi i parë, f. 172. Shënim i përkthyesit.

56 Ebu Davudi (3313), përcjellë nga Thabit ibn Dahaku, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*; si dhe Ibn Maxhe (2130), përcjellë nga Ibn Abasi, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

57 Fjala arabe *tjerah*, e cila në shqip do të thotë ogur, gjuhësisht rrjedh nga fjala *tetajur*, që do të thotë optimizëm ose *pesimizëm lidhur me diçka*. Ndërkaq, *tjerah*, sipas terminologjisë fetare, quhet *pesimizmi që ndodh për shkak të diçkaje që shihet, dëgjohet a dibet*. **Vendimi për oguret e zeza:** Oguret e zeza kundërshtojnë teuhidin në dy aspekte: 1. Ai që beson në to e këput mbështetjen në Allahun dhe mbështetet në dikë tjetër; 2. Ai që beson në to, lidhet me diçka që nuk ekziston, por është vetëm iluzion. **Gjendja e atij që beson në ogure të zeza:** Gjendja e parë: T’u përgjigjet ogureve dhe të zmbropset për shkak të tyre. Ky është besim i thellë në ogure të zeza dhe pesimizëm i madh; Gjendja e dytë: Të mos zmbropset, por të ndihet i brengosur dhe të frikësohet se mos po ndikojnë oguret e zeza. Edhe kjo bën pjesë në pesimizëm, por është më e lehtë. Që të dyja këto gjendje janë mangësi në teuhid dhe i bëjnë dëm robit. **Ilaçi për atë që i paraqiten oguret në zemër:** Ai duhet të thotë: “Allahu im, askush pos Teje nuk i sjell të mirat dhe askush pos Teje nuk i largon të këqijat. Nuk ka lëvizje e as fuqi pa dëshirën Tënde.” (Ebu Davudi) Gjithashtu, duhet të thotë: “Allahu im, nuk ka të mirë tjetër përveç së mirës Sate, nuk ka ogur të zi nga shpendët, përveç atij që vjen nga Ti dhe nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç Teje.” Këtë hadith e ka shënuar Ahmed, kurse Albani e ka vlerësuar si sahih. Po ashtu, njeriu i tillë duhet: 1. T’i njohë dëmet e besimit në ogure; 2. Ta luftojë nefsën e vet; 3. Të besojë në caktimin e Allahut; 4. Të ketë mendim të mirë për Allahun; dhe 4. Ta përdorë namazin e istiharës. **Kur mund të themi se njeriu ka rënë në sprovën e besimit në ogure?** I Dërguari i Allahut, Muhamedi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “Vërtet, besim në ogure është ajo që të bën të vazhdosësh ose të kthehesh mbrapsht.” (Ahmed) Abdullah ibn Ahmed el Huvejlî, Teuhidi i thjeshtësuar, f. 91-92. Shënim i përkthyesit.

58 Ebu Davudi (3910) dhe Ibn Maxhe (3538).

IV. Besimi në emrat dhe cilësitë e Allahut

Me besimin në emrat dhe cilësitë e Allahut nënkuptojmë bindjen e palëkundshme se Allahu i Lartësuar posedon emrat më të bukur dhe cilësitë më të larta. Gjithashtu, pohimin e cilësive të plota dhetributeve madhështore që Allahu ia ka pohuar Vetes në Librin e Tij ose i Dërguari i Vet ia ka pohuar në Sunetin e tij; pa bërë shëmbëllim (*temthil*) dhe pa i përshkruar formë (*tekjij*). Po ashtu, mohimin e asaj që Allahu ka mohuar për Vetën në Librin e Tij apo i Dërguari i Vet ka mohuar për Të në Sunetin e tij, përfshirë cilësitë e mangëta, të metat, dhe mohimin e përngjasimit të Tij me krijesat, pa bërë shtrembërim (*tabrif*) e mohim (*tatil*).

Allahu i Lartësuar thotë: **“Allahut i përkasin emrat më të bukur, andaj thirreni Atë (lutjuni Atij) me ta dhe largohuni nga ata që i shtrembërojnë emrat e Tij. Ata do të ndëshkohen për çfarë kanë vepruar.”** (El Araf, 180) Gjithashtu, Ai thotë: **“Asgjë nuk i shëmbëllen Atij. Ai i dëgjon të gjitha dhe i sheh të gjitha.”** (Esh Shura, 11)

Emrat dhe cilësitë e Allahut të Lartësuar janë *teukifije*⁵⁹, që mendja, e vetme, e ka të pamundur t'i pohojë. Allahu përshkruhet vetëm siç e ka përshkruar Vetveten apo siç e ka përshkruar Atë i Dërguari i Tij; nuk duhet të tejkalohej Kurani dhe Hadithi. Rreth përshkrimeve që Allahu dhe i Dërguari i Tij kanë heshtur, është obligim të heshtim dhe të ndalemi edhe ne; qoftë mohim apo pohim. Gjithashtu, kërkohet sqarim i hollësishëm rreth asaj që ka për qëllim thënësi. Nëse me të dëshiron kuptim të saktë, atëherë i pranohet kuptimi në fjalë, kurse shprehja i refuzohet. E, nëse përmend ndonjë kuptim jo të saktë, i refuzohet shprehja dhe kuptimi.

Allahu i Lartësuar thotë: **“Mos shko pas diçkaje për të cilën nuk ke dijeni. Vërtet, dëgjimi, shikimi dhe zemra, të gjithë këta do të merren në përgjegjësi.”** (El Isra, 36)

Emrat e Allahut të Lartësuar e kanë arritur kulmin e bukurisë. Ata janë emra të përveçëm të Qenies së Allahut dhe në vete përmbajnë cilësi të Tij. Cilësitë e Tij janë të plota: në to nuk ka të metë në asnjë aspekt. Allahu i Lartësuar thotë: **“Atij i përket shembulli më i lartë në qiej dhe në Tokë. Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti.”** (Er Rum, 27)

59 Mund të nxirren vetëm nga Kurani dhe Suneti, pa shtuar e pa pakësuar asgjë. Shënim i përkthyesi

Ata janë të vërtetë sipas realitetit të tyre. Është obligim t'i lëmë ata sipas kuptimit të tyre të dukshëm, pa shtrembërim. Është i ndaluar shtrembërimi (ilhadi) në çështjen e emrave të Allahut; qoftë duke i mohuar, shëmbëllyer me të tjerët, qoftë duke shpikur emra me të cilët nuk e ka emëruar Vetën e Tij; apo nxjerrja e emrave për idhujt nga emrat e Allahut të Lartësuar, si: el *Lat* prej *el Ilah* (i Adhuruari), *el Uzra* prej *el Aziz* (i Plotfuqishmi) dhe *Menat* prej *el Menan* (Mirësidhësnësi).⁶⁰

Është obligim t'i lutemi Allahut me ta, duke i theksuar në lutje dhe në adhurime.⁶¹ Duhet t'i mësojmë përmendsh dhe t'ua kuptojmë domethëniet, gjithashtu të meditojmë rreth gjurmëve të tyre, si dhe të punojmë sipas asaj që kërkojnë këta emra. Kjo është dija më e çmuar.

Cilësitë e Allahut të Lartësuar përkitazi me Të ndahen në dy lloje:

E para: cilësi qenësore (dhatije)

Cilësitë qenësore janë të pandara nga Qenia e shenjtë e Allahut, si: jeta, dëgjimi, shikimi, dituria, fuqia, dëshira, urtësia, forca dhe të tjera.

E dyta: cilësi veprore (filije)

Cilësitë veprore janë të lidhura me dëshirën dhe urtësinë e Tij: i vepron ato kur të dojë e qysh të dojë, ashtu siç nënkupton urtësia e Tij, si: ngritja, zbritja, dashuria, urrejtja, gëzimi, çuditja, e qeshura, ardhja dhe të tjera që kanë ardhur në Kuran, apo që janë saktësuar në traditën profetike (Sunet).

Disa prej tyre janë cilësi qenësore dhe veprore njëkohësisht, bie fjala, cilësia e të folurit të Allahut. Sa i përket origjinës së cilësisë, ajo është është qenësore⁶².

60 Emrat e këtyre idhujve i ka përmendur Allahu në Kuran, duke treguar se ata kanë qenë idhuj të cilët i adhuronte populli i të Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, dhe që i kishin marrë emërtimet nga emrat e Allahut. Shënim i përkthyesit.

61 Lutja ndahet në dy lloje: a. Lutje e kërkimit, që nënkupton kërkimin e asaj që bën dobi, ose kërkimin e largimit të asaj që bën dëm, që t'i lutet Allahut të Lartësuar për gjëra që i bëjnë dobi në këtë dhe në botën tjetër dhe (t'i lutet) që t'ia largojë gjërat që i bëjnë dëm në këtë dhe në botën tjetër, si: lutja për falje, mëshirë, udhëzim, sukses, fitim të Xhenetit dhe shpëtim nga Zjarri, si dhe që Allahu t'i japë të mira të kësaj dhe të botës tjetër etj.; b. Lutja e adhurimit, që nënkupton se njeriu të jetë rob i Allahut të Lartësuar, me të gjitha llojet e adhurimeve: të zemrës, të trupit apo materiale, si: frika prej Allahut, mbështetja tek Ai, namazi, agjërimi, haxhillëku, leximi i Kuranit, thënia subhanallah, dhikri (përmendja e Tij), zekati, lëmosha, thirrja tek Allahu, urdhërimi i së mirës dhe ndalimi i së keqes etj. www.islamqa.info. Shënim i përkthyesit.

62 Sepse Allahu ka qenë Folës dhe do të jetë gjithnjë. Shënim i përkthyesit.

Ndërkaq, sa u përket pjesëve të saj,⁶³ janë cilësi veprorë⁶⁴. Ose, thuhet është e vjetër si lloj dhe e re si pjesë.

Disa prej tyre janë cilësi tekstuale. Të tilla janë cilësitë që janë pohuar vetëm në bazë të lajmeve (të Kuranit dhe Sunetit), pa u bazuar në logjikë, si: fytyra, dy duart, dy sytë, këmba e të tjera, që kanë ardhur në Kuran dhe në hadithe të sakta.

Cilësitë e Allahut të Lartësuar që janë të vërtetuara me Kuran, Sunet dhe konsensus (ixbma)⁶⁵

1. Cilësia e lartësimit (el ulw)

Cilësia e lartësimit ndahet në tri lloje:

- a) **Lartësimi i madhësisë:** nga cilësitë e përsosura Allahu i Lartësuar posedon më të përsosurën, më të plotën dhe më të lartën. Allahu i Lartësuar thotë: **“... kurse Allahut i përket shembulli më i lartë (cilësitë më të larta).”** (En Nahl, 60)
- b) **Lartësimi i nënshtrimit:** domethënë, Allahu i Lartësuar posedon krenarinë, fuqinë, dhe nënshtrimin e të gjitha krijesave të Tij. Allahu i Lartësuar thotë: **“Ai është Sunduesi mbi robërit e Vet.”** (El Enam, 18)
- c) **Lartësimi i Qenies:** pra, Allahu i Lartësuar është mbi qiejt me Qenien e Tij, i ngritur mbi Arshin (Fronin) e Tij⁶⁶. Ai është i veçuar nga krijesat e Tij, në Të nuk ka asnjë krijesë të Tij, sikurse në krijesat e Veta nuk ka asgjë të Tijën.⁶⁷ Ai është i Patëmeta dhe Atij i përket falënderimi. Allahu i Lartësuar thotë: **“A jeni të sigurt se kush është në qiell, nuk do ta bëjë Tokën t’ju kapërdijë...”** (El Mulk, 16) Në Sahihun e Muslimit shënohet se i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, e kishte pyetur një robëreshë duke i thënë: “Ku është Allahu?” Ajo iu përgjigj: “Mbi qiell.” Ai përsëri e pyeti: “Po unë, kush jam?” Ajo iu përgjigj: “Ti je i Dërguari i Allahut.” Ai tha: “*Liroje, se ajo është*

63 Pra, të folurit që Allahu bën me engjëjt, të folurit me profetët, të folurit e Tij me Kura

64 Sepse të folurit varet nga dëshira e Allahut: Ai flet kur të dëshirojë. Shënim i përkthyesit.

65 *Ixbma* quhet konsensusi i dijetarëve të umetit në një kohë të caktuar për një çështje fetare. *Ixbma* është argumenti i tretë që merret për bazë në Islam, pas Kuranit dhe Sunetit. Shënim i përkthyesit.

66 Ashtu siç i takon madhërisë së Tij, duke mos i ngjasuar asnjë krijese. Shënim i përkthyesit.

67 Allahu nuk është i mishëruar me krijesat e Tij, sikurse ato nuk janë të mishëruara me Të. Shënim i përkthyesit.

besimtare.”⁶⁸ Ka shumë argumente nga Kurani, Suneti, konsensusi, mendja dhe natyrshmëria që e vërtetojnë këtë lloj. Argumentet për këtë janë të panumërta. Lartësimi është cilësi qenësore.

2. Cilësia e ngritjes/qëndrimit (*el istiva*)

Allahu i Lartësuar, në gjashtë vende në Kuranin fisnik, thotë: “... **pastaj u ngrit mbi Fron (Arsh)**” (El Araf, 54)⁶⁹, kurse vargu i shtatë kuranor është: “**I Gjithëmëshirshmi mbi Arsh (Fron) u ngrit.**” (Ta Ha, 5) *Istiva*-ja nënkupton ngritjen/qëndrimin e Allahut mbi Fronin e Tij, pas krijimit të qiejve dhe Tokës, ngritje kjo që i ka hije Lartmadhërisë së Tij. Kjo ngritje nuk u ngjason ngritjes së krijesave. *Istiva*-ja është cilësi veprore.

3. Cilësia e të folurit (*el kelam*)

Allahu i Lartësuar thotë: “**Thuaj: “Sikur deti të ishte bojë për të shkruar fjalët e Zotit tim, sigurisht që ai do të shterej, para se të soseshin fjalët e Zotit tim, edhe sikur Ne të sillnim si ndihmë edhe një det tjetër si ai.”** (El Kehf, 109) Gjithashtu, Ai thotë: “**Sa i takon Musait, Allahu i ka folur atij drejtpërdrejt.**” (En Nisa, 164) Dhe thotë: “**Kur Musai erdhi në kohën e caktuar dhe Zoti foli me të...**” (El Araf, 143) Cilësia e të folurit nënkupton se Allahu flet me fjalë reale që dëgjohen, me shkronja dhe me zë, por që nuk u ngjan fjalëve të krijesave. Ai flet kur të dëshirojë, me çfarë të dojë, si të dëshirojë; me fjalë të vërteta dhe të drejta, me fjalë që nuk sosën. Allahu i Lartësuar ka qenë dhe vazhdon të jetë Folës. Sa i përket origjinës së cilësisë së të folurit, është cilësi qenësore⁷⁰, kurse sa u përket pjesëve të saj, janë cilësi veprore⁷¹.

Të gjitha këto lloje të cilësive janë të vërteta sipas realitetit të tyre. Demos duhet t’i pohojmë dhe t’i lëmë ashtu siç kanë ardhur dhe sipas kuptimit të tyre të dukshëm, pa i shtrembëruar, pa i mohuar, pa i shëmbëllyer dhe pa u përshkruar formë. Ky është rregull i pandryshueshëm të të gjitha cilësitë, pa përjashtim. Ajo që thuhet për disa cilësi, thuhet edhe për të tjerat, nuk ka dallim mes tyre. Ndërkaq, ata që bëjnë dallime mes tyre, kanë marrë vendim kokë më vete.

68 Muslimi (537), përcjellë nga Muavije ibn el Hakem es Sulemi, *Allahu qofitë i kënaqur me të!*

69 Shih suret: El Araf, 54; Junus, 3; Er Rad, 2; El Furkan, 59; Es Sexhde, 4 dhe El Hadid, 4. Shënim i përkthyesit.

70 Sepse Allahu ka qenë Folës dhe do të jetë gjithnjë. Shënim i përkthyesit.

71 Sepse të folurit varet nga dëshira e Allahut: Ai flet kur të dëshirojë. Shënim i përkthyesit.

Në kapitullin e emrave dhe cilësive të Allahut kanë devijuar disa grupe, pjesëtarë të kiblës, si:

1) Shëmbëlluesit

Ithtarët e shëmbëllimit janë ata që e kanë tepruar në pohimin e emrave dhe cilësive, derisa kanë rënë në shëmbëllim. Dyshimi i tyre është se, shëmbëllimin e përmbajtkan tekstet fetare, sepse Allahu iu paskësh drejtuar njerëzve në bazë të asaj që njihet te krijesat!

Kundërpërgjigjja ndaj tyre jepet në disa aspekte

Së pari: Allahu, në vargje të qarta e të drejtpërdrejta kuranore, ka mohuar për Vetën të ketë të ngjashëm, të krahasueshëm e të barabartë me Të. Allahu i Lartësuar thotë: **“Asgjë nuk i shëmbëllen Atij.”** (Esh Shura, 11) **“Prandaj, mos sajoni me vetëdije zota të barabartë me Allahun.”** (El Bekare, 22) **“Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Të!”** (El Ihlas, 4) Rrjedhimisht, nuk ka mundësi që fjala e Allahut të jetë kontradiktore.

Së dyti: Mendja e shëndoshë nuk e pranon që i Adhuruari, Krijuesi i përkryer, të jetë sikurse robi, që është krijesë e mangët. Sikundërqë Qenia e Tij nuk u përngjan qenieve të tjera, ashtu edhe cilësitë e Tij nuk u përngajnë cilësive të tjerëve.

Së treti: Allahu u është drejtuar njerëzve sipas asaj që e njohin në bazë të kuptimit. Jo domosdoshmërisht ngjashmëria në kuptimin e përgjithshëm dhe absolut duhet krahasuar me realitete dhe forma. Meqë përputhja e emrave ndërmjet vetë krijesave nuk tregon medoemos përngjasimin ndërmjet tyre, si shprehja: dëgjimi, shikimi, fuqia, dora e fytyra; atëherë, ndërmjet Krijuesit dhe krijesës është më parësore (të mos ketë shëmbëllim).

2) Mobuesit e cilësive

Ithtarët e mohimit janë ata që e kanë tepruar në dëlirjen dhe lartësimin e Allahut, aq sa kanë rënë në mohim dhe refuzim të cilësive të Tij. Dyshimi i tyre është se, pohimi i cilësive e bën të domosdoshëm shëmbëllimin e Allahut me krijesat, se me këto cilësi u përshkruaka krijesa, kështu që është obligim t'i mohohen Krijuesit. Ata ia pohojnë Allahut ekzistencën absolute të pakufizuar me ndonjë cilësi. Ata që më së shumti i mohojnë cilësitë e Allahut janë *keramitët*

*ezoterikë*⁷², të cilët ia mohojnë Atij dy të kundërtat⁷³; pas tyre xehemitë, të cilët i mohojnë edhe emrat, edhe cilësitë; pasuar nga mutezilitë, të cilët i pohojnë emrat, por i mohojnë cilësitë që përmbajnë ata emra.

Kundërpërgjigjja ndaj tyre jepet në disa aspekte

Së pari: Allahu i Lartësuar ia ka pohuar Vetes së Tij cilësitë në vargje të qarta kuranore e me kuptim të drejtpërdrejtë dhe të detajuar, si dhe i ka theksuar ato në bashkëvjajtje me mohimin e shëmbëllimit (të tyre me ato të krijesave), si në fjalën e Tij: **“Asgjë nuk i shëmbëllen Atij. Ai i dëgjon të gjitha dhe i sheh të gjitha.”** (Es Shura, 11) Rrjedhimisht, nuk ka mundësi që fjala e Allahut të jetë kontradiktore.

Së dyti: Pohimi i një ekzistence absolute, që nuk pranon përshkrimin me ndonjë cilësi, në realitet nuk ekziston, ajo thjesht është vetëm një ide në mendjet e tyre. Së këndejmi, thënia e tyre çon në mohimin e Krijuesit.

Së treti: Përshkrimi me fjalë të përgjithshme, absolute dhe gjithëpërfshirëse i diçkaje konkrete jo domosdoshmërisht tregon se po ajo do të jetë e pranishme në diçka tjetër konkrete. Madje, secili prej tyre është një prej individëve të kësaj cilësie të përgjithshme, për faktin se, kur cilësia kufizohet ose atribuohet (te dikush), përjashtohet ngjashmëria në pamjen e jashtme.

3) Keqinterpretuesit

Ithtarët e keqinterpretimit janë ata të cilët besojnë se disa tekste që flasin rreth cilësive, bie fjala, cilësitë veprore dhe ato që përmenden në tekste, nuk tregojnë ndonjë cilësi reale që i përket Allahut të Lartësuar. Ata filluan të hulumtonin kuptime të tjera, në mënyrë që tekstet t'i lidhnin me to, duke mos pasur kurrfarë argumenti të saktë që t'ua lejonte tjetërsimin e fjalës nga kuptimi i saj i dukshëm në kuptime të tjera jo të qarta, duke e quajtur shtrembërimin e tyre të teksteve si interpretim.

⁷² Keramitët janë një sekt i shiitëve ismaili, të cilët emrin e kanë marrë nga themeluesi i tyre Hamdan Kurmuti. Keramitët gjatë historisë kanë bërë krime makabre ndaj muslimanëve, madje kanë sulmuar Qabënë dhe kanë vrarë haxhilerët, kanë rrëmbyer derën e Qabesë dhe Gurin e Zi, të cilin e kanë mbajtur diku 25 vjet. Ezoterikë janë ata që besojnë se Kurani dhe vargjet e tij kanë kuptime të brendshme. Madje, sipas tyre, çdo kuptim i brendshëm degëzohet edhe më tej në kuptim të brendshëm, kuptime këto që i kuptuakun vetëm dijetarët e këtyre sekteve. Shënim i përkthyesit.

⁷³ Ata thonë: Nuk është as Dëgjues, as i shurdhër; nuk është as Shikues, as i verbër. Shënim i përkthyesit.

Kundërpërgjigjja ndaj tyre jepet në disa aspekte

Së pari: Allahu është më i dituri rreth Vetes së Tij, është më i vërteti dhe më i bukuri në fjalë sesa krijesat e Veta. Po ashtu, i Dërguari i Tij, *sal-lallahu alejhi ue selem*, është më i dituri rreth Zotit të Tij, më i vërteti në fjalë, më oratori në sqarim dhe këshilluesi më i mirë i muslimanëve. Atëherë, si ka mundësi që dikush ta korrigojë Allahun e të Dërguarin e Tij dhe ta konsiderojë fjalën e tyre si thirrje në përshtjellim të së vërtetës dhe devijim?!

Së dyti: Në parim, fjala duhet kuptuar në bazë të realitetit të saj. Interpretimi i saj është i saktë vetëm me ndonjë argument të saktë, që e bën të domosdoshëm kalimin nga kuptimi i saj i dukshëm në atë alegorik. Përndryshe, për këtë nuk ka argument.

Së treti: I Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ua ka sqaruar njerëzve atë që i është zbritur nga Zoti dhe e ka kumtuar mesazhin në formë të qartë. Andaj, është e pamundur që i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ta lërë këtë kapitull madhështor pa e sqaruar qëllimin të cilin e pretendojnë ata shtrembërues rreth kuptimeve të shpikura!

4) Mosnjohësit

Ithtarët e mosnjohjes besojnë se kuptimet (e cilësive) që Allahu i ka njoftuar mbi Vetën e Tij apo i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka njoftuar për to, janë të panjohura për ne dhe se ato nuk i di askush përveç Allahut. Nuk ka mundësi që askush të mos i dijë ato (domethënie)! Ata e quajnë rrugën e tyre *et tefvid*⁷⁴.

Kundërpërgjigjja ndaj tyre jepet në disa aspekte

Së pari: Nuk ka mundësi që kapitulli i cili flet rreth njohjes së Allahut, që njëherazi është kapitulli më i çmuar i fesë, të jetë i mbyllur. As mendja e as tekstet fetare nuk aludojnë në një gjë të tillë!

Së dyti: Allahu i Lartësuar e ka zbritur Kuranin në gjuhën e qartë arabe dhe i ka urdhëruar robërit e Tij që ta logjikojnë atë, t'i meditojnë kuptimet e tij, pa përjashtuar asgjë prej tyre. Kjo tregon se kuptimet e cilësive mund të dihen. E,

⁷⁴ *Tefvid*-i nënkupton se domethënia dhe kuptimi i cilësive duhet t'i lihen Allahut të Lartësuar. Sipas tyre, nuk duhet të flitet asgjë rreth cilësive të Tij dhe kuptimeve që bartin ato. Si rezultat i kësaj del se Allahu u ka folur njerëzve me fjalë të pakuptueshme. Ky është kuptim i pasaktë e i kotë dhe bie ndesh me bazat e kësaj feje. Shënim i përkthyesit.

sa i përket formës dhe realitetit të tyre, ato janë gjëra të fshehta, dija e të cilave i autorizohet Allahu.⁷⁵

Së treti: Ndjekja e kësaj rruge rezulton në konsiderimin e pararendësve të këtij umeti për injorantë dhe në përshkrimin se kanë qenë në pozitat e analfabetëve, që nuk e kuptonin Kuranin, porse thjesht e lexonin atë. Ndërkaq, vargjet kuranore që flasin rreth cilësive, sipas tyre, janë enigma dhe shkronja të fjalorit, që nuk japin ndonjë kuptim të logjikshëm.



75 Një burrë kishte shkuar te Malik ibn Enesi, Allahu e mëshiroftë!, e i kishte thënë: “O Ebu Abdurrahman, i Gjithëmëshirshmi është ngritur lart mbi Fron. Por, si është ngritur?” Imam Maliku uli kokën dhe iu përgjigj: “Që është ngritur lart, është e njohur, ama mënyra është e panjohur. Ta besosh (që është ngritur) është detyrë, porse të pyesësh për mënyrën, është bidat. Prandaj, mendoj se je i humbur.” Shënim i përkthyesit.



BESIMI NË MELEKËT

Besimi në melekët (engjëjt) nënkupton bindjen e palëkundshme se Allahu ka krijuar krijesa vetëm për ta adhuruar Atë, ka zgjedhur që t'i nënshtrohen Atij, i ka veçuar me afërsinë e Tij, i ka bërë banorë të qiejve dhe u ka dhënë fuqinë për ta përmbushur urdhrin e Tij.

Besimi në melekët është i plotë vetëm nëse besohet se:

1. Ata janë robër të nderuar, të drejtë e të afërm të Tij; janë të nënshtruar dhe i frikësohen Zotit të tyre

Ata nuk posedojnë asnjë veçori të zotërimit (*rububijes*) dhe adhurimit (*ulubijes*). Allahu i Lartësuar thotë: **“Ata thonë: “I Gjithëmëshirshmi ka për Vete një bir (engjëll).” Qoftë i lavdëruar Ai dhe i lartësuar! Jo, ata (engjëjt) janë robër të nderuar. Ata nuk flasin para (Fjalës së) Tij dhe veprojnë me Urdhrin e Tij. Ai e di se ç’ka para tyre (çfarë kanë vepruar) dhe ç’ka pas tyre (çfarë do të veprojnë), ndërsa ata ndërmjetësojnë vetëm për atë me të cilin Ai është i kënaqur, e prej frikës së Tij qëndrojnë me nderim dhe frikë (se mos i ndëshkon).”** (El Enbija, 26-28) Gjithashtu, Ai thotë: **“Ata i frikësohen Zotit të tyre lart mbi ta dhe bëjnë atë që u urdhërohet.”** (En Nahl, 50) Po ashtu, thotë: **“... të cilët kurrë nuk i kundërshtojnë urdhrat e Allahut, por i zbatojnë menjëherë ata.”** (Et Tahrim, 6) Njashtu, thotë: **“Të ndershëm dhe të drejtë.”** (Abese, 16) Dhe thotë: **“Ditën, kur do t’i tubojë të gjithë, do t’u thotë engjëjve: “Vallë, këta ju adhuronin?”** Ata do të thonë: **“Qofsh i lavdëruar Ti, o Zoti ynë! Ti je Mbrojtësi ynë, jo ata. Ata adhuronin xhinët dhe shumica e mohuesve u besonin atyre.”** (Sebe’, 40-41) Si dhe thotë: **“Qofsh i lavdëruar! - thanë ata (engjëjt) - Ne dimë vetëm atë që na ke mësuar Ti. Në të vërtetë, Ti je i Gjithëdituri, i Urti.”** (El Bekare, 32)

2. Ata janë të emërtuar me emra fisnikë

Ata të cilëve ua dimë emrat, i besojmë me emra, kurse ata të cilëve nuk ua dimë, i besojmë në formë të përgjithshme. Ndër emrat e melekëve fisnikë të cilët i dimë janë: Xhibrili, Mikaili, Israfil, Meleku i Vdekjes, Maliku, Ridvani, Munkeri dhe Nekiri, ashtu siç kanë ardhur në Kuranin fisnik dhe në Sunetin autentik.

3. Ata janë të krijuar prej dritës, posedojnë flatra, kanë forma gjigande e të shumëllojshme

Allahu i Lartësuar thotë: **“Lavdërimi qoftë për Allahun, krijuesin e qiejve dhe Tokës, i Cili i ka bërë engjëjt të dërguar me nga dy, tre dhe katër krahë. Ai shton në krijim çfarë të dojë. Allahu, me të vërtetë, është i pushtetshëm për çdo gjë.”** (Fatir, 1) Ndërkaq, i Dërguari, *sal-lallabu alejhi ue selem*, ka thënë: *“Melekët janë krijuar prej dritës.”* (Shënon Muslimi)⁷⁶ Në dy përmbledhjet e haditheve të sakta shënohet se i Dërguari, *sal-lallabu alejhi ue selem*: *“E ka parë Xhibrilin në formën e Tij (reale), me ç’rast kishte gjashtëqind palë flatra, me të cilat e mbulonte horizontin.”*⁷⁷ Gjithashtu, i Dërguari, *sal-lallabu alejhi ue selem*, ka thënë: *“Më është dhënë leje të flas për një nga melekët e Allahut të Lartësuar, që është nga bartësit e Arshit (Fronit). Largësia ndërmjet lapës së veshit të tij deri te supet është sa shtatëqind vjet udhëtim.”* (Shënon Ebu Davudi)⁷⁸ Ata janë krijesa reale, e jo forca abstrakte, siç mendojnë disa të krisur. Ata janë krijesa të shumta, nuk mund t’i llogarisë askush përveç Krijuesit të tyre. Në hadithin e Enesit, që e shënojnë imam Buhariu dhe imam Muslimi, përcillet ndodhia e *Miraxhit*:⁷⁹ *“I Dërguari, sal-lallabu alejhi ue selem, është ngritur në Bejtul Mamur, në qiellin e shtatë, tek falen çdo ditë shtatëdhjetë mijë melekë, e, kur të dalin, nuk kthehen më në të.”*⁸⁰

4. Ata qëndrojnë në radhë dhe e lartësojnë Allahun

Allahu i ka inspiruar për ta lartësuar Atë, për ta zbatuar urdhrin e Tij dhe ua ka dhënë fuqinë për ta ekzekutuar atë. Allahu i Lartësuar thotë: **“Çdonjëri prej nesh e ka vendin e caktuar (në qiell, ku adhuron Allahun). Ne jemi ata që qëndrojnë në radhë dhe ne jemi ata që e lavdërojnë Atë!”** (Es Safat, 164-166) Gjithashtu, Ai thotë: **“E, nëse idhujtarët tregohen kryeneçë, le ta dinë se ata (engjëjt) që janë te Zoti yt e lavdërojnë Atë natën dhe ditën e kurrë nuk ndihen të lodhur.”** (Fusilet, 38) Dhe thotë: **“... por e lavdërojnë (Atë) natën dhe ditën, paprerë.”** (El Enbija, 20)

76 Muslimi (2996), përcjellë nga Aishja, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

77 Buhariu (3234) dhe Muslimi (177), përcjellë nga Aishja, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*; si dhe Buhariu (3232) e Muslimi (174), përcjellë nga Ibn Mesudi, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

78 Ebu Davudi (4727), përcjellë nga Aishja, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

79 Ngritja në qiell e të Dërguarit, *sal-lallabu alejhi ue selem*. Shënim i përkthyesit.

80 Buhariu (3207) dhe Muslimi (162).

Nga Hakim ibn Hizami, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, përcillet se ka thënë: “Teksa i Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, po qëndronte me shokët e tij, u kishte thënë: “*A po e dëgjoni atë që po dëgjoj unë?*” Ata ia kthyen: “Ne nuk po dëgjojmë asgjë.” Atëherë u tha: “*Po e dëgjoj gërvimën e qiellit, ndërkohë nuk qortobet pse gërvim, ngase nuk ka asnjë hapësirë, as sa një pëllëmbë, e të mos jetë aty një melek duke bërë sexhde apo duke qëndruar në këmbë.*” (Shënon Taberaniu, ndërsa Albani ka thënë: Hadithi është sahih, sipas kriterëve të Muslimit)⁸¹

5. Ata nuk mund të shihen

Janë krijesa të padukshme. Në këtë botë nuk mund të përkapen përmes shqisave njerëzore, veçse për atë që do Allahu, sikurse rasti kur i Dërguari ynë, *sal-lallahu alejhi ue selem*, e ka parë Xhibrilin në formën në të cilën e ka krijuar Allahu. Por, ata do të shihen në botën tjetër. Allahu i Lartësuar thotë: **“Ditën, kur të shohin engjëjt, për keqbërësit nuk do të ketë lajm të mirë dhe do t’u thuhet: “Nuk do të kaloni dot për matanë.”** (El Furkan, 22) Gjithashtu, Ai thotë: **“Dhe engjëjt do të hyjnë tek ata nga çdo derë (e Xhenetit).”** (Er Rad, 23) Mirëpo, Allahu ua ka dhënë aftësinë që të shndërrohen dhe të marrin formën njerëzore. Allahu i Lartësuar thotë: **“Ne i dërguam Shpirtin Tonë (Xhiblirin), i cili iu paraqit asaj (Merjemes) si një njeri i plotë.”** (Merjem, 17) Po ashtu, Ai thotë: **“Të dërguarit Tanë (engjëjt), i sollën Ibrahimit lajmin e mirë dhe i thanë: “Paqe mbi ty!” Ai iu përgjigj: “Paqja qoftë mbi ju!” Dhe me të shpejtë u solli atyre një viç të pjekur. Kur pa se ata nuk po i zgjasnin duart te mishi, nuk i pëlqeu dhe ndjeu frikë prej tyre. (Engjëjt) thanë: “Mos u frikëso, Ne jemi dërguar te populli i Lutit”. (Hud, 69-70) Dhe thotë: **“Kur të dërguarit Tanë (engjëjt) i vajtën Lutit, Ai u hidhërua, ndjeu një shtrëngim në shpirtin e tij dhe tha: “Kjo është ditë e rëndë!” Populli i tij, që më parë pat punuar vepra të këqija, u vërsul drejt tij. (Luti) tha: “O populli im, këto janë bijat e mia. Ato për ju janë më të pastra, e frikësojuni Allahut dhe mos më turpëroni para mysafirëve të mi. A nuk ka midis jush një njeri me mend?”** (Hud, 77-78) Ata, paqja qoftë mbi ta!, ishin në formë burrash. Njashtu, kur Xhibrili i vajti të Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, në formë të një njeriu tejet rrobëbardhë e fort flokëzi. Herë-herë i vente në fizionominë e Dihje el Kelbiut⁸², *Allahu qoftë i kënaqur me të!***

81 Shënon Taberaniu në *El Musxhem el kebir* (3122) dhe shiko: *Es Siksileh es sahiba*, të Albanit (852).

82 I cili ishte një prej shokëve të Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*. Shënim i përkthyesit.

6. Ata janë të ngarkuar me detyra të ndryshme

Krahas detyrës së tyre esenciale dhe të vazhdueshme, siç është adhurimi dhe lartësimi që ia kushtojnë Allahut, ata kanë detyra të tjera. Ja disa prej tyre:

1) Zbritja e shpalljes hyjnore

Kjo është detyra e Xhibrilit, *alejhi selam*. Allahu i Lartësuar thotë: **“Thuaj: “Atë (Kuranin) e ka zbritur Shpirti i Shenjtërisë nga Zoti yt me të vërtetën, për t’i forcuar ata që besojnë dhe për të qenë udhërrëfyes dhe lajm i mirë për ata që i dorëzohen Allahut.”** (En Nahl, 102) Gjithashtu, Ai thotë: **“Nuk ka dyshim se ky (Kuran) është Shpallja e Zotit të botëve. Atë e zbriti Shpirti i besueshëm (Xhibrili) në zemrën tënde (o Muhamed) që të jesh nga ata që paralajmërojnë.”** (Esh Shuara, 192-194)

2) Zbritja e reshjeve dhe mbirja e tokës

Kjo është detyra e Mikailit, *alejhi selam*, siç shënon Ahmedi, kur çifutët i kishin thënë të Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selemr*: *“Po të thoshe që Mikaili e zëbret mëshirën, mbirjen (e tokës) dhe reshjet, do të të kishim besuar.”*⁸³

3) Fryrja në Sur⁸⁴

Kjo është detyra e Israfilin, *alejhi selam*, i cili do t’i fryjë dy herë: herën e parë për të vdekur të gjithë (përveç atyre që do Allahu), kurse herën e dytë për t’u ringjallur. Allahu i Lartësuar thotë: **“Kur do t’i fryhet Surit, do të vdesin të gjithë ata që gjenden në qiej dhe në Tokë, përveç atyre që do Allahu; pastaj do të fryhet për të dytën herë në Sur dhe ata përnjëherë do të ngjallen e do të presin.”** (Ez Zumer, 68)

Këta tre: Xhibrili, Mikaili dhe Israfilin, janë melekët kryesorë, sepse detyra e tyre është e ndërlidhur me jetën. Xhibrili ka qenë i ngarkuar me jetën e zemrave (shpalljen hyjnore), Mikaili është i ngarkuar me jetën e bimëve, Israfilin është ngarkuar me jetën e trupave. Prej tyre më i nderuari është Xhibrili, *alejhi selam*, i cili njëkohësisht është edhe Shpirti i Shenjtërisë (*Ruhul Kudus*).

83 Ahmedi (2483), përcjellë nga Ibn Abasi, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*; si dhe Taberaniu në El Muxhem el kebir (12061), përcjellë nga Ibn Abasi, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

84 *Suri* (briri) që njofton ardhjen e Kiametit dhe Ringjalljen. Shënim i përkthyesit.

4) *Ruajtja e njerëzve*

Allahu i Lartësuar thotë: “Njeriu ka përcjellës (engjëj), para tij dhe pas tij, që e ruajnë atë me urdhrin e Allahut. Me të vërtetë, Allahu nuk e ndryshon gjendjen e një populli, derisa ata të ndryshojnë ç’kanë në vetvete. Kur Ai dëshiron ta ndëshkojë një popull, askush nuk mund ta pengojë Atë; dhe ata, përveç Tij, s’kanë asnjë ndihmës.” (Er Rad, 11)

5) *Ruajtja e veprave të njerëzve*

Allahu i Lartësuar thotë: “Dy engjëj i rrinë atij nga e djathta dhe e majta, e, për çdo fjalë që ai thotë, ka pranë vetes një mbikëqyrës të gatshëm (për ta shënuar atë).” (Kaf, 17-18)

6) *Forcimi dhe të ndihmuarit e besimtarëve*

Allahu i Lartësuar thotë: “(Kujto o Muhamed) kur Zoti yt i frymëzoi engjëjt: “Unë jam me ju, andaj forcojini ata që besojnë. Unë do të shtie frikë në zemrat e mohuesve, andaj goditini në qafë dhe në të gjithë gishtërinjtë.” (El Enfal, 12)

7) *Marrja e shpirttrave*

Kjo është detyrë e engjëllit të vdekjes (*Melekul Meutit*)⁸⁵. Allahu i Lartësuar thotë: “Thuaj: ‘Shpirtin do t’jua marrë engjëlli i vdekjes, i cili është ngarkuar për ju, e pastaj do të ktheheni te Zoti juaj.’” (Es Sexhde 11) Gjithashtu, i Lartësuari thotë: “Ai ju dërgon rojtarë (engjëj) të cilët, kur ndonjërit nga ju i vjen vdekja, ia marrin shpirtin, duke mos bërë kurrfarë lëshimi.” (El Enam, 61)

8) *Marrja e të vdekurit në pyetje në varrin e tij për Zotin, fenë dhe të Dërguarin e Tij*

Ata që marrin në pyetje janë Munkerit dhe Nekirit.

Nga Enes ibn Maliku, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, përcillet se i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “Kur robi të vendoset në varr dhe kur të largohen shokët e tij, ai e dëgjon kërcitjen e nallaneve të tyre, e po aty i venë dy melekë, me ç’rast e ulin dhe i thonë: “Ç’thoshe për atë njeri, Muhamedin, sal-lallahu alejhi ue selem?” Besimtari do të

⁸⁵ Te shumë njerëz është e përhapur se emri i tij është Azrail, por një gjë e tillë nuk vërtetohet. Prof. dr. Nasir el Kifari, *Allahu e ruajtë, Mubadarat fil akide*, f. 23. Shënim i përkthyesit.

thotë: “Dëshmoj se ai është rob dhe i Dërguari i Allahut.” I thubet: “Shikoje vendin tënd në Zjarr. Allahu ta ka zëvendësuar atë me një vend në Xhenet.” Kështu, ai i sheh të dyja vendet. Ndërkaq, hipokritit dhe jobesimtarit i thubet: “Ç’toshe për atë njeri?” Do të thotë: “Nuk di... Thosha atë që thoshin njerëzit.” Do t’i thubet: “As e dije, as lexoje.” Pastaj e godasin me një çekan të hekurt, aq fort, saqë e lëshon një britmë të cilën e dëgjon çdo gjë përreth tij, përveç njerëzve dhe xhinëve.” (E shënojnë Buhariu dhe Muslimi)⁸⁶

Në një motërzim të Tirmidhiut, përcjellë nga Ebu Hurejra, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, qëndron: “Kur të varroset i vdekuri, ose ka thënë, ndonjëri prej jush, i venë dy melekë të zinj, (e sy-) kaltër, njëri qubet Munker e tjetri Nekir, i thonë: “Çfarë thoshe për këtë njeri?...” Ajo që ka ardhur në hadith.⁸⁷

9) Kujdesi për embrionin (në mitrën e nënës)

Që bëhet duke i fryrë (dhënë) shpirtin, shkruar rriskun (furnizimin), jetëgjatësinë, punën dhe në do të jetë fatzi apo i lumtur (në botën e amshuar). Nga Abdullah ibn Mesudi, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, përcillet se ka thënë: “I Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, i cili është fjalëdrejti i besueshmi, ka thënë: “Çdo njeri formohet në mitrën e nënës së tij (duke qëndruar) dyzet ditë si një pikë uji, pastaj, për po aq ditë, shndërrohet në copë gjaku, më pas, shndërrohet në një copë mishi për po aq ditë. Pas kësaj, Allahu e dërgon një melek (engjell), të cilit i urdhëroben katër gjëra, duke iu thënë: “Shkruaja punën, rriskun e jetëgjatësinë e tij, si dhe a do të jetë fatzi apo i lumtur (në botën e amshuar). Më pas i frybet atij shpirti...” Siç ka ardhur në hadith.⁸⁸

10) Rojat e Zjarrit

Allahu i Lartësuar thotë: “**Ne kemi bërë rojtarë të Zjarrit vetëm engjëjt...**” (El Mudethir, 31) Gjithashtu, Ai thotë: “**Ata do të thërrasin: “O Malik! (Më mirë) Le të na bëjë Zoti yt të vdesim!”**”, ndërsa ai do të thotë: “**Ju do të qëndroni përherë aty!**” (Ez Zuhruf, 77) Dhe thotë: “**O ju, që besoni! Ruani veten dhe familjet tuaja nga Zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit**”

86 Buhariu (1374) dhe Muslimi (2870).

87 Tirmidhiu (1071). Albani, në *Es Silsilah es sahiha*, ka thënë: “Zinxhiri i tij transmetues është i mirë. Të gjithë transmetuesit janë të besueshëm dhe janë transmetues të Muslimit.”

88 Buhariu (3208) dhe Muslimi (2643) pa e përmendur: “... një pikë uji (en nutfeh)...” E shënon Ebu Avaneh, i cili e përmend: “... një pikë uji (en nutfeh)...”, siç qëndron në Fet’hul Bari, të Ibn Haxherit (15/189).

dhe gurët. Atë e mbikëqyrin engjëj të fuqishëm e të ashpër, të cilët kurrë nuk i kundërshtojnë urdhrat e Allahut, por i zbatojnë menjëherë ata.”

(Et Tahirim, 6)

11) Ata kërkojnë falje për besimtarët, luten për ta, i përgëzojnë dhe i nderojnë në Xhenet

Allahu i Lartësuar thotë: “Ata (engjëj), që e mbajnë Fronin (Arshin) dhe ata që janë rreth tij, e madhërojnë Zotin e tyre me falënderim dhe i besojnë Atij. Ata lypin falje për besimtarët, duke thënë: “O Zoti ynë, Ti përfshin çdo gjë me mëshirën dhe dijeninë Tënde, prandaj fali ata që janë penduar e që ndjekin rrugën Tënde dhe ruaji ata prej dënimit të Zjarrit flakërues! O Zoti ynë, shpiji ata në kopshtet e Adnit, të cilat ua ke premtuar, së bashku me prindërit e tyre, bashkëshortet e tyre dhe pasardhësve e tyre të devotshëm! Ti je i Plotfuqishmi dhe i Urti. Dhe shpëtoji ata nga e keqja! Atë që Ti e shpëton nga e keqja atë Ditë, Ti e ke mëshiruar; e ky, me të vërtetë, është shpëtimi i madh!” (Gafir, 7-9) Gjithashtu, Ai thotë: “Me të vërtetë, atyre që thonë: “Zoti ynë është Allahu”, e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t’u zbresin engjëjt (para vdekjes) e do t’u thonë: “Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni Xhenetit që ju është premtuar.” (Fussilet, 30) Dhe thotë: “Dhe engjëjt do të hyjnë tek ata nga çdo derë (e Xhenetit) (e do t’u thonë): “Shpëtimi qoftë mbi ju, për durimin që keni treguar (në jetën e kësaj bote)! Sa vendbanim i bukur që është ky!” (Er Rad, 23-24)





BESIMI NË LIBRAT

Besimi në librat nënkupton bindjen e palëkundshme se Allahu i Lartësuar u ka zbritur të dërguarve të Tij libra me të vërtetën, të cilët janë udhëzim, mëshirë e këshillë për njerëzit e argument kundër tyre, si dhe sqarues për çdo gjë.

Besimi në librat përfshin disa çështje:

1. Besimi se librat në fjalë janë të zbritur nga Allahu me të vërtetën

Allahu i Lartësuar thotë: **“Ai të ka shpallur ty Librin, me të vërtetën e saktë, duke vërtetuar shpalljet e mëparshme. Ai i ka zbritur Teuratin dhe Inxhilin (Ungjillin).”** (Alu Imran, 3) Ata janë librat e Allahut dhe fjalët e Tij; nuk janë fjalë të ndonjë meleku të privilegjuar e as të ndonjë profeti të dërguar. Ata posedojnë cilësinë e pagabueshmërisë dhe të shenjtërisë.

2. Besimi në mënyrë konkrete për secilin që ia dimë emrin, kurse në ata të cilëve nuk ua dimë emrat, besojmë në mënyrë të përgjithshme

Më madhështorët janë tre:

1) *Teurati, të cilin Allahu i Lartësuar ia ka zbritur Musait, alejhi selam*

Allahu i Lartësuar thotë: **“Zoti tha: “O Musa! Unë të kam zgjedhur ty mbi të tjerët me kumtet e Mia dhe të Folurin Tim (pa ndërmjetës, por të drejtpërdrejtë). Merre atë që ta kam dhënë dhe bëhu mirënjohës!”** Ne i shkruam në Pllaka udhëzime dhe shpjegime për gjithçka: **“Merri këto me bindje dhe urdhëroje popullin tënd që t’i përvetësojë në mënyrën më të mirë. Unë do t’ju tregoj shtëpinë e të pabindurve.”** (El Araf, 144-145) Gjithashtu, thotë: **“Ne kemi dërguar Teuratin, në të cilin janë udhëzimet dhe drita. Sipas tij, profetët që ia kishin dorëzuar veten Allahut, i gjykonin hebrenjtë; por edhe të diturit dhe rabinët kështu vepronin, sepse atyre iu qe besuar mbrojtja e Librit të Allahut, për të cilin ata dëshmonin.”** (El Maide, 44)

2) *Inxhili (Ungjilli), të cilin Allahu i Lartësuar ia ka zbritur Isait, alejbi selam*

Allahu i Lartësuar thotë: “Pas tyre Ne çuam të dërguar të tjerë, mandej dërguam Isain, të birin e Merjemes. Ne i dhamë atij Inxhilin (Ungjillin)...” (El Hadid, 27) Po ashtu, thotë: “Dhe i dhamë atij Inxhilin (Ungjillin), në të cilin ka udhëzim dhe dritë, si përmbushje të asaj që ishte shpallur para tij në Teurat dhe si udhërrëfim e këshillë për ata që i frikësohen Allahut.” (El Maide, 46)

3) *Kurani, të cilin Allahu i Lartësuar ia ka zbritur Muhamedit, sal-lallabu alejbi ue selem*

Ai është më i madhështori ndër të gjithë ata. Allahu i Lartësuar thotë: “Ne të kemi zbritur ty (o Muhamed) Librin me të vërtetën, si përmbushës të shkrimeve të mëparshme dhe mbrojtës të tyre.” (El Maide, 48) Gjithashtu, i Lartësuar thotë: “I Lartësuar qoftë Ai që i ka zbritur Dalluesin⁸⁹ robit të Vet,⁹⁰ që të jetë paralajmërues për botët.” (El Furkan, 1)

Ndër librat e Allahut është edhe Zeburi, të cilin ia ka dhënë Davudit, *alejbi selam*. Allahu i Lartësuar thotë: “... dhe Davudit i kemi dhënë Zeburin.” (El Isra, 55) Dhe Fletët e Ibrahimit, *alejbi selam*. Allahu i Lartësuar thotë: “Kjo, me të vërtetë, ndodhet në Fletët e lashta, në Fletët e Ibrahimit dhe Musait.” (El Ala, 18-19)

3. Besimi i lajmeve që nuk kanë pësuar ndryshime (përveç Kuranit)

Allahu i Lartësuar ka treguar se librat e bijve të Izraelit kanë pësuar shtrembërim tekstual dhe kuptimor. Allahu i Lartësuar thotë: “Ata i kanë shtrembëruar fjalët e Shkrimeve të shenjta.” (El Maide, 13) Njashtu, thotë: “Ata i ndryshojnë vendet e fjalëve (në tekstet e shenjta).” (El Maide, 41) Dhe thotë: “Me të vërtetë, një grup ithtarësh të Librit e shtrembërojnë Librin me gjuhët e tyre (ndërsa e lexojnë atë), që ju të mendoni se ai farë leximi është prej Librit (që ka zbritur Allahu), kurse në të vërtetë, nuk është prej Librit.

⁸⁹ Pra, Kuranin, që dallon të vërtetën nga e pavërteta.

⁹⁰ Pra, profetit Muhamed, *sal-lallabu alejbi ue selem*.

Ata thonë: “Kjo që lexojmë është nga Allahu”, por ajo nuk është nga Allahu. Ata flasin gënjeshtër për Allahun, duke qenë të vetëdijshëm për këtë.” (Alu Imran, 78) Ndërkaq, Kuranin e madhërishtëm Allahu i Lartësuar ka marrë përsipër që ta ruajë. Allahu i Lartësuar thotë: **“Sigurisht, Ne e kemi shpallur Përkujtuesin (Kuranin) dhe, sigurisht, Ne do ta ruajmë atë.”** (El Hixhr, 9) dhe e ka mbrojtur atë. Allahu i Lartësuar thotë: **“Ata që e mohojnë Fjalën Tonë rikujtuese⁹¹, kur u vjen, do të dënohen rëndë. Ai është vërtet një Libër i madhërueshëm. Atij nuk mund t’i afrohet gënjeshtër nga asnjëra anë. Kjo është shpallje prej një të Urti që meriton të gjitha lavdet.”** (Fusilet, 41-42)

Duke u bazuar në këtë, tregimet dhe rrëfimet e përmendura në librat e ithtarëve të Librit (çifutëve dhe të të krishterëve) të cilat në terminologji quhet *“israiljate”*, përfshihen në njërin prej tri gjendjeve:

E para: Janë në përputhje me atë që gjendet në Kuran

Besojmë se ky lloj është i saktë ngaqë Libri ynë (Kurani) dëshmon për të, bie fjala, përmendja e Tufanit (përmbytjes), tregimi i Ibrahimit, Jusufit e Musait, fundosja e pasuesve të Faraonit, mrekullitë e Isait, *alejhi selam*, e të tjera, përjashtuar gjërat e detajuara që i përmbajnë ato.

E dyta: Janë në kundërshtim me atë që gjendet në Kuran

Për këtë lloj besojmë se është i kotë (i pasaktë), se është nga gjërat që i kanë shpifur e i kanë shkruar me duart e veta dhe i kanë shtrembëruar me gjuhët e tyre, bie fjala, pretendimi i tyre se Luti, *alejhi selam*, ka pirë alkool dhe ka bërë imoralitet me dy bijat e tij! Allahu e ka nderuar dhe e ka ruajtur atë nga një gjë e tillë apo, pretendimi i tyre se Isai (Jezusi) është vetë Allahu (Zoti), se është biri i Zotit, apo se është njëri prej Trinisë!⁹² Qoftë i lartësuar dhe i pastër Allahu nga ajo që thonë ata!

E treta: As janë në përputhje, as në kundërshtim (me atë që gjendet në Kuran)

Këtë lloj as e besojmë, as e përgënjeshtrojmë, bazuar në fjalën e të Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selem*: *“Kur t’ju flasin ithtarët e Librit, as mos u besoni, e as mos i*

⁹¹ Kuranin.

⁹² Shih suren el *Maide*, përkatësisht vargun e 73-të kuranor. Shënim i përkthyesit.

përgëneshtroni, por thoni: “Besojmë në Allahun, librat dhe të dërguarit e Tij.” Po të jetë e vërtetë, ju nuk i keni përgëneshtruar; e, po të jetë e pavërtetë, ju nuk u keni besuar.” (E shënojnë Ahmedi dhe Ebu Davudi)⁹³ Mirëpo, lejohet të flasim dhe t’i kallëzojmë tregimet e tyre, bazuar në fjalën e të Dërguarit, *sal-lallahu alejbi ue selem: “Tregoni rreth bijve të Izraelit pa druajtje!”* (E shënon Buhariu)⁹⁴ Në shumicën prej tyre nuk ka dobi e as nuk kemi nevojë për to.

4. Gjykimi me legjislacionin e Kuranit

Me të vërtetë, Allahu e ka zbritur Kuranin e madhërishtëm si mbizotërues të librave të mëparshëm. Pra, si gjykues, besnik e dëshmues për ta. Kurani i ka përfshirë dobitë që gjendeshin në librat e mëparshëm. Disa dispozita të tyre i ka shfuqizuar, e disa të tjera i ka aprovuar dhe ka shtuar. Nuk lejohet ndjekja e ndonjë legjislacioni tjetër përveç atij të Kuranit. Allahu i Lartësuar, pasi e përmend Teuratin dhe Inxhilin, thotë: **“Ne të kemi zbritur ty (o Muhamed) Librin me të vërtetën, si përmbushës të shkrimeve të mëparshme dhe mbrojtës të tyre. Prandaj gjykoji ata sipas asaj që të ka zbritur Allahu dhe mos ndiq dëshirat e tyre, duke u shmangur kështu nga e Vërteta që të është shpallur. Ne për secilin nga ju kemi sjellë një ligj dhe një rrugë të qartë. Sikur të donte Allahu, do t’ju kishte bërë një popull të vetëm, por Ai kërkon që t’ju provojë në atë që ju ka dhënë, andaj bëni gara për punë të mira! Të gjithë do të ktheheni tek Allahu e Ai do t’ju lajmërojë për çështjet rreth të cilave kishit kundërshti. Prandaj, gjykoji sipas asaj që të ka shpallur Allahu e mos ndiq dëshirat e tyre të kota! Ki kujdes që ata të të mos nxisin të largohesh nga një pjesë e asaj që të ka shpallur Allahu! Nëse ata të kthejnë kurrizin e nuk dëgjojnë gjykimin tënd, atëherë ta dish se Allahu do vetëm që t’i dënojë për disa gjynahe të tyre. Në të vërtetë, shumë njerëz janë të pabindur. A mos kërkojnë ata gjykimin (me ligjin) e (kohës së) injorancës (paganizmit paraislam)?! E kush është gjykatës më i mirë se Allahu për njerëzit që besojnë bindshëm?”** (El Maide, 48-50) Gjithashtu, thotë: **“Vërtet, Ne (o**

93 Ahmedi (17225) dhe Ebu Davudi (3644), përcjellë nga Ebu Nemle el Ensariu, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

94 Buhariu (3461), përcjellë nga Abdullah ibn Amri, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

Muhamed) ta kemi zbritur Kuranin me të drejtën, në mënyrë që ti të gjykosh ndërmjet njerëzve sipas asaj që të ka shpallur Allahu. Dhe mos u bëj mbrojtës i tradhtarëve!”⁹⁵ (En Nisa, 105)

5. Besimi në tërësinë e librave, pa kurrfarë përjashtimi

Allahu i Lartësuar thotë: “Mos vallë, një pjesë të Librit (Teuratit) e besoni, kurse pjesën tjetër e mohoni?! Cilido prej jush që vepron kështu, do të ndëshkohet me poshtërim në këtë jetë, ndërsa në Ditën e Kiametit do të dërgohet në dënimin më të ashpër. Allahu nuk është i pavëmendshëm ndaj veprimeve tuaja.” (El Bekare, 85) Gjithashtu, thotë: “Ja, ju i doni ata, por ata nuk ju duan ju dhe ju u besoni të gjithë librave (kurse ata jo)...” (Alu Imran, 119)

6. Ndalohet fshehja e ndonjë gjëje që përmbajnë ata, shtrembërimi, mospajtimi rreth tyre dhe përplasja e Fjalës së Allahut me njëra-tjetrën

Allahu i Lartësuar thotë: “Kujtoje (o Muhamed) kohën kur Allahu mori premtimin nga ata që u është dhënë Libri se do t’ua shpjegojnë atë njerëzve dhe nuk do të fshehin asgjë nga ai. Pastaj ata e hodhën pas shpine (premtimin) dhe e ndërruan atë me një vlerë të vogël. Eh, sa këmbim të shëmtuar që bënë ata!” (Alu Imran, 187) Gjithashtu, thotë: “Pa dyshim, ata që fshehin çfarë ka shpallur Allahu në Libër dhe e këmbëjnë atë me diçka tjetër të pavlerë, do të gëlltisnin në barkun e tyre vetëm zjarr. Në Ditën e Kiametit Allahu nuk do t’u flasë atyre, nuk do t’i pastrojë (nga gjynahet) dhe do t’u japë dënim të dhembshëm. Ata e kanë këmbyer rrugën e drejtë me humbjen dhe faljen e Zotit me dënimin e Tij. Po sa të durueshëm do të jenë në Zjarr?! Kjo është kështu, sepse Allahu e ka zbritur Librin me të vërtetën. Sigurisht, ata që nuk pajtohen rreth tij, janë të përçarë dhe larg së vërtetës.” (El Bekare, 174-176) Si dhe thotë: “Mjerë ata që me duart e tyre shkruajnë Librin, e pastaj thonë: “Kjo

⁹⁵ Komentuesit klasikë të Kuranit (Taberiu) bëjnë të ditur se ky varg dhe vargjet e mëpasshme, deri në vargun 113, kanë lidhje me çështjen e një njeriu që quhej Ibn Ubejrik. Ai akuzohej se kishte vjedhur, por mbrohej nga i Dërguari i Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, i cili ishte bindur nga ndërmjetësimi i familjes së të pandehurit se vjedhjen e kishte bërë një hebre. Shpallja hyjnore e shfaqësoi hebreun, kurse Ibn Ubejriku mohoi besimin dhe u arratis në Mekë, ku vazhdoi jetën e tij si keqbërës, derisa e gurëzuan. Përkthyesi, prof. Hasan I, Nahi, *Allahu e mëshiroftë!*

është prej Allahut” që për këtë të kenë ndonjë dobi të vogël (materiale). Mjerë ata për çfarë kanë shkruar me duart e tyre dhe mjerë ata për çfarë kanë fituar.” (El Bekare, 79)

I Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, i kishte dëgjuar disa njerëz që po ziheshin me fjalë, me ç’rast kishte thënë: *“Ata që kanë qenë para jush janë shkatërruar për këtë gjë: kanë përplasur Librin e Allahut me njëri-tjetrin! Ndërkaq, Libri i Allahut ka zbritur që ta vërtetojë njëri-tjetrin, andaj mos e përgënjeshtrohi njëren pjesë me tjetrën! Prandaj, çfarëdo që dini (prej Kuranit), thoni, dhe çfarëdo që nuk e dini, lërjani Atij që e di!”* (E shënon Ahmedi)⁹⁶



96 Ahmedi (6741), përcjellë nga Abdullah ibn Amri, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*



BESIMI NË TË DËRGUARIT

Besimi në të dërguarit nënkupton bindjen e palëkundshme se Allahu i Lartësuar prej njerëzve ka zgjedhur burra të cilëve u ka shpallur dhe i ka dërguar përgëzues dhe qortues. Ata përcjellin te njerëzit mesazhet e Tij (duke i ftuar që) vetëm Atij t'i kushtohet adhurimi dhe për t'iu shmangur çdo gjëje që adhurohet përveç Allahut. Kjo, si mëshirë për ta dhe për t'ua ngritur atyre argumentin (që të mos kenë kurrfarë arsytimi).

Allahu i Lartësuar thotë: **“Allahu zgjedh të dërguar nga engjëjt dhe njerëzit; me të vërtetë Allahu dëgjon dhe sheh gjithçka.”** (El Haxh, 75) Gjithashtu, Ai thotë: **“Ne edhe para teje kemi dërguar vetëm njerëz, të cilëve u kemi dhënë shpallje, andaj pyetni dijetarët e Librit, nëse nuk e dini (këtë).”** (En Nahl, 43) Po ashtu, thotë: **“(Këta janë) të dërguar që kanë sjellë lajme të mira e kanë paralajmëruar, në mënyrë që njerëzit të mos kenë ndonjë justifikim ndaj Allahut pas ardhjes së të dërguarve. Se, Allahu, është i Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijshëm.”** (En Nisa, 165) Dhe thotë: **“Çdo populli Ne i çuam një të dërguar (që u thoshte): “Adhuroni Allahun dhe shmangni idhujt!”** (En-Nahl, 36)

Te besimi në të dërguarit hyn:

1. Besimi se mesazhi i tyre është nga Allahu, pikërisht sipas dëshirës dhe urtësisë së Tij

Allahu i Lartësuar thotë: **“Kur atyre u vjen ndonjë mrekulli, thonë: “Ne nuk do të besojmë derisa të na jepet diçka, si ajo që u është dhënë të dërguarve të Allahut.” Allahu e di më mirë kujt ia jep mesazhin e Vet.”** (El Enam, 124) Gjithashtu, Ai thotë: **“Sikur t'i kishte zbritur ky Kuran ndonjë njeriu të madh prej njerit nga këto dy qytete⁹⁷!” Vallë, a mos janë ata që e ndajnë mëshirën e Zotit tënd? Jemi Ne ata që ua ndajmë njerëzve mjetet e jetesës në këtë botë, duke i ngritur në shkallë disa më lart mbi të tjerët, me qëllim që disa t'u shërbejnë të tjerëve. Mëshira e Zotit tënd është më e mirë nga ajo që grumbullojnë ata.”** (Ez Zuhruf, 31-32)

⁹⁷ Mekës dhe Taifit.

Profetësia (*en nbuveh*) dhe peygamberia (er risaleh) nuk mund të arrihen me përpjekje⁹⁸ e me sakrifica, siç mendojnë disa sufi të humbur, sikurse nuk mund të vërtetohet me bashkimin e forcave të shenjta, imagjinare dhe ndikuese, siç pretendojnë filozofët. Madje, profetësia dhe peygamberia janë përzgjedhje e kulluar; është mirësi nga Allahu ndaj robërve të Tij fisnikë, që Ai e dinte se e meritonin atë.

2. Besimi në të gjithë të dërguarit: atyre që ua dimë emrat (u besojmë) në mënyrë konkrete, kurse atyre që nuk ua dimë, u besojmë përgjithësisht

Atyre që ua dimë emrat, janë përmendur në fjalën e Allahut të Lartësuar, pas përmendjes së Ibrahimit, *alejhi selam*. **“Ne i dhuruam atij Is’hakun dhe Jakubin. Që të dy këta i udhëzuam në rrugë të drejtë, ashtu siç patëm udhëzuar më parë Nuhun. Ndër pasardhësit e tij Ne udhëzuam Davudin, Sulejmanin, Ejubin, Jusufin, Musain dhe Harunin. Kështu i shpërblejmë punëmirët. Ne udhëzuam edhe Zekerijain, Jahjain, Isain, Iljasin - të gjithë këta kanë qenë nga njerëzit e mirë. Po ashtu, udhëzuam edhe Ismailin, Eljesain, Junusin dhe Lutin - secilin prej tyre e ngritëm mbi të gjithë njerëzit.”** (El Enam, 84-86) Gjithashtu, i Lartësuari thotë: **“Edhe para teje (o Muhamed) Ne kemi nisur të dërguar, për disa prej të cilëve të kemi treguar ty, e për disa të tjerë nuk të kemi treguar.”** (Gafir, 78)

Besimi në të gjithë ata është obligim. Kjo, se thirrja e tyre ka qenë e njëjtë. Allahu i Lartësuar thotë: **“Ai ka urdhëruar për ju atë fe, të cilën ta zbuloi ty (o Muhamed) dhe që pati urdhëruar për Nuhun, Ibrahimin, Musain dhe Isain, duke thënë: “Qëndroni në fenë e drejtë dhe mos u përçani në të!”** (Esh Shura, 13) Mohimi i njërit prej tyre konsiderohet mohim i të gjithëve. Allahu i Lartësuar thotë: **“Populli i Nuhut i quante gënjeshtarë të dërguarit.”** (Es Shuara, 105) Edhe pse ai ka qenë i dërguari i parë.

Nuk lejohet të bëhet dallim mes të dërguarve të Allahut, e as t’u besojmë disave kundrejt të tjerëve. Ai që vepron kësisoj, ka mohuar. Allahu i Lartësuar thotë:

⁹⁸ Përpjekja nënkupton përmirësimin e gjendjeve shpirtërore, duke mos iu ndarë adhurimeve, si dhe duke iu larguar epsheve. Shënim i përkthyesit.

“Vërtet, ata që mohojnë Allahun dhe të dërguarit e Tij dhe dëshirojnë të ndajnë Allahun nga të dërguarit e Tij, duke thënë: “Ne disa i besojmë e disa nuk i besojmë” dhe duke dashur që kështu të zgjedhin një rrugë të ndërmjetme, pikërisht ata janë mohuesit e vërtetë. Ne kemi përgatitur dënim poshtërues për mohuesit. Ndërsa atyre që besojnë Allahun dhe të dërguarit e Tij dhe nuk bëjnë dallim mes asnjërit prej tyre, Ai do t’u japë shpërblimin (e premtuar). Se Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.” (En Nisa, 150-152)

3. Pranimi dhe konsiderimi për të mirëqena i gjërave që kanë lajmëruar nga Allahu

Allahu i Lartësuar thotë: “O njerëz! I Dërguari ju ka sjellë të vërtetën nga Zoti juaj, prandaj besoni, se për ju është më mirë! E, në qoftë se nuk besoni, ta dini se Allahut i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë.” (En Nisa, 170) Gjithashtu, Ai thotë: “Ata, që e shpallin të Vërtetën dhe që i besojnë asaj, pikërisht ata janë të përkushtuarit që i frikësohen Zotit.” (Ez Zumer, 33) Dhe thotë: “Beto hem në yllin kur perëndon, se shoku juaj (Muhamedi), nuk ka humbur e nuk ka devijuar! Ai nuk flet sipas qejfit të vet, por ajo (që thotë) është vetëm shpallje hyjnore, që i vjen atij. Atë ia ka mësuar atij një (engjell) shumë i fuqishëm (Xhibrili).” (En Nexhm, 1-5)

Çdo gjë që është vërtetuar nga lajmet e të dërguarve të mëparshëm, nga ato që Allahu i ka pohuar në Librin e Tij, apo që janë saktësuar në Sunetin e të Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, është obligim t’i besojmë për të vërteta. E, për ato që transmetohen në israiljate, zbatohet ajo që është shpjeguar hollësisht te Besimi në librat. Ndërkaq, për ato transmetime hadithesh që kanë zinxhir transmetuesish deri te Muhamedi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, zbatohen rregullat e (vëna prej) hadithologëve për t’i njohur të saktat prej të dobëtave. Hadithet që janë të sakta, është obligim t’i pranojmë dhe t’i besojmë.

4. T’u bindemi, t’i pasojmë dhe të gjykohe mi tek ata

Allahu i Lartësuar thotë: “Ne i kemi nisur të dërguarit me qëllim që njerëzit, me lejen e Allahut, t’u binden atyre.” (En Nisa, 64) Për çdo popull është obligim që t’i bindet dhe ta pasojë pejgamberin që u është dërguar

atyre. E, meqenëse Muhamedi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, është i fundit dhe vula e tyre, legjislacioni (*sheriati*) i tij i ka shfuqizuar legjislacionet e mëparshme. Rrjedhimisht, bindja dhe pasimi i tij është i domosdoshëm për këdo që ka dëgjuar për të.⁹⁹ Allahu i Lartësuar thotë: “... dhe atyre që ndjekin të Dërguarin Tonë, Profetin¹⁰⁰ që nuk di shkrim e lexim, të cilin ata do ta gjejnë të shënuar në shkrimet e tyre, në Teurat dhe Inxhil (Ungjill). Ai do t’i urdhërojë ata të bëjnë vepra të mira dhe do t’i ndalojë nga të këqijat; do t’ua lejojë të mirat e do t’ua ndalojë të këqijat, duke i liruar nga barrët e rënda dhe vështirësitë që kanë pasur. Prandaj, ata që do ta besojnë, do ta përkrahin dhe do ta nderojnë atë, duke ndjekur dritën që është zbritur me të, pikërisht ata janë të fituarit.” Thuaj (o Muhamed): “O njerëz, unë jam i Dërguari i Allahut për të gjithë ju, i Atij që i përket sundimi i qiejve dhe i Tokës. Nuk ka zot tjetër të vërtetë veç Atij; Ai jep jetë dhe vdekje, prandaj besoni në Allahun dhe në të Dërguarin e Tij, Profetin që nuk di shkrim e lexim e që beson në Allahun dhe Fjalët e Tij! Shkoni pas Tij, që të jeni në rrugën e drejtë!” (El Araf, 157-158) Po ashtu, thotë: “Thuaju (o Muhamed): “Nëse ju e doni Allahun, atëherë më ndiqni mua, që Allahu t’ju dojë dhe t’jua falë gjynahet! Allahu është Falës i Madh dhe Mëshirëplotë.” Thuaju: “Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit!” Në qoftë se kthejnë shpinën, (dijeni se) Allahu, me të vërtetë, nuk i do jobesimtarët.” (Alu Imran, 31-32) Si dhe thotë: “Jo, për Zotin tënd, ata nuk do të jenë besimtarë të vërtetë, derisa të të marrin ty për gjyqtar për kundërshtitë mes tyre; e pastaj, të mos ndiejnë kurrfarë dyshimi ndaj gjykimit tënd dhe të të binden ty plotësisht.” (En Nisa, 65)

5. T’i miqësojmë, t’i duam, t’i nderojmë dhe të dërgojmë selam (përschëndetje) mbi ta

Allahu i Lartësuar thotë: “Miqtë dhe mbrojtësit tuaj janë vetëm Allahu, i Dërguari i Tij dhe besimtarët që falin namazin dhe japin zekatin, duke qenë të përlur (në adhurim) ndaj Allahut. Ata që marrin për mik e

99 I Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “Betobem në Atë, në dorën e të Cilit është shpirti i Muhamedit, se çido njeri i këtij umeti që dëgjon për mua, qoftë ai çifut a i krishterë, e vdes duke mos e besuar atë në të cilën jam dërguar, do të jetë banor i Zjarrit.” (Muslimi) Shënim i përkthyesit.

100 Muhamedin, *sal-lallahu alejhi ue selem*.

mbrojtës Allahun, të Dërguarin e Tij dhe besimtarët, (ta dinë se) pa dyshim, pala e Allahut do të jetë fituese.” (El Maide, 55-56) Gjithashtu, Ai thotë: “Kur Isai vuri re mosbesimin e tyre, tha: “Cilët janë ndihmuesit e mi në rrugën e Allahut?”, nxënësit (e tij) iu përgjigjën: “Ne jemi ndihmuesit e (fesë së) Allahut. Ne e besojmë Allahun e ti (Isa) dëshmo se ne (i) jemi nënshtruar (Atij).” (Alu Imran, 52) Njashtu, thotë: “Thuaj: “Nëse etërit tuaj, bijtë tuaj, vëllezërit tuaj, gratë tuaja, farefisi juaj, pasuria juaj që e keni fituar, tregtia për të cilën keni frikë se nuk do të shkojë mirë dhe shtëpitë ku e ndieni veten rehat, janë më të dashura për ju sesa Allahu, i Dërguari i Tij dhe lufta në rrugën e Tij, atëherë pritni derisa Allahu të sjellë vendimin (dënimin) e Tij. Allahu nuk e udhëzon në rrugën e drejtë popullin e pabindur.” (Et Teube, 24) Po ashtu, thotë: “Paqja qoftë mbi të dërguarit!” (Es Safat, 181) Për të Dërguarin e Tij, Muhamedin, *sal-lallahü alejhi ue selem*, thotë: “Që t’i besoni Allahut dhe të Dërguarit të Tij, që ta ndihmoni e ta nderoni atë (Muhamedin) dhe që ta lavdëroni Atë (Allahun) me namaz në mëngjes dhe mbrëmje.” (El Fet’h, 9) Dhe thotë: “Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin dhe engjëjt e Tij luten për të. O besimtarë, lutuni për të dhe përshëndeteni me “selam”!” (El Ahzab, 56)

Ndërkaq, i Dërguari, *sal-lallahü alejhi ue selem*, ka thënë: “Askush prej jush nuk ka besuar (plotësisht), derisa unë të jem më i dashur tek ai sesa prindi e fëmija i tij dhe të gjithë njerëzit.” (E shënojnë Buhariu dhe Muslimi)¹⁰¹



101 Buhariu (15) dhe Muslimi (44), përcjellë nga Enesi, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*



BESIMI NË DITËN E FUNDIT

Besimi në Ditën e Fundit nënkupton bindjen e palëkundshme në atë se Allahu i Lartësuar i afatizon robërit e Tij për një ditë ku do t'i ringjallë nga varret e do t'i marrë në llogari për veprat e tyre dhe do t'i shpërblejë për to, ose me Xhenet, ose me Zjarr.

Allahu i Lartësuar thotë: **“Ai vetëm ua shtyn (dënimin) deri në Ditën, kur sytë e tyre do të zgurdullohen (nga tmerret që do të shohin).”** (Ibrahim, 42) Gjithashtu, Ai thotë: **“Mohuesit kujtojnë se nuk do të ringjallen kurrsesi. Thuaju: “Po, për Zotin tim, me siguri që do të ringjalleni e pastaj do të njoftoheni për atë që keni bërë!” Dhe kjo është e lehtë për Allahun.”** (Et Tegabun, 7) Dhe thotë: **“E, atë ditë kur të arrijë Ora (Dita e Kiametit), ata (besimtarët dhe jobesimtarët) do të ndahen. Ata që kanë besuar dhe kanë bërë vepra të mira, do të gëzojnë në kopshtin e Xhenetit; kurse ata që kanë mohuar dhe kanë përgënjeshtuar shenjat Tona dhe takimin në jetën tjetër, do të hidhen në Zjarr.”** (Er Rum, 14-16)

Besimi në Ditën e Fundit përfshin pikat në vijim:

1. Besimi në atë që do të ndodhë pas vdekjes

Ku bëjnë pjesë: të parët me sy e melekëve gjatë agonisë së vdekjes; sprova e varrit, që do të ndodhë nga dy melekët, ku robin do ta pyesin për Zotin, fenë dhe peygamberin e tij; si dhe ndëshkimi e kënaqja në varr, që do të bëhet në jetën e varrit (*berzabut*)¹⁰². Allahu i Lartësuar thotë: **“Eh, sikur të shihje sesi engjëjt ua marrin shpirtrat mohuesve! I godasin ata në fytyrë dhe shpinë (duke u thënë): “Shijoni dënimin e Zjarrit!”** (El Enfal, 50) Gjithashtu, Ai thotë: **“Me të vërtetë, atyre që thonë: “Zoti ynë është Allahu” e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t’u zbresin engjëjt (para vdekjes) e do t’u thonë: “Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni Xhenetit që ju është premtuar.”** (Fusilet, 30) Po ashtu, thotë: **“Dhe Allahu e ruajti atë prej të këqijave dhe kurtheve të tyre, ndërsa ithtarët e Faraonit i kaploi dënimi i vrazhdë. Ata do të çohen para Zjarrit në mëngjes dhe mbrëmje (në jetën e varrit) e, kur të arrijë Ora (e Kiametit), do të thuhet: “Hidhni ithtarët e Faraonit në dënimin më të rëndë!”** (Gafir, 45, 46)

102 Berzah është etapa nëpër të cilën kalon dhe e përjeton robi, nga momenti i vdekjes deri në ringjallje. Shënim i përkthyesit.

Enes ibn Maliku, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, përcjell, se i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “Kur robi të vendoset në varr dhe kur të largohen shokët e tij, ai e dëgjon kërcitjen e nallaneve të tyre, e po aty i venë dy melekë, me ç’rast e ulin dhe i thonë: “Ç’thoshe për atë njeri, Muhamedin, *sal-lallahu alejhi ue selem?*” Besimtari do të thotë: “Dëshmoj se ai është rob dhe i Dërguari i Allahut.” I thubet: “Shikoje vendin tënd në Zjarr. Allahu ta ka zëvendësuar atë me një vend në Xhenet.” Kështu, ai i sheh të dyja vendet. Ndërkaq, hipokritit dhe jobesimtarit i thubet: “Ç’thoshe për atë njeri?” Do të thotë: “Nuk di... Thosha atë që thoshin njerëzit.” Do t’i thubet: “As e dije, as lexoje.” Pastaj e godasin me një çekan të hekurt, aq fort, saqë e lëshon një britmë të cilën e dëgjon çdo gjë përreth tij, përveç njerëzve dhe xhinëve.” (E shënojnë Buhariu dhe Muslimi)¹⁰³

Nga Ibn Abasi, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, përcillet se ka thënë: “I Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, kishte kaluar pranë dy varreve, me ç’rast kishte thënë: “Këta të dytë po ndëshkohen, por nuk po ndëshkohen për diçka të madhe (në sytë e njerëzve). I pari nuk rubej gjatë urinimit, kurse i dyti bartte fjalë (për të bërë ngatërresa mes njerëzve).” Më pas mori një degë të njomë palme dhe e ndau në dysh. Në secilin varr e futi nga një. Sahabët i thanë: “O i Dërguari i Allahut! Përse veprove kështu?” Ai tha: “Mbase u lehtësobet (dënimi), derisa të thahen ato.” (E shënojnë Buhariu dhe Muslimi)¹⁰⁴

2. Besimi në Ditën e Kiametit dhe shenjat e saj

Allahu i Lartësuar thotë: “Allahu është Ai që e ka shpallur Librin me vërtetësi dhe drejtësi. E si do ta dije ti që ndoshta Dita e Kiametit është afër?! Kiametin kërkojnë ta shpejtojnë ata që nuk besojnë në të, kurse ata që besojnë, kanë frikë nga ai dhe e dinë se është plotësisht i vërtetë. Pa dyshim, ata që kundërshtojnë për Ditën e Kiametit, janë në një gabim shumë të madh!” (Esh Shura, 17-18) Gjithashtu, Ai thotë: “A mos vallë mohuesit presin që t’u vijë befasisht vetëm Ora (e Kiametit)? Ndërkohë, shenjat e saj kanë ardhur. Po për çfarë do t’u shërbejnë atyre këshillat, kur t’iu ketë ardhur Kiameti?!” (Muhamed, 18)

Ndër shenjat e mëdha të Kiametit janë ato që i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka treguar në fjalën e tij: “Me të vërtetë Kiameti nuk do të ndodhë, derisa t’i

103 Buhariu (1374) dhe Muslimi (2870).

104 Buhariu (218) dhe Muslimi (292).

shibni para tij (Kiametit) dhjetë shenja.” Pastaj renditi: *“Tymi, Dexhali, kafsha, lindja e Diellit nga perëndimi, zbritja e Isait, të birit të Merjemes, jexhuxhët dhe mexhuxhët dhe tri fundosjet (e tokës): një fundosje në lindje, një fundosje në perëndim dhe një fundosje në Gadishullin Arabik. Dhe shenja e fundit është një zjarr që do të dalë nga Jemeni, i cili i dëbon njerëzit drejt vendtubimit të tyre.”* (E shënon Muslimi)¹⁰⁵

Dita e Kiameti vjen krejtësisht papritmas dhe shpejt. Allahu i Lartësuar thotë: “Ata të pyesin ty (Muhamed) rreth Orës (së Kiametit). Thuaju: **“Atë e di vetëm Zoti im. Kohën kur do të ndodhë ajo, do ta tregojë vetëm Ai. Do të jetë e rëndë për qiejt dhe Tokën, do t’u vijë krejtësisht papritmas.”** Ata të pyesin, a thua se ti di diçka për të. Thuaj: **“Këtë e di vetëm Allahu, ndërsa shumica e njerëzve nuk e dinë (pse kjo gjë është e fshehtë).”** (El Araf, 187) Gjithashtu, Ai thotë: **“Allahut i përkasin fshehtësitë e qiejve dhe të Tokës, ndërsa çështja e Ditës së Kiametit është sa çel e mbyll sytë, ose edhe më shpejt.”** (En Nahl, 77) Dhe thotë: **“Kur do t’i fryhet Surit, do të vdesin të gjithë ata që gjenden në qiej dhe në Tokë, përveç atyre që do Allahu...”** (Ez Zumer, 68)

3. Besimi në Ringjalljen

Besimi në Ringjalljen nënkupton se Allahu do t’i nxjerrë robërit e Tij nga varret të gjallë, të zbathur, të zhveshur, të pasyretuar e pa asgjë me vete. Kjo do të jetë pasi t’i fryhet Surit për të dytën herë. Allahu i Lartësuar thotë: **“... pastaj do të fryhet për të dytën herë në Sur dhe ata përnjëherë do të ngjallen e do të presin.”** (Ez Zumer, 68) Po ashtu, thotë: **“Dhe, kur të fryhet në Sur, ata do të dalin nga varret dhe do të nxitojnë drejt Zotit të tyre.”** (Jasin, 51) Ndërkaq, i Dërguari, sal-lallahu alejhi ue selem, ka thënë: *“Në Ditën e Kiametit njerëzit do të ringjallen të zbathur, të zhveshur dhe të pasyretuar.”* (E shënojnë Buhariu dhe Muslimi)¹⁰⁶

4. Besimi në lidhje me ndodhitë e mëdha të Kiametit

Allahu i Lartësuar thotë: **“Ditën, kur të gjithë njerëzit do të dalin para Zotit të botëve.”** (El Mutafifin, 6) Ajo është (dita) kur të gjithë njerëzit do

105 Muslimi (2901), përcjellë nga Hudhejfe, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

106 Buhariu (3349) dhe Muslimi (2860), përcjellë nga Ibn Abasi, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*; si dhe Buhariu (6527) dhe Muslimi (2809), përcjellë nga Aishja, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

të dalin para Zotit të botëve dhe do të qëndrojnë shumë gjatë në sheshin e tubimit në Ditën e Kiametit, ku u arrin zëri i thirrësit e i përfshin shikimi, e Dielli do t'u afrohet dhe djersa do t'i mbulojë. Do të shkojnë te Haudi¹⁰⁷, regjistrat (e veprave) do të shpërndahen, peshoret do të vendosen e Sirati (ura) do të vihet mbi Xhehenem¹⁰⁸ në situata madhështore dhe gjendje tmerruese.

5. Besimi në dhënien e llogarisë:

Allahu i Lartësuar thotë: **“Pa dyshim, ata do të kthehen të gjithë te Ne dhe patjetër që do të japin llogari para Nesh.”** (El Gashije, 25-26) Gjithashtu, Ai thotë: **“Ai, të cilit do t'i jepet libri i tij në dorën e djathtë, do ta ketë të lehtë llogarinë.”** (El Inshikak, 7-8) Po ashtu, thotë: **“Kush ka bërë ndonjë të mirë, qoftë sa një thërmijë, do ta shohë atë, e kush ka bërë ndonjë të keqe, qoftë sa një thërmijë do ta shohë atë.”** (Ez Zelzele, 7-8) Dhe thotë: **“Dhe në Ditën e Kiametit, Ne do të vendosim peshore të sakta e askush nuk do të pësojë asnjë padrejtësi. Ne do të sjellim (për gjykim) çdo vepër, qoftë kjo edhe sa pesha e një kokrre sinapi. Ne jemi të mjaftueshëm për llogaritje.”** (El Enbija, 47)

Dhënia e llogarisë nga ana e krijësave ndahet në dy lloje:

E para: Dhënia e llogarisë nga ana e besimtarëve

Dhënia e llogarisë nga ana e besimtarëve është ose prezantim (i veprave), ose marrje në pyetje. Dhënia e llogarisë me prezantimin (e veprave) është për ata të

107 Në sheshin e Ditës së Gjykimit ndodhet Haudi (Burimi) i Muhamedit, *sal-lallahu alejhi ne selem*, uji i të cilit është më i bardhë se qumështi dhe më i ëmbël se mjalti. Enët që ndodhen aty janë më shumë se yjet në qiell. Gjatësia e tij është sa një muaj udhëtim dhe gjerësia po aq. Atë që pi ujë aty një herë të vetme, nuk e merr më kurrë etja. Ibn Tejmije, *Allabu e mëshiroftël*, El Akide el vasitije. Shënim i përkthyesit.

108 Ura e Siratit vendoset mbi Xhehenem dhe skaji tjetër i saj përfundon në Xhenet. Njerëzit e kalojnë në varësi të veprave që kanë bërë. Disa prej tyre e kalojnë sa hap e mbyll sytë, disa e kalojnë si vetëtim, disa si era, disa sikur janë duke vrapuar me kalë, disa sikur janë duke ecur mbi deve, disa duke vrapuar, disa duke ecur, disa duke u zvarritur e disa rrëmbehen dhe hidhen në Xhehenem, sepse ura e Siratit ka kanxa që i rrëmbejnë njerëzit sipas veprave të tyre. Ai që e kalon urën e Siratit, hyn në Xhenet. Pasi ta kalojnë urën e Siratit, do të qëndrojnë në Kantara (një vend para se të hyjnë në Xhenet), ndërmyet Xhenetit dhe Zjarrit. Atje i marrin hakun njëri-tjetrit derisa të pastrohen krejtësisht dhe pastaj u jepet leje për të hyrë në Xhenet. Ibn Tejmije, *Allabu e mëshiroftël*, El Akide el vasitije. Shënim i përkthyesit.

cilëve u ka prirë mirësia e Allahut, që janë të lumturit (banorët e Xhenetit), gjë të cilën e tregon hadithi i Ibn Omerit, *Allahu qoftë i kënaqur me të!, se i Dërguari, sal-lallahu alejhi ue selem, ka thënë: “Vërtet Allahu do ta afrojë besimtarin, mbi të cilin do ta vendosë Perden e Tij dhe do ta mbulojë.”* Pastaj do ta pyesë: “A e di këtë dhe atë mëkat që e ke kryer?” Ai do të thotë: “Po, o Zoti im!” E, pasi (Allahu) e bën t’i pranojë mëkatet e veta dhe në vetvete mendon se u shkatërrua, (Allahu) i thotë: “Unë t’i kam mbuluar mëkatet në dynja dhe po Unë do të t’i fal sot.” Kështu, atij do t’i jepet libri i veprave të tij të mira.” (E shënojnë Buhariu dhe Muslimi)¹⁰⁹

Ndërkaq, dhënia e llogarisë duke u marrë në pyetje është për monoteistët që kanë bërë mëkate të mëdha, për ata që Allahu dëshiron t’i dënojë në Zjarr për shkak të mëkateve të tyre, porse përfundimi i tyre është në Xhenet. Një gjë të tillë e tregon hadithi i Aishes, *Allahu qoftë i kënaqur me të!, se i Dërguari, sal-lallahu alejhi ue selem, ka thënë: “Kushdo që merret në llogari Ditën e Kiametit, do të shkatërrohet.”* I thashë: “O i Dërguari i Allahut, a nuk ka thënë Allahu i Lartësuar: **“Ai, të cilit do t’i jepet libri i tij në dorën e djathtë, do ta ketë të lehtë llogarinë?”** I Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem, iu përgjigj: “Kjo nënkupton prezantimin (e veprave), ndërkaq ai që merret në llogari Ditën e Kiametit, do të ndëshkohet medoemos.”* (E shënojnë Buhariu dhe Muslimi)¹¹⁰

E dyta: Dhënia e llogarisë nga ana e jobsimtarëve

Jobsimtarëve nuk do t’u llogariten veprat duke iu peshuar të mirat dhe të këqijat, sepse ata nuk kanë vepra të mira. Allahu i Lartësuar thotë: **“Dhe Ne do t’u qasemi veprave që kanë bërë ata dhe do t’i shndërrojmë në pluhur e hi.”** (El Furkan, 23) Madje, ata ndalen për t’u llogaritur për veprat e tyre dhe (Allahu) i bën që t’i pranojnë ato. Në hadithin e lartpërmendur të Ibn Omerit, *Allahu qoftë i kënaqur me të!, qëndron: “Ndërkaq, jobsimtarët dhe hipokritët do të thirren në mesin e krijesave: “Këta janë ata që kanë gënjer kundër Zotit të tyre. Mallkimi i Allahu qoftë mbi të padrejtët!” (Hud, 18) (E shënojnë Buhariu dhe Muslimi)¹¹¹*

109 Buhariu (2441) dhe Muslimi (2768).

110 Buhariu (6537) dhe Muslimi (2876).

111 Buhariu (2441) dhe Muslimi (2768).

6. Besimi në shpërblimin (me Xhenet ose me Zjarr)

Kjo nënkupton besimin se Xheneti dhe Zjarri janë të vërtetë. Xheneti është vendbanim që Allahu e ka përgatitur si shpërblim për robërit e Tij të devotshëm. Aty ka kategori kënaqësish konkrete e kuptimore, të cilat asnjë sy nuk i ka parë, asnjë vesh nuk i ka dëgjuar dhe asnjë njeri nuk e ka marrë me mend. Ndërkaq, Zjarri është vendbanim që Allahu e ka përgatitur si “shpërblim” për jobesimtarët. Aty ka kategori ndëshkimesh konkrete e kuptimore, që asnjë sy nuk i ka parë, asnjë vesh nuk i ka dëgjuar dhe asnjë njeri nuk i ka marrë me mend.

Allahu i Lartësuar thotë: **“Pastaj, Ne ua dhamë Librin robërve Tanë të zgjedhur (nga ndjekësit e Muhamedit). Disa prej tyre i bëjnë dëm vetes (duke bërë vepra të ndaluara), disa janë në rrugë të mesme (duke kryer detyrimet dhe duke shmangur të ndaluarat), ndërsa disa, me lejen e Allahut, shkojnë përpara me të mira (përtej detyrimeve); kjo është dhuntia e madhe. Ata do të hyjnë në kopshtet e Adnit të stolisur me byzlykë ari e margaritarë dhe veshja e tyre do të jetë prej mëndafshi. Pastaj do të thonë: “Lavdi Allahut, i Cili e ka larguar hidhërimin nga ne. Vërtet, Zoti ynë është Falës dhe Falënderues. Është Ai që me mirësinë e Tij na ka pranuar në shtëpinë e banimit të përhershëm, në të cilën nuk do të lodhemi e nuk do të rraskapitemi.” Për jobesimtarët është përgatitur zjarri i Xhehenemit, ku ata nuk do të vdesin dhe as që do t’u lehtësohet dënimi. Ja, kështu Ne do t’i dënojmë mosmirënjohësit. Atje, ata do të thërrasin: “O Zoti ynë, nxirrna se do të bëjmë vepra të mira e jo nga ato që kemi bërë.” (Atyre do t’u thuhet): “Vallë, a nuk jua zgjatëm jetën aq sa të mund të mendohej ai që donte të kujtonte (Allahun)?! Madje juve ju erdhi edhe paralajmëruesi? Andaj, shijoni (dënimin)! Për keqbërësit nuk ka kurrfarë ndihmësi!” (Fatir, 32-37)**





BESIMI NË KADERIN (PARACAKTIMIN)

Besimi në paracaktimin (*kaderin*) nënkupton bindjen e palëkundshme se Allahu i Lartësuar i ka vendosur paracaktimet e krijesave me Dijen e Tij të pafillim (el ezeli), i ka shkruar ato në Pllakën e Ruajtur (*Leuhul Mahfudh*), i ka përmbushur me vullnetin e Tij dhe i ka sjellë në ekzistencë me fuqinë e Vet. Allahu i Lartësuar thotë: **“Vërtet, Ne çdo gjë e kemi krijuar me masë të paracaktuar.”** (El Kamer, 49) Dhe thotë: **“I Cili ka krijuar çdo gjë dhe e ka rregulluar si duhet.”** (El Furkan, 2)

Te besimi në kader hyjnë çështjet në vijim:

1. Besimi në dijen e Allahut të Lartësuar

Besimi në dijen e pafillim dhe të pafund të Allahut se përfshin gjithçka, në mënyrë të përgjithshme dhe të detajuar, (dije kjo) që ka lidhje me veprat e Tij, si: paracaktimi i jetëgjatësisë e furnizimit, ose që ka të bëjë me veprat e robërve, si: adhurimet dhe mëkatet. Allahu i Lartësuar thotë: **“Ai është i Dijshëm për çdo gjë.”** (El Bekare, 29) Dhe thotë: **“Ky (rregull) është caktim i të Plotfuqishmit dhe të Gjithëditurit.”** (El Enam, 96) Kështu, Ai di kush do t’iu nënshtrohet e kush do ta kundërshtojë, sikurse që e di për gjithsecilin se a do të jetë jetëgjatë apo jetëshkurtër.

2. Besimi se Allahu i ka shkruar paracaktimet në Pllakën e Ruajtur

Allahu i Lartësuar thotë: **“S’ka fatkeqësi që godet tokën dhe ju e që të mos jetë e shënuar në Libër (Leuhul Mahfudh) më parë se ta krijojmë atë. Kjo për Allahun është vërtet e lehtë!”** (El Hadid, 22) Dhe thotë: **“Ai i di të gjitha të fshehtat. Atij nuk mund t’i fshihet asnjë grimë, as në qiej, as në Tokë, e nuk ka asgjë më të vogël apo më të madhe se ajo, që të mos jetë shënuar në Librin e qartë.”** (Sebe, 3)

Nga Abdullah ibn Amër ibn el Asi, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, përcillet se ka thënë: “E kam dëgjuar të Dërguarin, *sal-lallahu alejhi ue selem*, duke thënë:

“Allahu i ka shkruar paracaktimet e krijesave pesëdhjetë mijë vjet para se të krijonte qiejt dhe Tokën.” Pastaj ka thënë: *“Dhe Froni (Arshi) i Tij ka qenë mbi ujë.”* (E shënon Muslimi)¹¹²

Nga Ubade ibn es Samiti, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, përcillet se ka thënë: “E kam dëgjuar të Dërguarin, *sal-lallahu alejhi ue selem*, duke thënë: *“Me të vërtetë, gjëja e parë të cilën e ka krijuar Allahu i Lartësuar ka qenë lapsi. Pastaj i ka thënë atij: “Shkruaj!” Ai kishte pyetur: “Ç’të shkruaj, o Zot?!” Ai i kishte thënë: “Shkruaj paracaktimet e çdo gjëje të cilat do të ndodhin derisa të bëhet Kiameti.”* (E shënojnë Ebu Davudi dhe Tirmidhiu)¹¹³

Allahu e ka përmendur bashkërisht dijen dhe shkrimin në Fjalën e Tij: **“A nuk e di ti, se Allahu di çdo gjë që është në qiej e në Tokë? Të gjitha këto janë (shënuar) në Libër.”**¹¹⁴ **Me të vërtetë, kjo është e lehtë për Allahun.”** (El Haxh, 70)

3. Besimi në dëshirën realizuese të Allahut

Kjo nënkupton të besosh se atë që do Allahu, ndodh; kurse atë që Ai s’do, nuk ndodh kurrësi. Askush nuk mund ta ndalojë atë që Ai e jep dhe s’ka kush që mund të japë atë që Ai e ndalon. S’ka kush që pengon Atë që Ai përcakton. Në pushtetin e Tij nuk mund të ndodhë diçka që Ai nuk dëshiron. Ai e udhëzon kë të dojë me mirësinë e Tij, sikurse e lë në humbje kë të dojë me drejtësinë e Tij, e askush nuk mund ta thyjë gjykimin e Tij.

Allahu i Lartësuar thotë: **“Sikur të donte Allahu, njerëzit që erdhën pas të dërguarve nuk do të vriteshin me njëri-tjetrin pas ardhjes së provave të qarta, por ata u përçanë: disa besuan, kurse të tjerët mohuan. Sikur të donte Allahu, ata nuk do të vriteshin me njëri-tjetrin, por Allahu bën si të dojë Vetë.”** (El Bekare, 253) Dhe thotë: **“... për secilin nga ju që dëshiron të ndjekë rrugën e drejtë. Por ju nuk mund të dëshironi, përveçse me vullnetin e Allahut, Zotit të botëve.”** (Et Tekvir, 28-29)

112 Muslimi (2603).

113 Ebu Davudi (4700) dhe Tirmidhiu (2155).

114 Në Librin e Ruajtur (*Leuhul Mahfudh*), ku është shënuar gjithçka, nga fillimi i krijimit deri në Ditën e Kiametit.

4. Besimi se Allahu i ka krijuar të gjitha krijesat dhe i ka sjellë në ekzistencë

Pra, Allahu është Krijuesi, e të tjerët përveç Tij janë të krijuar. Të gjitha gjërat, përfshirë qeniet, cilësitë dhe lëvizjet e tyre, janë të krijuara e të lindura e Allahu është Krijuesi dhe Ekzistencësjellësi i tyre. Allahu i Lartësuar thotë: **“Allahu është Krijuesi i çdo gjëje dhe Ai është Mbikëqyrës i çdo gjëje.”** (Ez Zumer, 62) Dhe thotë: **“Ndërkohë Allahu është Ai që ju ka krijuar ju dhe gjithçka që bëni!”** (Es Safat, 96) Veprat e robërve janë të krijuara nga Allahu, ndërkohë ata i vepronë vetë ato. Allahu i Lartësuar thotë: **“Në dobi të tij është e mira që e bën, kurse në dëm të tij është e keqja që punon.”** (El Bekare, 286)

5. Besimi se nuk ka asnjë lidhje ndërmjet dëshirës dhe dashurisë

Allahu mund të dëshirojë diçka që nuk e do, sikurse mund të dojë diçka që nuk e dëshiron. Kjo, për shkak të ndonjë urtësie të përsosur dhe synimi të përkryer. Allahu i Lartësuar thotë: **“Sikur Ne të donim, do t’ia jepnim secilit udhëzimin e tij, por do të përmbushet Fjala Ime: “Me të vërtetë, do ta mbush Xhehenemin me xhinë dhe njerëz bashkërisht!”** (Es Sexhde, 13) Dhe thotë: **“Nëse ju e mohoni Atë, dini se Allahu është vërtet i pavarur prej jush. Megjithatë, Ai nuk është i kënaqur me mosbesimin e robërve të Tij...”** (Ez Zumer, 7)

6. Besimi se nuk ka kontradiktë mes sheriatit dhe kaderit

Allahu i Lartësuar thotë: **“Vërtet veprat tuaja janë të ndryshme. Sa për atë që jep (për hir të Allahut), ka frikë (nga Ai) dhe dëshmon për vërtetësinë e më së bukurës (besimit), Ne do t’ia lehtësojmë atij rrugën drejt shpëtimit. Kurse atij që është koprrac, ndihet i vetëmjaftueshëm, dhe e quan gënjeshtër më të bukurën (besimin), Ne do t’ia lehtësojmë rrugën drejt dënimit.”** (El Lejl, 4-10) Kjo, se sheriatit është libër i hapur, e kaderi është i padukshëm dhe i fshehtë. Allahu i ka vendosur paracaktimet e robërve dhe këtë gjë ua ka fshehur atyre. I ka urdhëruar dhe i ka ndaluar, i ka përgatitur dhe u ka ndihmuar që të kenë mundësi ta zbatojnë urdhrin e Tij dhe t’i largohen ndalesës së Tij. Gjithashtu, i ka justifikuar nëse u paraqitet ndonjë pengesë që ua pamundëson realizimin e obligimeve. Andaj, askush nuk mund

të argumentohet për veprimin e mëkatit dhe braktisjen e adhurimit (duke u mbështetur) në kaderin paraparak. Allahu i Lartësuar thotë: **“Idhujtarët do të thonë: “Sikur të donte Allahu, nuk do të adhuronim tjetër veç Tij as ne, as baballarët tanë dhe ne nuk do të kishim bërë të ndaluar asgjë.” Kështu mohonin edhe ata para tyre, derisa shijuan dënimin Tonë. Thuaju: “A keni ndonjë provë të na paraqitni? Ju mbështeteni vetëm në hamendje dhe jeni vetëm gënjeshtarë.” Thuaju: “Allahu ka argumentin më bindës dhe, po të donte Ai, të gjithëve do t’ju përudhte në rrugë të drejtë!”** (El Enam, 148-149)

Së pari: ka përgënjeshtuar pretendimin e tyre.

Së dyti: i ka bërë që ta përjetojnë dënimin e Tij. Nëse ata do të kishin kaderin si argument (për veprimin e idhujtarisë), Allahu nuk do t’i bënte që ta përjetojnë dënimin e Tij.

Së treti: ka zbuluar ligësinë e pretendimit të tyre. Ata nuk e kanë parë librin (ku i kanë të shkruara veprat), e që këtë ta ndërtonin duke u bazuar në dije, si dhe (argumentimi me kaderin për veprimin e mëkateve) të jetë argument në favor të tyre. Argumentimi i tyre është i bazuar thjesht në hamendje dhe supozim. Prandaj, argumenti më i përsosur është për Allahun.

Në kapitullin e kaderit kanë devijuar dy grupe:

1) Kaderitë mohues

Të cilët e teprojnë në pohimin e veprave të robërve dhe e mohojnë kaderin e mëparshëm. Këta ndahen në dy nënkategori:

a) Tepruesit

Ky është grupi i parë, që është shfaqur në periudhën e fundit të sahabëve, të cilët pretendonin se Allahu i di gjërat vetëm pasi të ndodhin. Sahabët, si: Ibn Abasi e Ibn Omeri, *Allahu qoftë i kënaqur me ta!*, i kanë kundërshtuar ata. Të tillët e mohojnë dijen, shkrimin, dëshirën dhe krijimin (e Allahut).

b) Mesatarët

Këta janë mutezilitë, të cilët e pohojnë dijen dhe shkrimin, por mohojnë dëshirën dhe krijimin. Të tillët pretendojnë se robi është krijuesi i veprës së tij.

2) *Xhebritë*

Të cilët e teprojnë në pohimin e veprave të Zotit, saqë robin e zhveshin nga dëshira dhe fuqia. Ata veprat e robit i konsiderojnë të imponuara, bie fjala, lëvizja që bën personi gjatë rrëqethjes, si dhe mohojnë që në veprat e Allahut ka urtësi dhe shkak. Këta ndahen në dy nënkategori:

a) *Tepruesit*

Këta janë zindikët sufi, që pretendojnë se e shohin realitetin universal, rrjedhimisht ia lejojnë vetes veprimin e çdo gjëje, me pretendimin se këto veprime janë në përputhje me kaderin. Njëri prej tyre ka thënë:

Për atë që do të zgjedhësh prej meje kam një shqetësim,

Se të gjitha veprat e mia janë adhurim, pa përjashtim.

b) *Mesatarët*

Këta janë esharitë, që pohojnë teorinë e përfitimit (*el kesb*)¹¹⁵ dhe i pohojnë rob-it forcë, por që nuk është ndikuese!

Të dy grupeve u kundërpërgjigjet sheriatu dhe realiteti

Mobuesve të kaderit

Përfshirë katër kategoritë e lartpërmendura: dijen, shkrimin, dëshirën dhe krijimin. Atyre u kundërpërgjigjen tekstet e qarta fetare që i pohojnë këto kategori të kaderit. Gjithashtu, realiteti tregon se njeriu synon të bëjë diçka, mirëpo mes tij dhe veprës ndërhyjnë diçka.

Xhebrive teprues në pohimin e kaderit

Atyre u kundërpërgjigjen tekstet fetare që argumentojnë pohimin e vullnetit, veprës dhe dëshirës së rob-it. Gjithashtu, realiteti tregon se çdo njeri bën dallim ndërmjet veprave që i kryen me vetëdëshirë dhe atyre të imponuara. Po ashtu, tekstet fetare, që pohojnë se në veprat e Allahut të Lartmadhërishëm ka urtësi dhe shkak, janë të bollshme.



KURANI

Kurani është Fjalë e Allahut. Allahu i Lartësuar thotë: **“Nëse ndonjë idhujtar**



të kërkon mbrojtje ty (Muhamed), mbroje, në mënyrë që të dëgjojë fjalën e Allahut, e pastaj përcille në vendin e tij të sigurt. Kështu duhet, sepse ata janë njerëz që nuk dinë.” (Et Teube, 6) Ndërkaq, i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, teksta u prezantohej fiseve gjatë sezonit (të haxhillëkut), ka thënë: “A ka njeri që më bart te populli i tij, ngase kurejshët më ndaluan që ta kumtoj fjalën e Zotit tim?” (E shënojnë të pestët)¹¹⁶

Kurani, përfshirë shkronjat dhe kuptimet e tij, është vërtet fjalë e Allahut. Ai nuk i shëmbëllen fjalës së krijesave. Ai është i zbritur, e jo i krijuar. Allahu fillimisht ka folur me të, pastaj ia ka shpallur Shpirtit Besnik (*Ruhul Emin*), Xhibrilit, e ky i fundit e ka zbritur atë në zemrën e Muhamedit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, pjesë-pjesë, i cili ua ka lexuar (mësuar) njerëzve. Allahu i Lartësuar thotë: **“Ky është një Kuran, që Ne e kemi ndarë pjesë-pjesë, që ti t’ua mësosh njerëzve pak nga pak, duke e shpallur atë kohë pas kohe.”** (El Isra, 106)

Kur njerëzit e lexojnë, e shkruajnë nëpër mus’hafe apo e memorojnë në kraharorët e tyre, kjo nuk e përjashton nga të qenët fjalë e vërtetë e Allahut. Në të vërtetë fjala i adresohet atij që e thotë fillimisht, e jo atij që e thotë si kumtues e përcjellës. Pra, leximi nuk është sikurse e lexuara, shkrimi nuk është sikurse e shkruara, memorimi nuk është sikurse e memoruara, e kështu me radhë të gjitha veprimet. Domethënë, veprimi është veprim i lexuesit, shkruesit apo memoruesit, e fjala është fjalë e Krijuesit (*arb. El Bari - Allahut*). Allahu i Lartësuar thotë: **“Ne e dimë mirë që ata¹¹⁷ thonë: “Atë¹¹⁸ e mëson një njeri!” Por, ai për të cilin flasin, flet në gjuhën e të huajve, kurse ky (Kurani) është në gjuhën e qartë arabe¹¹⁹.”** (En Nahl, 102-103) Allahu e ka shpallur jobesimtar atë që e ka adresuar (duke thënë se Kurani) është fjalë e njeriut dhe e ka kërcënuar me Zjarrin përvëlues. Ai thotë: **“Do ta hedh në Sekar (Zjarrin**

116 Ahmedi (15192), Ebu Davudi (4734), Tirmidhiu (2925), Nesaiu në *Es Sunen el kubra* (7680) dhe Ibn Maxhe (201), përcjellë nga Xhabiri, *Allahu gostë i kënaqur me të!*

117 Paganët e Mekës.

118 Muhamedin, *sal-lallahu alejhi ue selem*.

119 Sipas komentuesve të Kuranit, ky varg bën fjalë për një skllav të krishterë që jetonte dhe punonte si kovaç në Mekë e të cilit profeti Muhamed, *sal-lallahu alejhi ue selem*, i fliste herë pas here. Për këtë arsye, paganët e Mekës thoshin se ky skllav ishte që ia mësonte Muhamedit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, Kurantin. Mirëpo ai ishte i huaj dhe nuk dinte mirë arabisht, prandaj nuk kishte mundësi që t’i mësonte Profetit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, Kurantin, që është në gjuhë të kulluar arabe. Përkthyesi, prof. Hasan I. Nahi, Allahu e mëshiroftë!

përvëlues).” (El Mudethir, 26)

Në këtë kapitull kanë devijuar dy grupe:

1) *Xhebmitë dhe mutezilitë*, të cilët i mohojnë cilësitë e Allahut, e mohojnë cilësinë e të folurit dhe pretendojnë se adresimi i të folurit tek Allahu është në aspektin e adresimit të krijesës të Krijuesi, si: robi i Allahut, shtëpia e Allahut, deveja e Allahut, e jo në aspektin e adresimit të cilësisë tek i cilësuar.

Atyre u kundërpërgjigjemi se, ajo që i adresohet Allahut, ose është send që qëndron vetvetiu, e që është adresim i krijesës të Krijuesi i saj; ose është cilësi që nuk parafytyrohet të qëndrojë vetvetiu, si: jeta, dëgjimi, shikimi, dija, të folurit, e që është adresim i cilësisë tek ai që cilësohet me të, duke i bashkëngjitur kësaj edhe kundërshtimin, që pretendimi i tyre ua bën Kuranit, Sunetit dhe ixhmait.

2) *Pobuesit e cilësive nga radhët e kulabive*, esharive dhe maturidive, të cilët pohojnë se fjala e Allahut është kuptimi i hershëm që qëndron në qenien e Tij, kurse zërat dhe shkronjat janë të krijuara për t’u shprehur me to, ose për të treguar atë kuptim të hershëm, i cili nuk ripërtërihet dhe nuk lidhet me dëshirën e Tij. Ata të folurit e kufizojnë në kuptime, e jo në shkronja e zëra. Ndërkaq, atë që dy prindërit (Ademi dhe Havaja) e kanë dëgjuar në Xhenet dhe atë që Musai e ka dëgjuar te pema, e konsiderojnë të krijuar, e jo fjalë reale të Allahut!

Atyre u kundërpërgjigjemi duke thënë se, fjala përdoret vetëm duke i bashkuar të dyja së bashku: kuptimet dhe zërat. Të folurit në vete realisht nuk konsiderohet e folur. Shtoji kësaj edhe kundërshtimin që ata i bënë Kuranit, Sunetit dhe ixhmait.



TË PARËT E ALLAHUT TË LARTËSUAR



Prej besimit në Allahun dhe në Ditën e Fundit është edhe besimi se besimtarët me sytë e tyre do ta shohin Zotin e vet në Ditën e Gjykimit, pa e përfshirë Atë të tërin. Kjo do të ndodhë në dy vende:

I pari: Në sheshin e tubimit në Ditën e Kiametit, vendin ku do të jepet llogaria.

I dyti: Pasi të hyjnë në Xhenet.

Allahu i Lartësuar thotë: **“Atë ditë, disa fytyra do të shkëlqejnë dhe Zotin e tyre do të shohin.”** (El Kijame, 22-23) Gjithashtu, Ai thotë: **“Duke shikuar nga divanet.”** (El Mutaifin, 23) Dhe thotë: **“Ata që bëjnë vepra të mira, do të kenë shpërblim të mirë, madje edhe më tepër.”** (Junus, 26) I Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, (vargun kuranor) **“... madje edhe më tepër”**, e ka komentuar me shikimin në Fytyrën fisnike të Allahut.¹²⁰ Po ashtu, i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, kur e kishte parë hënën e plotë, kishte thënë: *“Me të vërtetë, do ta shihni Zotin tuaj ashtu siç po e shihni Hënën: nuk do ta shtyni njëri-tjetrin për ta parë Atë.”* (E shënojnë Buhariu dhe Muslimi)¹²¹

Në këtë kapitull kanë devijuar dy grupe:

1) Mohuesit e cilësive: xehmitë, mutezilitë, si dhe rafiditë e ibaditë¹²² që pajtohen me ta

Të tillët e kanë mohuar të parët e Allahut, duke u argumentuar me fjalën e Allahut thënë Musait (kur i kishte kërkuar për ta parë): **“Ti nuk mund të më shohësh!”** (El Araf, 143) Dhe me fjalën e Tij: **“Shikimet njerëzore nuk mund ta arrijnë Atë...”** (El Enam, 103)

Atyre u kundërpërgjigjemi në këtë mënyrë: Qëllimi i fjalës së Allahut (thënë Musait): **“Ti nuk mund të më shohësh!”**, ka për qëllim (të parët e Tij) në këtë botë, ashtu siç kërkoi ai. Pjesëza nuk (len) s’e nënkupton mohimin e përhershëm. Po ashtu, mohimi i arritjes së Tij me shikimet e njerëzve ka për qëllim mohimin e përfshirjes së Tij, jo mohimin e të parit të Allahut. Ndodh që diçka të shihet e të mos perceptohet e tëra, sikurse shikimi i Diellit, Hënës, malit etj. Janë të shumta tekstet kuranore e profetike që e konfirmojnë të parët e Allahut.

¹²⁰ Muslimi (181), përcjellë nga Suhejbi, *Allahu qoftë i kënaqur me të!* Shih: Tefsirin e Taberit (12/155).

¹²¹ Buhariu (553) dhe Muslimi (633), përcjellë nga Xheriri, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

¹²² Ibaditë janë një prej grupeve të havarixhëve. Shënim i përkthyesit.

2) Sufitë dhe bidatçinjtë që bazohen në legjenda

Të cilët e kanë tepruar në pohimin e të parit të Allahut, saqë parashohin që për evlijatë e tyre një gjë e tillë mund të ndodhë edhe në këtë botë, gjë për të cilën transmetojnë hadithe të trilluara. Ndërkaq, i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “*Dijeni se nuk do ta shihni Zotin tuaj të Lartmadhërisëm derisa të vdisni!*”¹²³

REALITETI I BESIMIT

1. Besimi (imani) është fjalë e vepër, fjalë e zemrës dhe e gjuhës, si dhe vepër e zemrës, gjuhës dhe gjymtyrëve

- **Fjala e zemrës:** ku hyjnë: bindja, vërtetësia dhe pranimi i saj.
- **Fjala e gjuhës:** ku hyjnë: të shprehurit e fjalës së Islamit dhe të bërët publike dy dëshmitë.
- **Vepra e zemrës:** ku bëjnë pjesë ato vepra që bëhen si rrjedhojë e qëllimeve dhe synimeve, si: dashuria, frika, shpresa dhe mbështetja në Allahun.
- **Vepra e gjuhës:** ku bëjnë pjesë ato që bëhen vazhdimisht me të, si: dhikri (përmendja e Allahut), duaja (lutja) dhe leximi i Kuranit.
- **Vepra e gjymtyrëve:** ku bëjnë pjesë ato adhurime trupore përmes të të cilave lëvizin pjesët e trupit.

Allahu i Lartësuar thotë: **“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata, zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, fërgëllojnë dhe, kur u lexohen shpalljet e Tij, u forcohet besimi dhe vetëm te Zoti i tyre mbështeten, ata që falin namazin dhe japin prej asaj që Ne ua kemi dhënë. Njëmend, ata janë besimtarë të vërtetë. Ata do të kenë shkallë përnderimi te Zoti i tyre, falje dhe furnizimi bujar (në Xhenet).”** (El Enfal, 2-4) Dhe thotë: **“Besimtarë të vërtetë janë vetëm ata që besojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe pastaj nuk dyshojnë, por luftojnë në rrugën e Allahut me pasurinë dhe jetën e tyre. Këta janë besimtarë të sinqertë.”** (El Huxhurat, 15) Ndërkaq, i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: *“Besimi është shtatëdhjetë apo gjashtëdhjetë e ca degë. Më e mira është fjala “la ilabe il-lallah” (nuk ka të adhuruar me të drejtë përveç*

¹²³ Ahmed (22824), Nesaiu në *Es Sunen el kubra* (7716) dhe Axhurri në *Esh Sberijah* (881); teksti është i këtij të fundit, përcjellë nga Ubade, *Allahu qoftë i kënaqur me të!* Të njëjtën gjë e shënon edhe Ibn Maxhe (4077), përcjellë nga Ebu Umame, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

Allabut), kurse më e ulëta është largimi i pengesës nga rruga. Edhe turpi është degë e besimit.” (E shënojnë Buhariu dhe Muslimi, teksti është i këtij të fundit)¹²⁴

Besimi është realitet i përbërë nga fjala dhe vepra. Ai është besim me zemër, që e bën të patjetërsueshëm fjalën dhe veprën. Mosprania e fjalës dhe veprës është argument i mospranisë së vërtetësisë.

2. Kur besimi (imani) përmendet vetëm

Atëherë është sinonim i Islamit e të dy kanë për qëllim tërë fenë. Ndërkaq, kur përmenden së bashku, imani ka për qëllim besimin e brendshëm, kurse Islami ka për qëllim veprën e jashtme. Rrjedhimisht, çdo besimtar është musliman, porse jo çdo musliman është besimtar. Allahu i Lartësuar thotë: **“Arabët e shkretëtirës deklarojnë: “Ne besojmë.” Thuaju: “Ju nuk keni besuar! Por, më mirë thoni: “Ne përulemi”, pasi besimi ende nuk ka hyrë (si duhet) në zemrat tuaja. E, nëse i bindeni Allahut dhe të Dërguarit të Tij, nuk do t’ju pakësohet asgjë prej veprave tuaja. Sigurisht, Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.”** (El Huxhurat, 14)

3. Besimi shtohet dhe pakësohet

Ai shtohet me njohjen e Allahut, meditimin e argumenteve të Tij universale dhe përsiatjen e argumenteve të Tij fetare, si dhe me veprimin e adhurimeve dhe braktisjen e mëkateve; ndërkaq, pakësohet me mosnjohjen e Allahut, pakujdesinë rreth argumenteve të Tij universale dhe kthimin e shpinës argumenteve fetare, shkujdesjen në kryerjen e adhurimeve dhe veprimin e të këqijave. Allahu i Lartësuar thotë: **“... kur u lexohen shpalljet e Tij, u forcohet besimi...”** (El Enfal, 2) Gjithashtu, ai thotë: **“Sa u përket besimtarëve, atyre (kjo sure) ua shton besimin dhe ata gëzohen.”** (Et Teube, 124) Dhe thotë: **“Është Ai, që zbriti qetësi në zemrat e besimtarëve, për t’ua shtuar besimin, krahas besimit që patën.”** (El Fet’h, 4)

4. Degët e besimit nuk janë të barabarta

Disa degë të tij janë më larta sesa të tjerat, ashtu siç qëndron në hadithin e lartpërmendur: *“Besimi është shtatëdhjetë apo gjashtëdhjetë e ca degë. Më e mira është*

¹²⁴ Buhariu (9) dhe Muslimi (35), përcjellë nga Ebu Hurejra, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

fjala “la ilabe il-lallah” (nuk ka të adburuar me të drejtë përveç Allahut), kurse më e ulëta është largimi i pengesës nga rruga. Edhe turpi është degë e besimit.” (E shënojnë Buhariu dhe Muslimi, teksti është i këtij të fundit)

5. Besimtarët nuk janë të barabartë në iman

Disa besimtarë kanë besim më të plotë sesa të tjerët, ashtu siç thotë Allahu i Lartësuar: **“Pastaj, Ne ua dhamë Librin robërve Tanë të zgjedhur (nga ndjekësit e Muhamedit). Disa prej tyre i bëjnë dëm vetes (duke bërë vepra të ndaluara), disa janë në rrugë të mesme (duke kryer detyrimet dhe duke shmangur të ndaluarat), ndërsa disa, me lejen e Allahut, shkojnë përpara me të mira (përtej detyrimeve); kjo është dhuntia e madhe.”** (Fatir, 32) Ndërkaq, i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: *“Besimtari me besimin më të plotë është ai që është më i moralshmi.”* (E shënojnë Ahmedi, Ebu Davudi dhe Tirmidhiu)¹²⁵

Ai që e shqipton shehadetin, duke besuar në kuptimin e tij dhe i përmbahet asaj që kërkon ai, ka bazën e besimit; ai që i vepron obligimet dhe i braktis të ndaluarat, ka besimin obligativ; kurse ai që i kryen obligimet, gjërat e pëlqyera e i braktis të ndaluarat dhe veprat e urryera, ka besimin e plotë.

6. Përjashtimi në besim

Nënkupton që (besimtari) të thotë: Unë jam besimtar, *inshallah* (në dashtë Allahu)! Ky përjashtim i ka tri forma:

E para: Nëse këtë formulim e thotë duke dyshuar në bazën e besimit, atëherë ky përjashtim është i ndaluar. Madje, i tilli është mohim, se besimi është vendosmëri (e jo dyshim).

E dyta: Nëse këtë formulim e thotë nga frika e lavdërimit dhe pastrimit të vetes nga pretendimi se e ka realizuar besimin obligativ ose e ka plotësuar, atëherë kjo është obligim.

E treta: Nëse këtë formulim e thotë duke kërkuar begati me përmendjen e dëshirës së Allahut (në dashtë Allahu), atëherë është e lejuar.

¹²⁵ Ahmedi (7402), Ebu Davudi (4682) dhe Tirmidhiu (1162), përcjellë nga Ebu Hurejra, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

7. Epiteti i besimit nuk humbet me veprimin e ndonjë mëkati; qoftë i vogël apo i madh¹²⁶

Mirëpo, ato e zvogëlojnë besimin, edhe pse i mbetet baza. Vepruesi i mëkateve të mëdha është besimtar me besim të mangët; *besimtar me besimin e tij dhe i shtburur (fasik) me mëkatin e tij të madh*. I tilli, në këtë botë, nuk del nga feja (me këtë veprim) e as nuk përjetësohet në Zjarr në botën e amshueshme. Por, ai do të jetë nën dëshirën e Allahut: nëse do, e fal me mirësinë e mëshirën e Tij dhe e fut në Xhenet; nëse do, e ndëshkon në varësi të mëkatit të tij, porse përfundimi i tij është në Xhenet. Ose, e ndëshkon për shkak të disa mëkateve, rrjedhimisht del (prej Zjarrit) me ndërmjetësimin e ndërmjetësuesve, ose me mëshirën e më të Mëshirshmit (Allahut). Allahu i Lartësuar thotë: **“Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër përveç Tij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë. Kushdo që i bën shok Allahut (në adhurim), ka bërë gjynah të tmerrshëm.”** (En Nisa, 48)

Ndërkaq, i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: *“Xhenetlinjtë do të hyjnë në Xhenet dhe xhebenemlinjtë do të hyjnë në Zjarr. Pastaj Allahu i Lartësuar thotë: “Nxirreni atë që në zemrën e tij ka besim sa një kokërr sinapi!” Ata do të nxirren që andej, ndërkohë janë nxirë. Më pas hidhen në lumin e jetës.”* (E shënon Buhariu)¹²⁷ Gjithashtu, i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: *“Nga Zjarri do të dalë ai që ka thënë “la ilabe il-lallah” duke pasur në zemër mirësi aq sa peshon një kokërr elbi. “Nga Zjarri do të dalë ai që ka thënë “la ilabe il-lallah” duke pasur në zemër mirësi aq sa peshon një kokërr gruri. “Nga Zjarri do të dalë ai që ka thënë “la ilabe il-lallah” duke pasur në zemër mirësi aq sa peshon një grimçë.”* (E shënon Buhariu)¹²⁸ Në një motërzim qëndron: *“... ka besim... ”*, në vend: *“... duke pasur mirësi.”*

Në këtë kapitull kanë devijuar dy grupe:

Grupi i parë: Kërcënuesit (el vaidije), që thonë se kërcënimi do të

126 Për sa kohë që nuk i lejon ato. Shënim i përkthyesit.

127 Buhariu (22), përcjellë nga Ebu Seid el Hudriu, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

128 Buhariu (44), përcjellë nga Enesi, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

përmbushet¹²⁹ dhe për mëkatarët e mëdhenj monoteistë e mohojnë shefatin (ndërmjetësimin). Këta ndahen në dy nëngrupe:

- 1) **Havarixhët**, që thonë së vepruesi i mëkatit të madh del nga besimi dhe kalon në mohim, rrjedhimisht i tilli në këtë botë është jobesimtar dhe në botën e amshueshme në Zjarrin e përhershëm.
- 2) **Mutezilitë**, që thonë se vepruesi i mëkatit të madh del nga besimi dhe kalon në mohim, rrjedhimisht i tilli në këtë botë është në një pozitë të ndërmjetme: as besimtar, as jobesimtar, kurse në botën e amshueshme do të jetë përherë në Zjarr.

Kërcënuesve u kundërpërgjigjemi në disa aspekte. Ja disa prej tyre:

Së pari: Allahu i Lartësuar mëkatarit të madh ia ka pohuar besimin dhe ia ka ruajtur epitelin e vëllazërisë islame në këtë botë, siç ka ardhur në Fjalën e Tij: **“O besimtarë! Është caktuar për ju *kisasi*¹³⁰ për vrasje: I liri për të lirin, skllavi për skllavin dhe femra për femrën. Ndërkaq, atij që i falet diçka nga vëllai i vet (farefisi i të vrrarit), duhet të sillt njerëzishëm dhe le të zbatojë dëmshpërblimin me të mirë.”** (El Bekare, 178) Pra, vrasësin e ka quajtur vëlla të të vrrarit. Dhe siç ka ardhur në Fjalën e Tij: **“Nëse dy palë besimtarësh bëjnë luftë midis tyre, pajtojini ata. Por, nëse njëra palë sulmon tjetrën, atëherë luftoni kundër sulmuesit, derisa të kthehet në urdhrat e Allahut. E, nëse kthehet, atëherë pajtojini ata midis tyre, me drejtësi dhe paanësi, sepse Allahu i do ata që veprojnë me drejtësi. Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër, andaj pajtojini vëllezërit tuaj midis tyre dhe kijeni frikë Allahun, në mënyrë që ju të mëshiroheni.”** (El Huxhurat, 9-10) Të dyja palët që bëjnë luftë midis tyre i ka adresuar në besim dhe ua ka pohuar vëllazërinë e besimit.

Sy dyti: Atij që dëshiron, Allahu ia fal (mëkatet) që janë më të vogla sesa idhujtaria (*shirku*). Gjithashtu, e nxjerr nga Zjarri atë që në zemrën e tij ka besim qoftë edhe më të vogël sesa kokrra e sinapit, gjë për të cilën kanë ardhur

129 Ata thonë se tekstet fetare ku përmendet kërcënimi për atë që bën këtë dhe atë mëkat, do të përmbushen. Ndërkaq, ehlu suneti dhe xhemati thotë se ata që i bëjnë mëkatet e tilla janë nën dëshirën e Allahut: nëse do, i fal; e, nëse do, i dënon. Shënim i përkthyesit.

130 Kisasi në të drejtën juridike islame është ligji i barazisë në ndëshkim.

hadithet mutevatire ¹³¹ rreth ndërmjetësimit.

Grupi i dytë: Murxhitë, që deklarojnë se veprat janë të dala (të vonuara) nga nocioni i besimit. Tek ata vepra nuk bën pjesë në përkufizimin dhe realitetin e besimit. Përkritazi me përkufizimin e besimit, ata ndahen në disa kategori:

- 1) **Xhehmitë:** Besimi është vetëm miratim ose njohje me zemër dhe se mëkati nuk e dëmton besimin, sikurse prania e mohimit që nuk i bën dobi adhurimit.
- 2) **Kerramitë:** Besimi është vetëm shqiptim me gjuhë.
- 3) **Murxhietul fukaha (murxhinjtë juristë):** Besimi është vetëm miratim me zemër e shqiptim me gjuhë dhe veprat nuk hyjnë në përkufizimin dhe realitetin e besimit, por ato janë fryte të tij.

Murxhive u kundërpërgjigjemi në disa aspekte, si:

Së pari: Allahu veprat i ka quajtur besim. Ai, për ata (sahabë) që janë falur në drejtim të Bejtul Makdisit dhe kanë vdekur para se të ndërrohet drejtimi i kiblës, ka thënë: **“Dijeni se Allahu nuk jua humb besimin tuaj!”** (El Bekare, 143) Përkatësisht, namazin tuaj (që e keni falur në drejtim të Kudsit, Allahu e ka quajtur besim).

Së dyti: I Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ia ka mohuar besimin e plotë atij që bën mëkate të mëdha praktike. Ai ka thënë: *“Laviri nuk është besimtar gjatë kohës që kryen marrëdhënie jashtëmartesore, bajduti nuk është besimtar gjatë kohës që vjedh, ai që pi alkool nuk është besimtar gjatë kohës kur e konsumon atë dhe plaçkëtisi që ua merr njerëzve një gjë me vlerë tek e cila kanë drejtuar shikimet njerëzit, gjatë plaçkëtjes së saj, nuk është besimtar.”* (E shënojnë Buhariu dhe Muslimi).¹³²

Zanafilla e këtij mendimi të prishur te të dyja palët, *kërcënuesit* dhe *murxhitë*, rrjedh nga bindja e tyre se besimi është njësi e pandashme: ose ekziston i tëri, ose nuk ekziston fare. Murxhitë e pohojnë besimin vetëm nëpërmjet miratimit me zemër, ose me gjuhë, apo me të dyja bashkërisht, edhe nëse në realitet nuk vepron asgjë. Domethënë, ata janë ithtarë të neglizhencës. Ndërkaq, *kërcënuesit* ia mohojnë

131 *Hadithi mutevatir* është hadithi që e transmetojnë një grup i madh njerëzish, nga fillimi i zinxhirit të transmetimit (senedi) deri në fund. Ky numër i madh transmetuesish bën të pamundur që ata të bien në ujdë për të gënjyer, si dhe baza e lajmit të tyre janë shqisat. Pra, thonë: kemi dëgjuar, ose kemi parë. Shënim i përkthyesit.

132 Buhariu (2475) dhe Muslimi (57), përcjellë nga Ebu Hurejra, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

besimin (mëkatarit) me mëkatin e madh më të ulët. Domethënë, ata janë ithtarë të teprimit. Fillimi i tyre ka qenë i njëjtë, porse rezultati është i përkundërt!

IMAMLLËKU DHE XHEMATI

Muslimanët janë një bashkësi e vetme; çështje kjo e cila qëndron, përmirësohet e i realizohet mesazhi vetëm me pikat vijuese:

1. OBLIGUESHMËRIA E BESATIMIT:

I Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “*Ai që vdes pa i dhënë besën prijësit, vdes vdekeje të xhabilitit.*”¹³³ (E shënon Muslimi)¹³⁴

2. DËGJUESHMËRIA DHE BINDJA NDAJ UDHËHEQËSVE NË GJËRAT E MIRA:

Kryerja e haxhillëkut, (falja e) xhumave dhe bajrameve me udhëheqësit, qofshin të devotshëm apo mëkatarë, si dhe këshillimi i tyre. Në raste mospajtimi, i kthehemi Kuranit dhe Sunetit. Allahu i Lartësuar thotë: **“O besimtarë! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja. Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, drejtojuni Allahut dhe të Dërguarit¹³⁵, nëse besoni Allahun dhe Ditën e Kiametit. Kjo për ju është më e mira dhe shpjegimi më i bukur.”** (En Nisa, 59) Ndërkaq, i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “*Muslimani dubet të dëgjojë dhe të bindet në gjërat që i do dhe i urren, përveç nëse urdhërohet për ndonjë mëkat. Po qe se urdhërohet për ndonjë mëkat, atëherë nuk ka as dëgjim, as bindje.*” (E shënojnë Buhariu dhe Muslimi)¹³⁶ Gjithashtu, ka thënë: “*Ai që heq dorë nga bindja (ndaj udhëheqësit), në Ditën e Gjykimit do ta takojë Allahun, porse nuk do të ketë argument në favor të tij.*” (Shënon Muslimi)¹³⁷

SAHABËT

Sahab quhet ai që është takuar me të Dërguarin, *sal-lallahu alejhi ue selem*, duke i

133 Nuk është qëllimi se ai vdes si jobesimtar, mirëpo qëllimi është se vdes duke u përngjasuar injorantëve të kohës paraislame, të cilët nuk kishin prijës për t’u bindur atyre. Shënim i përkthyesit.

134 Muslimi (1851), përcjellë nga Ibn Omeri, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

135 Pra, drejtojuni Kuranit dhe Sunetit (traditës së regjistruar të profetit Muhamed, *sal-lallahu alejhi ue selem*).

136 Buhariu (7144) dhe Muslimi (1839), përcjellë nga Ibn Omeri, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

137 Muslimi (1851), përcjellë nga Ibn Omeri, *Allahu qoftë i kënaqur me të!* Kjo është pjesë e hadithit të parë në këtë tematikë.



besuar atij dhe ka vdekur si besimtar. *Sababët, Allahu qoftë i kënaqur me ta*, pas të dërguarve, janë njerëzit më të mirë dhe janë gjenerata më e mirë e këtij umeti. I Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “Njerëzit më të mirë janë gjenerata ime.”¹³⁸ Dhe ka thënë: “Më të mirët e umetit tim janë gjenerata ime.” (E shënojnë Buhariu dhe Muslimi)¹³⁹

Të gjithë ata kanë qenë të besueshëm. Kjo, se Allahu i Lartësuar i ka zgjedhur për ta shoqëruar të Dërguarin e Tij, *sal-lallahu alejhi ue selem*, i ka lavdëruar, ka qenë i kënaqur me ta, ua ka pranuar pendimin, i ka cilësuar me epitetet më fisnike dhe u ka premtuar premtimin më të mirë. Allahu i Lartësuar thotë: **“Muhamedi është i Dërguari i Allahut. Ata që janë me të, janë të ashpër ndaj jobesimtarëve e të mëshirshëm midis tyre. I sheh ata si përkulen dhe bien në sexhde, duke kërkuar dhuntinë dhe kënaqësinë e Allahut. Në fytyrat e tyre shihen shenjat e sexhdes. Ky është përshkrimi i tyre në Teurat. Ndërsa në Ungjill, shembulli i tyre përshkruhet si një farë e mbjellë që lëshon filiza e forcohet e pastaj ngrihet e fortë me kërcellin e vet, duke i gëzuar mbjellësit.¹⁴⁰ (Kështu përshkruhen ata) me qëllim që, nëpërmjet tyre, Ai t’i zemërojë mohuesit. Për ata midis tyre që besojnë dhe kryejnë vepra të mira, Allahu ka premtuar falje dhe shpërblim të madh.”** (El Fet’h, 29).

Megjithatë, ata dallojnë prej njëri-tjetrit, dallim ky që është i përgjithshëm dhe i veçantë.

1. Dallimi i përgjithshëm

- *Muhaxhirët janë më të mirë se ensarët*

Ngaqë e kanë gërshetuar hixhretin (emigrimin) dhe ndihmesën (ndaj të Dërguarit), e ngaqë Allahu i Lartësuar i ka përmendur të parët, kur thotë: **“Një pjesë e plaçkës u takon edhe mërgimtarëve të varfër¹⁴¹, të cilët u përzunë nga vendlindja dhe pasuritë e tyre, duke kërkuar mirësinë dhe kënaqësinë**

¹³⁸ Buhariu (2652) dhe Muslimi (2533), përcjellë nga Ibn Mesudi, Allahu qoftë i kënaqur me të!

¹³⁹ Buhariu (3650) dhe Muslimi (2530), përcjellë nga Imran ibn Husejni, Allahu qoftë i kënaqur me ta! teksti është i Buhariut.

¹⁴⁰ *Fara* simbolizon fenë islame, rritja e së cilës, në fuqi dhe në numër, sigurisht që i mrekullon shikuesit. Ndërkaq, *mbjellësit* simbolizojnë profetin Muhamed, *sal-lallahu alejhi ue selem*, dhe shokët e tij, që bënë përpjekjet më të mëdha për rritjen dhe përhapjen e kësaj feje. Përkthyesi, prof. Hasan I, Nahi, *Allahu e mëshiroftë!*

¹⁴¹ Ata që janë shpërngulur për hir të fesë nga Meka në Medinë.

e Allahut dhe duke ndihmuar Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Pikërisht ata janë besimtarët e sinqertë. Ndërsa ata që banojnë në Medinë dhe që e kanë pranuar besimin qysh më parë¹⁴², i duan mërgimtarët që vijnë në Medinë dhe në zemrat e tyre nuk ndiejnë kurrfarë rëndimi, për atë,¹⁴³ që u është dhënë atyre, por duan t'u bëjnë më mirë mërgimtarëve sesa vetes, edhe pse vetë janë nevojtarë. Kushdo që ruhet nga lakmia e vetvetes, me siguri që do të jetë fitues.” (El Hashr, 8-9)

“Sa u përket besimtarëve të parë, prej muhaxhirëve¹⁴⁴ dhe ensarëve¹⁴⁵, Allahu është i kënaqur me ta dhe me të gjithë të tjerët që i pasuan me vendosmëri e përkushtim në besim; edhe ata janë të kënaqur me Të. Allahu ka përgatitur për ta kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj dhe ku do të jetojnë përgjithmonë. Kjo është fitorja madhështore!” (Et Teube, 100)

“Pa dyshim, Allahu e pranoi pendimin e të Dërguarit, të muhaxhirëve dhe të ensarëve, të cilët shkuan pas tij në çastin e vështirë, pasi zemrat e disave prej tyre për një fije qenë afër shmangies (nga detyra), pastaj Allahu pranoi pendimin e tyre¹⁴⁶. Vërtet, Ai është i Butë dhe i Mëshirshëm me ta.” (Et Teube, 117)

- *Ata që kanë shpenzuar para Marrëveshjes së Hudejbijes dhe kanë luftuar, janë më të mirë se ata që kanë shpenzuar e luftuar pas saj*

Allahu i Lartësuar thotë: “Nuk janë të barabartë ata që kanë shpenzuar dhe kanë luftuar para fitores me ata që kanë shpenzuar dhe kanë luftuar më pas. Ata kanë shkallë më të lartë, mirëpo Allahu u premtonte të gjithëve më të mirën (Xhenetin). Allahu e di mirë atë që bëni ju.” (El Hadid, 10)

2. Pjesëtarët e Bedrit

Bazuar në fjalën e të Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, thënë Omerit, *Allahu*

142 Pra, para mbërritjes së mërgimtarëve në Medinë.

143 Plaçkën e luftës që u është ndarë mërgimtarëve të varfër.

144 Muhaxhirët janë muslimanët mekas që emigruan nga Meka në Medinë gjatë viteve të para të Islamit, për shkak të persekutimit që kishin pësuar nga banorët e Mekës. Përkthyesi, prof. Hasan I, Nahi, *Allahu e mëshiroftë!*

145 Ensarët janë muslimanët e Medinës që strehuan dhe ndihmuan profetin Muhamed, *sal-lallahu alejhi ue selem*, dhe muhaxhirët e tjerë muslimanë të ardhur nga Meka. Përkthyesi, prof. Hasan I, Nahi, *Allahu e mëshiroftë!*

146 Bëhet fjalë për fushatën e Tebukut, e cila ka ndodhur në vitin 9 h/631 e.s.

qoftë i kënaqur më tël, në tregimin e Hatib ibn Ebu Beltait: “Ai ka marrë pjesë në Bedër. Ku ta dish?! Mbase Allahu i ka shikuar pjesëtarët e Bedrit dhe ka thënë: “Punoni ç’të doni, ngase jua kam falur!” (E shënojnë Buhariu dhe Muslimi)¹⁴⁷

3. Pjesëmarrësit në Besëlidhjen e Kënaqësisë (Bejatur Ridvan)

Allahu i Lartësuar thotë: **“Allahu është i kënaqur me ata besimtarë, kur t’u betuan për besnikëri nën hijen e pemës. Ai e dinte çfarë kishte në zemrat e tyre, prandaj u dha atyre qetësi¹⁴⁸ dhe i shpërbleu me një fitore të afërt.”**¹⁴⁹ (El Fet’h, 18) Ndërkaq, i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: *“Askush prej atyre që janë betuar për besnikëri nën hijen e pemës nuk do të hyjë në Zjarr, në dashtë Allahu.”* (E shënon Muslimi)¹⁵⁰

4. Dallimi i veçantë

- Katër kalifët e drejtë

Njerëzit më të mirë në këtë umet pas të Dërguarit tonë janë Ebu Bekri, pastaj Omer ibn Hatabi, gjë për të cilën ehlu suneti dhe xhemati janë të njëzëshëm. Transmetimet janë *mutevatire* dhe kanë ardhur mbi tetëdhjetë rrugë transmetimi që pohojnë se Aliu, *Allahu qoftë i kënaqur me tël*, në minberin e Kufes ka thënë: *“(Njeriu) më i mirë i këtij umeti pas të Dërguarit, sal-lallahu alejhi ue selem, është Ebu Bekri, pastaj Omeri.”* (E shënojnë Ahmedi, me zinxhir të saktë transmetuesish, Ibn Ebu Asimi, saktësuar nga Albani)¹⁵¹ Për këtë çështje Aliu, *Allahu qoftë i kënaqur me tël*, nuk mund të flasë me kompetencë pa pasur dituri rreth saj.

Pas tyre më i miri është Othman ibn Afani, Allahu qoftë i kënaqur me tël, bazuar në hadithin e Abdullah ibn Omerit, *Allahu qoftë i kënaqur me tël*, që e shënon Buhariu: *“Bënim zgjedhje ndërmjet njerëzve në kobën e të Dërguarit, sal-lallahu alejhi ue selem: ne e zgjidhnim Ebu Bekrin, pastaj Omerin, pastaj Othmanin, Allahu qoftë i kënaqur me ta!”*¹⁵² Në një motërzim tjetër qëndron: *“Kjo (zgjedhje ndërmjet*

147 Buhariu (3007) dhe Muslimi (2494), përcjellë nga Aliu, *Allahu qoftë i kënaqur me tël*

148 Qetësia e përmendur në këtë varg është përkthim i fjalës arabe sekina. Sipas disa thënieve të profetit Muhamed, *sal-lallahu alejhi ue selem*, = të regjistruara në librat e Buhariut dhe të Muslimit, sekina është një prani shpirtërore që zbrit së bashku me engjëjt për të sjellë qetësi në shpirtrat e besimtarëve të devotshëm.

149 Fitoren e Betejës së Hajberit në vitin 7 h/629.

150 Muslimi, (2496), përcjellë nga Umu Mubeshiri, *Allahu qoftë i kënaqur me tël*

151 Ahmedi (836) dhe Ibn Ebu Asimi në Es Suneh, me verifikim të Albanit (1201).

152 Buhariu (3655).

*njerëzve) i arrinte të Dërguarit, sal-lallabu alejhi ue selem, e ai nuk e mohonte.”*¹⁵³

Sufjan eth Theuriu, *Allahu e pastë mëshiruar!*, ka thënë: “*Ai që i jep përparësi Aliut kundrejt Ebu Bekrit dhe Omerit, sigurisht që i ka nënçmuar mubaxhirët dhe ensarët.”*¹⁵⁴

Kjo, se ata i kanë dhënë përparësi atij në kalifat (udhëheqje). (Pas këtyre treve) vjen Aliu, Allahu qoftë i kënaqur me të! Sipas vlerës që kanë, renditja e tyre është e njëjtë me renditjen e tyre në kalifat.

- Të përgëzuarit me Xhenet

Ata janë: katër kalifët e drejtë (Ebu Bekri, Omeri, Othmani dhe Aliu), Abdurrahman ibn Afi, Sad ibn Ebu Vekasi, Talha ibn Ubejdullahu, Zubejr ibn el Avami, Ebu Ubejde Amir ibn Xherrahu, Seid ibn Zejdi, Allahu qoftë i kënaqur më të gjithë!

I Dërguari, *sal-lallabu alejhi ue selem*, për këtë dhjetëshe ka dëshmuar se do të hyjë në Xhenet. (E shënojnë të pestët)¹⁵⁵, ndërkohë (hadithi) është i saktë.

Krahas tyre, tekstet tregojnë se me Xhenet janë përgëzuar edhe të tjerë, si: Bilali,¹⁵⁶ Thabit ibn Kajsi¹⁵⁷ dhe Abdullah ibn Selami,¹⁵⁸ *Allahu qoftë i kënaqur më të gjithë!*

- Familja e të Dërguarit, sal-lallabu alejhi ue selem (ehulul bejti)

Familje e tij konsiderohen pesë barqet që e kanë haram marrjen e lëmoshës, si: familja e Aliut, Khaferit, Akilit, Abasit dhe bijtë e Harith ibn Abulmutalibit. I Dërguari, *sal-lallabu alejhi ue selem*, ka thënë: “*Nga bijtë e Ismailit, alejhi selam, Allahu i Lartmadhërisëm e ka zgjedhur (fisin) kinan; kurejshët i ka zgjedhur nga (fisi)*

153 Ibn Ebu Asimi në Es Sunch, me verifikim të Albanit (1193).

154 Ibn Meini (885) në *Et Tarib*, përcjellë nga Ibn Muhrizi, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*; Halali në Es Sunch (528). Hatib el Bagdadi në Tarihu Dimeshk (5/50) nga Halali me tekstin: “Ai që i jep përparësi Aliut kundrejt Othmanit, veçse i ka nënçmuar dymbëdhjetë mijë. I Dërguari, *sal-lallabu alejhi ue selem*, vdiq duke qenë i kënaqur ndaj atyre që ishin tubuar për t’ia dhënë besën Othmanit.

155 Ahmedi (1675), Tirmidhiu (3747) dhe Nesaiu në *Es Sunen el kubra* (8138), përcjellë nga Abdurrahman ibn Afi, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, ku është përmendur dhjetëshja; si dhe Ahmedi (1631), Ebu Davudi (4649), Tirmidhiu (3748), Nesaiu në *Es Sunen el kubra* (8162) dhe Ibn Maxhe (133), përcjellë nga Seid ibn Zejdi, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, ku janë përmendur nëntë.

156 Buhariu (1149) dhe Muslimi (2458), përcjellë nga Ebu Hurejra, Allahu qoftë i kënaqur me të!; si dhe Muslimi (2457), përcjellë nga Xhabiri, Allahu qoftë i kënaqur me të!

157 Buhariu (3613) dhe Muslimi (119), përcjellë nga Enesi, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

158 Buhariu (3812) dhe Muslimi (2483), përcjellë nga Sad ibn Ebu Vekasi, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

kënan; e nga kurejshët ka zgjedhur bijtë e Hashimit. Ndërkaq, mua më ka përzgjedhur nga bijtë e Hashimit.” (Shënon Muslimi)¹⁵⁹ Gjithashtu ka thënë: *“Jua kujtoj Allahun në lidhje me familjen time! Jua kujtoj Allahun në lidhje me familjen time!”* (E shënon Muslimi)¹⁶⁰ Kur Abas ibn Abdulmutalibi, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, i ishte ankuar të Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, se disa kurejshë kishin sjellje të keqe me bijtë e Hashimit, ai kishte thënë: *“Betohem në Allahun se asnjë njeriu nuk do t’i hyjë imani në zemër, derisa t’ju duan ju për hir të Allahut dhe për shkak të farefisnisë suaj me mua!”* (Shënon Ahmedi)¹⁶¹

Në familjen e të Dërguarit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, bëjnë pjesë edhe gratë e tij të ndershme dhe të dëlira. Allahu i Lartësuar ka thënë: **“Oj familja e Profetit! Në të vërtetë, Allahu do që ta largojë prej jush papastërtinë dhe t’ju pastrojë plotësisht.”** (El Ahzab, 33) Allahu i ka zgjedhur ato për të Dërguarin e Tij dhe i ka bërë gra të tij në këtë dhe në botën tjetër. Ato i ka quajtur *nëna të besimtarëve*. Më e mira prej tyre është Hadixhja, pastaj Aishja, e bija e Ebu Bekrit, *Allahu qoftë i kënaqur me to!* Të tjerat janë: Sevde bint Zemah; Hafsa, e bija e Omerit; Umu Seleme; Umu Habibe, e bija e Ebu Sufjanit; Safije bint Hujej; Zejnebe bint Xhahsh; Xhujejria; Mejmuna dhe Zejneb bint Huzejme, *Allahu qoftë i kënaqur më të gjitha!*

5. Obligimi ynë karshi sahabëve, pavarësisht shtresave dhe pozitave të tyre

- *T’i duam e t’i miqësojmë, të kërkojmë falje dhe kënaqësinë e Allahut për ta, një nga një dhe si bashkësi*

Allahu i Lartësuar thotë: **“Besimtarët dhe besimtare të tjerë janë miq për njëri-tjetrin.”** (Et Teube, 71) Gjithashtu, Ai thotë: **“Edhe ata që erdhën pas tyre, thonë: “O Zoti ynë, falna ne dhe vëllezërit tanë, të cilët kanë besuar para nesh...”** (El Hashr, 10) Ndërkaq, i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: *“Shenjë e besimit është dashuria e ensarëve, kurse shenjë e dyfytërsisë është urrejtja ndaj tyre.”* (Shënon Buhariu)¹⁶²

Aliu, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, ka thënë: *“Betohem në Atë që e çan farën dhe*

159 Muslimi (2276), përcjellë nga Vathile ibn Eska, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

160 Muslimi (2408), përcjellë nga Zejd ibn Erkami, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

161 Ahmedi (1777), përcjellë nga Abas ibn Abdulmutalibi, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

162 Buhariu (18), përcjellë nga Enesi, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

e krijon njeriun se me të vërtetë ky është një premtim që i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, i cili nuk di shkrim e lexim, ma ka bërë mua: “*Mua do të më dojë vetëm besimtari dhe do të më urrejë vetëm hipokriti.*” (Shënon Muslimi)¹⁶³

- *Zemrat dhe gjubët t’i kemi të pastra karshi tyre, përfshirë smirën, mendimin e keq, sharjen dhe mallkimin*

Allahu i Lartësuar thotë: “... dhe mos lejo që në zemrat tona të ketë asnjë të keqe ndaj besimtarëve! O Zoti ynë, vërtet Ti je i Butë dhe Mëshirëplotë!” (El Hashr, 10) Ndërkaq, i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: “*Mos i shani shokët e mi! Betohem në Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im, se, sikur ndokush prej jush të japë lëmshë në ar sa mali i Uhudit, nuk do ta arrinte dot lëmshën sa dy grushtet e tyre e as sa gjysma.*” (E shënojnë Buhariu dhe Muslimi)¹⁶⁴

- *Heshtja ndaj çdo konflikti që ka ndodhur ndërmjet disa prej tyre dhe mendimi i mirë për ta*

Duhet t’i arsyetojmë ata, ngase kanë qenë muxhtehidë (kanë bërë përpjekje), të cilët, ose ia kanë qëlluar, me ç’rast i kanë dy shpërblime (të përpjekjes dhe që ia kanë qëlluar së vërtetës); ose kanë gabuar dhe e kanë një shpërblim (atë të përpjekjes). Ata u kanë paraprirë të tjerëve (me vepra të mira), kanë pasur virtyte, të mira madhështore, gjë e cila bën të detyrueshme faljen e mëkateve, nëse kanë vepruar ndonjë mëkat.

- *Distancimi nga rruga e rafidive, të cilët e teprojnë rreth familjes së të Dërguarit, sal-lallahu alejhi ue selem, urrejnë e shajnë shumicën e sahabëve, si dhe distancimi nga rruga e nasibive, të cilët janë të vrazhdë dhe lëndues ndaj familjes së të Dërguarit, sal-lallahu alejhi ue selem.*



TË DASHURIT E ALLAHUT

163 Muslimi (78).

164 Buhariu (3673) dhe Muslimi (2540), përcjellë nga Ebu Seidi, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*; si dhe Muslimi (2540), përcjellë nga Ebu Hurejra, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*



(EVLIJATË)

Të gjithë besimtarët janë të dashur të Allahut (*evlija*): **“Allahu është Mbrojtësi (el Velij) i atyre që besojnë.”** (El Bekare, 257) Prej tyre më i nderuari tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij: **“Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij.”** (El Huxhurat, 13) Pra, ai që i frikësohet Allahut, është i dashur i Tij. Dashuria e tyre ndaj Tij nënkupton se i binden dhe e duan, kurse dashuria e Tij ndaj tyre nënkupton se i do dhe u bën mirë.

1. I DASHURI I ALLAHUT (VELIJU)

I dashur i Tij është çdo besimtar i devotshëm.¹⁶⁵ Allahu i Lartësuar thotë: **“Pa dyshim, të dashurit e Allahut nuk do të kenë arsye për t’u frikësuar dhe as për t’u dëshpëruar. (Të tillët janë) ata që besojnë dhe që (i) frikësohen (Allahut).”** (Junus, 62-63) Pozita e tyre, si të dashur të Allahut, është në varësi të pozitës së tyre në besim dhe devotshmëri ndaj Tij, e jo në bazë të prejardhjes dhe pretendimeve. Allahu i Lartësuar thotë: **“Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshëm dhe për Të asgjë nuk është e fshehtë.”** (El Huxhurat, 13)

2. MREKULLIA (KERAMETI)

Kerameti është diçka e jashtëzakonshme, të cilën Allahu ua mundëson disa të dashurve të Tij, shenjë nderimi për të dhe miratimi për të Dërguarin që ai e pason. Kerametet ndahen në dy lloje:

I pari: Në dijeni, zbulim të gjërave që nuk u shfaqen të tjerëve, mprehtësi dhe inspirime.¹⁶⁶

I dyti: Në fuqi dhe ndikime.¹⁶⁷

Kerametet u kanë ndodhur edhe të dashurve të Allahut (*evlijave*) në popujt e kaluar dhe gjeneratës së parë të këtij umeti, si sahabëve dhe tabiünëve¹⁶⁸. Në këtë umet kremaetet do të jenë të pranishme deri në Ditën e Gjykimit.

BAZA TË PËRGJITHSHME RRETH ARGUMENTIMIT

¹⁶⁵ Pra, që është i devotshëm, duke i kryer urdhrat dhe duke iu larguar ndalesave. Shënim i përkthyesit.

¹⁶⁶ Pra, Allahu i jep dituri që s’e fitojnë dot të tjerët, jo nga mundi i vet, por dhuratë nga Ai. Allahu ia mundëson atij që t’i shohë ca gjëra që nuk shihen për së afërmi. Gjithashtu, e inspiron që të veprojë apo të mos veprojë ndonjë gjë që është në të mirën e tij. Shënim i përkthyesit.

¹⁶⁷ Allahu ia mundëson që të bëjë gjëra që njerëzit e rëndomtë nuk i bëjnë, bie fjala, rasti i Merjemes, kur ajo e shkundi trungun e hurmës, me ç’rast mbi të ranë hurma të freskëta. Shënim i përkthyesit.

¹⁶⁸ Tabiünët janë ata që kanë ardhur pas periudhës së sahabëve, janë shoqëruar me ta duke qenë besimtarë dhe kanë vdekur si të tillë. Shënim i përkthyesit.

1. BAZAT E PËRGJITHSHME

Bazat nga të cilat merret doktrina, sheriat (legjislacioni islam) dhe morali janë tri: Kurani, Suneti autentik dhe konsensusi i saktë (*ixhamai*)¹⁶⁹. Këto nuk lejohet të kundërshtohen asesi duke përdorur logjikën, analogjinë, shijet, vegimet apo thëniet e ndokujt, kushdo qoftë ai.

2. RRUGA PËR TA KUPTUAR KURANIN DHE SUNETIN

Ajo është rruga e besimtarëve të parë muhaxhirë, ensarë dhe atyre që i pasuan me vendosmëri e përkushtim në besim, si dhe largimi nga metodat e bidatçinjve, të cilën e kanë shpikur skolastikët (mutekelimët) dhe sufitë. Allahu i Lartësuar thotë: **“Këdo që e kundërshton të Dërguarin, pasi i është dhënë udhëzimi dhe ndjek rrugë tjetër nga ajo e besimtarëve, Ne e lëmë të ecë andej nga është nisur dhe do ta përcëllojmë në zjarrin e Xhehenemit; eh, sa vendbanim i keq që është ai!”** (En Nisa, 115)

3. LOGJIKA E ÇILTËR

Është logjika e paprekur nga dyshimet dhe epshet. Është ajo që nuk e kundërshton tekstin autentik fetar i cili nuk është prekur nga defektet zhvlerësuese. Ka raste kur tekstet fetare vijnë me gjëra që e hutojnë mendjen, mirëpo kurrë nuk vijnë me gjëra të pakapshme për logjikën. Atij që supozon se ka kontradiktë (mes teksteve dhe logjikës), kjo i ndodh si pasojë e mendjes së tij të prishur, supozim ky i cili ia bën të domosdoshëm t’i japë përparësi tekstit fetar kundrejt logjikës.

BIDATI

Me bidat nënkuptojmë shpikjet që bëhen në fe. I Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: *“Kujtdo që shpikë në fenë tonë atë që nuk është prej saj, do t’i refuzohet.”* (E shënojnë Buhariu dhe Muslimi)¹⁷⁰ Në një motërzim të Muslimit qëndron: *“Atij që bën ndonjë vepër që nuk është në përputhje me fenë tonë, do t’i refuzohet.”*¹⁷¹

Ekzistojnë disa lloje të bidateve:

169 *Ixhma* quhet konsensusi i dijetarëve të umetit në një kohë të caktuar për një çështje fetare. *Ixhmai* është argumenti i tretë që merret për bazë në Islam, pas Kuranit dhe Sunetit. Shënim i përkthyesit.

170 Buhariu (2697) dhe Muslimi (1718), përcjellë nga Aishja, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

171 Muslimi (1718), përcjellë nga Aishja, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

1. **Doktrinare**, si: shiizmi, havarixhizmi, kaderizmi dhe murxhizmi;
2. **Praktike**, si: murgëria dhe sektarizmi;
3. **Në bazë**, si: festimi i ditëlindjeve¹⁷² dhe dhikret e shpikura;
4. **Shtesë**: depërton në adhurim, përfshirë shkakun, llojin, sasinë, formën, kohën apo vendin e tij;
5. **Të rënda**, si: shirku me llojet e tij;
6. **Të lehta**, si: dhikri i bërë bashkërisht (me xhemat);
7. **Që nxjerrin nga feja**, si: mohimi i cilësive të Allahut të Lartësuar;
8. **Që kategorizojnë shthurjen**, si: semaja e ndaluar (poezitë apo dhikri i shoqëruar me muzikë)¹⁷³.

DISA GJËRA QË E PLOTËSOJNË BESIMIN

1. URDHËRIMI PËR VEPRA TË MIRA DHE NDALIMI PREJ VEPRAVE TË KËQIJA

Allahu i Lartësuar thotë: **“Le të dalë prej jush një grup që të thërrasë për në mirësi, të urdhërojnë për vepra të mira e të ndalojnë prej veprave të shëmtuara! Këta njerëz do të jenë të shpëtuarit.”** (Alu Imran, 104)

Nga Ebu Seid el Hudriu, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, përcillet se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, duke thënë: *“Kushdo që sheh ndonjë të keqe, le ta ndryshojë me dorën e tij; e, nëse nuk mundet, atëherë me gjuhën e tij; e, nëse nuk mundet as kështu, atëherë me zemrën e tij, por ky është besimi më i dobët.”*¹⁷⁴

Para se të ndërmarresh këtë veprim patjetër duhet të kesh dije, që shoqërohet me butësi, dhe të jesh i durueshëm pas kësaj (vepre).

2. RUAJTA E UNITETIT DHE KOMPAKTËSISË, SI DHE LARGIMI NGA PËRÇARJA DHE KONTRADIKTA

172 Ditëlindjet e shpikura për profetët dhe evlijatë e tyre. Shënim i përkthyesit.

173 Semaja e mistikëve është vjershë e recituar dhe kënduar me zë melodik, shoqëruar me disa instrumente muzikore, me qëllim adhurimin e Allahut. Abdurrahman Kureshi, *Es Sema inde es sufijeh arrdun ue nakdun*, f. 35 dhe *Muxhem elfadh es sufijeh*, f. 176. Shënim i përkthyesit.

174 Muslimi (49).

Allahu i Lartësuar thotë: **“Të gjithë mbahuni fort për litarin e Allahut (Kuranin) dhe mos u përçani! Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju, sepse, kur ishit në armiqësi, Ai i pajtoi zemrat tuaja e, në saje të dhuntisë së Tij, u bëtë vëllezër. Dhe ju ishit buzë greminës së zjarrit, ndërsa Ai ju shpëtoi prej saj. Kështu, Allahu jua shpjegon shpalljet e Veta, që ju të drejtoheni në udhën e drejtë. Le të dalë prej jush një grup që të thërrasë për në mirësi (për në fenë e pastër islame), të urdhërojë për vepra të mira e të ndalojë prej veprave të shëmtuara! Këta njerëz do të jenë të shpëtuarit. Mos u bëni si ata që, pasi u erdhën provat e qarta, u përçanë dhe u grindën. Për këta do të ketë dënim të madh.”** (Alu Imran, 103-105)

“Qëndroni në fenë e drejtë dhe mos u përçani në të!” (Esh Shura, 13)

I Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: *“Besimtari për besimtarin është si ndërtesa: secila pjesë e saj e forcon tjetrën”,* - dhe kryqëzoi gishtërinjtë e tij. (E shënojnë Buhariu dhe Muslimi)¹⁷⁵

Gjithashtu, i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: *“Besimtarët në dashuri, mëshirë dhe ndjenja të ndërsjella i shëmbëlajnë trupit: nëse njëra pjesë e tij ankohet, i gjithë trupi vuan nga pagjumësia dhe etbet.”*¹⁷⁶

3. VIRTYTET E LARTA MORALE DHE VEPRAT E MIRA

Si: durimi, bujaria, trimëria, butësia, falja e thjeshtësia, përkatësisht braktisja e të kundërtave të tyre. Gjithashtu, këtu bëjnë pjesë: respektimi i prindërve, mbajtja e lidhjeve farefisnore, fqinjësia e mirë, bamirësia ndaj jetimëve, nevojtarëve dhe shtegtarëve të mbetur rrugëve.

Allahu i Lartësuar thotë: **“Trego mëshirë, urdhëro vepra të mira dhe shmangu nga të paditurit!”** (El Araf, 199)

Nga Ebu Derdai, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, përcillet se i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: *“Në peshoren (e Ditës së Gjykimit) nuk ka gjë që peshon më*

¹⁷⁵ Buhariu (2446) dhe Muslimi (2585), përcjellë nga Ebu Musai, Allahu qoftë i kënaqur me të!; teksti është i Buhariut.

¹⁷⁶ Muslimi (2586); përcjellë nga Numan ibn Beshiri, *Allahu qoftë i kënaqur me ta!*

rëndë sesa morali i mirë.”¹⁷⁷

Ebu Hurejra, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, përcjell se i Dërguari, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ka thënë: *“Atij që ia largon besimtarit një brengë të kësaj bote, Allahu do t’ia largojë një brengë të Ditës së Kiametit. Ndërkaq, kush ia lehtëson (borxhin) atij që është në vështirësi, Allahu do t’ia lehtësojë në këtë botë dhe në të amshueshmen. Atij që ia mbulon të metat një muslimani, Allahu do t’ia mbulojë të metat në këtë botë dhe në tjetrën. Allahu i ndihmon robit të Tij ashtu siç i ndihmon ai vëllait të vet. Atij që merr rrugë për të nxënë dije, Allahu do t’ia lehtësojë rrugën për në Xhenet. Sa herë që mblidhet një grup njerëzish në ndonjë shtëpi të Allahut (xhami) për ta lexuar dhe studiuar Librin e Tij ndërmjet vete, mbi ta zëbret qetësia, i mbulon mëshira, i rrethojnë engjëjt (melekët) dhe Allahu i përmend në praninë e atyre që janë tek Ai. Atë që e lë prapa vepra e tij, nuk e çon përpara prejardhja e tij.”¹⁷⁸*



FEJA DHE SEKTARIZMI

¹⁷⁷ Ebu Davudi (4799) dhe Tirmidhiu (2002, 2003); versioni është i Ebu Davudit. Te Tirmidhiu qëndron kjo shtesë: *“Me të vërtetë, ai që posedon moral të mirë, me të arrin shkallën e atij që agjëron dhe falet.”*

¹⁷⁸ Muslimi (2699).



Feja e Allahut është një, respektivisht Islami. Allahu i Lartësuar thotë: **“Feja e vërtetë tek Allahu është vetëm Islami.”** (Alu Imran, 19) Ajo është feja e Allahut për të parët dhe për të fundit. Allahu i Lartësuar thotë: **“Ne kemi dërguar Teuratin, në të cilin janë udhëzimet dhe drita. Sipas tij, profetët që ia kishin dorëzuar (eslemu) veten Allahut, i gjykonin hebrenjtë...”** (El Maide, 44) Islami, në kuptimin e përgjithshëm, është: dorëzimi ndaj Allahut me njëshmërinë (*teuhid*), nënshtrimi ndaj Tij me adhurim dhe distancimi nga idhujtaria.¹⁷⁹ Ndërkaq, sipas kuptimit të ngushtë Islami është ai me të cilin Allahu e ka dërguar të Dërguarin e Tij, Muhamedin, *sal-lallabu alejhi ue selem*, me udhëzimin dhe fenë e vërtetë, ku bëjnë pjesë: besimet e sakta, legjislacionet e drejta, veprat e mira, moralet e bukura. Allahu e ka bërë atë shfuqizues të feve paraprake, ndaj Ai nuk pranon fe përveç tij. Allahu i Lartësuar thotë: **“Kush kërkon tjetër fe përveç Islamit, nuk do t’i pranohet dhe ai në botën tjetër do të jetë i humbur.”**¹⁸⁰ (Alu Imran, 85) I Dërguari, *sal-lallabu alejhi ue selem*, ka thënë: *“Betobem në Atë, në dorën e të Cilit është shpirti i Muhamedit, se çdokush i këtij umeti që dëgjon për mua, qoftë çifut a i krishterë, e vdes duke mos besuar në atë me të cilin jam dërguar, do të jetë banor i Zjarrit.”* (E shënon Muslimi)¹⁸¹

Allahu i ka quajtur muslimanë robërit e Tij të cilëve u ka dhënë mirësi që më parë. Ai thotë: **“Ai ju ka zgjedhur dhe nuk ju ka vënë asnjë barrë në**

179 Distancimi nga idhujtaria, kjo e sjell në shprehje edhe distancimin nga idhujtarët. Allahu i Lartësuar për këtë thotë: “Shembull i mrekullueshëm për ju është Ibrahim dhe ata që kanë qenë me të, kur i thanë popullit të vet: **“Ne shkëputemi nga ju dhe nga ato që ju i adhuroni në vend të Allahut; ne ju mohojmë dhe armiqësia dhe urrejtja midis nesh është e përhershme derisa, të besoni tek Allahu Një dhe i Vetëm.”** (El Mumtehine, 60) Shejh Muhamed ibn Salih el Uthejmini, *Allahu e mëshiroftë!* Shënim i përkthyesit.

180 Feja islame ka ardhur me të gjitha mirësitë shpirtërore, trupore, jetësore dhe shoqërore. Këto cilësi, përveç në Kuranin fisnik, nuk janë paraqitur tërësisht në asnjë libër. Nga këto të mira nuk bën të zbrapsemi, sepse feja islame nuk e lejon kthimin e njerëzve mbrapa. Ka shumë shembuj që tregojnë se profeti Muhamed, *sal-lallabu alejhi ue selem*, nuk e ka ngarkuar popullin me aq shumë vepra të tepërta, të cilat do të shkaktonin kthimin e tij mbrapa. Përkthyesi, prof. Hasan I, Nahi, *Allahu e mëshiroftë!*

181 Muslimi (153), përcjellë nga Ebu Hurejra, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*

fenë tuaj, fenë e babait tuaj, Ibrahimit. Ai ju ka quajtur muslimanë...”

(El Haxh, 78) Mirëpo, pastaj ndodhi ligji i Allahut në krijesat e Tij, që ata të përçahen dhe të ndahen, siç ka thënë i Dërguari i Tij, *sal-lallahu alejhi ue selem*: “*Vini re, ithtarët e Librit, që kanë qenë para jush, janë ndarë në shtatëdhjetë e dy grupe, e ky umet (populli musliman) do të ndahet në shtatëdhjetë e tri (grupe). Shtatëdhjetë e dy (do të jenë) në Zjarr e njëri në Xhenet, i cili është xhemati (bashkësia e muslimanëve).*” (E shënojnë Ebu Davudi dhe Tirmidhiu) *Ky grup i shpëtuar janë pasuesit e Sunetit (traditës profetike) dhe xhematit (bashkësisë së muslimanëve), të cilët janë të kapur për Librin (e Allahut, Kuranin) dhe e pasojnë Sunetin (e të Dërguarit). Ata janë të pastër prej njollave, epsheve dhe bidateve (risive në fe). Ata janë pala ngadhënjimtare, për të cilët i Dërguari, sal-lallahu alejhi ue selem ka thënë: “Një grup i umetit tim do të vazhdojë t’i përmbahet urdhrit të Allahut. Atyre nuk u bëjnë dëm ata që i braktisin dhe që i kundërshtojnë. Kështu do të jenë derisa të vijë urdhri i Allahut (Çasti i Kiametit): ngadhënjimtarë ndaj të gjithë njerëzve.”* (E shënojnë Buhariu dhe Muslimi)¹⁸²

Ata janë mesatarë ndërmjet dy drejtimeve (të skajshme), të drejtë ndërmjet dy shtrembërimeve dhe udhëzim ndërmjet dy devijimeve:

1. Ndërmjet përngjasuesve dhe mohuesve në kapitullin mbi cilësitë e Allahut;
2. Ndërmjet *xhebrive* dhe *kaderive* në kapitullin mbi veprat e Allahut;
3. Ndërmjet *murxhivë* dhe *kërcënuesve* në kapitullin mbi kërcënimin e Allahut dhe

182 Ahmedî (16937) dhe Ebu Davudî (4597), përcjellë nga Muavijë ibn Ebu Sufjanî, Allahu qoftë i kënaqur me të!; Tirmidhiu (2640) dhe Ibn Maxhe (3991), përcjellë nga Ebu Hurejra, Allahu qoftë i kënaqur me të!; Tirmidhiu (2641), përcjellë nga Abdullah ibn Amri, Allahu qoftë i kënaqur me të!; si dhe Ibn Maxhe (3992), përcjellë nga Auf ibn Maliku, Allahu qoftë i kënaqur me të!

emërtimet e besimit dhe fesë;

4. Ndërmjet *havarixhëve* dhe *rafidive* në kapitullin mbi sahabët (shokët e të Dërguarit), *sal-lallahu alejbi ue selem*.

Ata janë larg këtyre doktrinave të liga dhe rrugëve të devijuara. Të tjerët u kanë lakmi për mirësinë që ua ka dhënë Allahu, ngaqë ua ka bërë të dashur besimin duke u zbukuruar atë në zemrat e tyre, ashtu siç ua ka bërë të urreyer mosbesimin, shturjen dhe mosbindjen, **“... me mirësinë dhe hirin e Allahut. Allahu është i Gjithëdijshëm dhe i Urtë.”** (El Huxhurat, 8)

Salavatet dhe *selamet* qofshin për robin dhe të Dërguarin e Tij, Muhamedin, familjen dhe të gjithë shokët e tij!



Vision

Achieve international leadership in consolidating and disseminating Islamic studies.

Mission

Contribute to serving the religion of Islam through qualified cadres, through a moderate and contemporary approach.



+966 11 8236708



ca-sais@pnu.edu.sa



sais_pnu



مركز أصول

Osoul Center
www.osoulcenter.com



عرض تعريفى عن مركز أصول
ومجالاته وخدماته.. مشاهدة ممنعة لك

osoulcenter    



+966504442532

www.osoulcenter.com